

GJENDJA

MJEDISORE

NË KOMUNËN

E GJAKOVËS

PRILL 2021



GJENDJA MJEDISORE NË KOMUNËN E GJAKOVËS

Botues : EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &
Bulevardi Nënë Tereza 30B H1 Nr.5,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky dokument është realizuar nga EC Ma Ndryshe, mbështetur nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj "Human Rightivism" që implementohet nga Community Development Fund - CDF. Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.



Prill, 2021

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE 1

LISTA E FIGURAVE 3

LISTA E HARTAVE 4

01

HYRJE 5

02

**BURIMET E NDOTJES SË
MJEDISIT** 6

2.1. GAZRAT E DËMSHME 7

2.2. INDUSTRIA ENERGJETIKE 9

2.3. SEKTORI I BANIMIT – SHFRYTËZIMI I
BIOMASËS DHE ENERGJISË ELEKTRIKE 8

2.4. TRANSPORTI RRUGOR 11

2.5. BUJQËSIA, PYLLTARIA 13

2.6. NDOTËSIT NGA BURIMET 14

AGROKEMIKALE

2.7. MENAXHIMI I MBETURINAVE 14

03

**NDIKIMET E AJRIT TË NDOTUR
NË SHËNDETIN E NJERIUT** 18

04

**KORNIZA INSTITUCIONALE
PËR MONITORIMIN E
GJENDJES SË MJEDISIT** 21

05

AJRI 24

5.1. KORNIZA LIGJORE PËR CILËSINË E
AJRIT 25

5.2. CILËSIA E AJRIT NË KOMUNËN E
GJAKOVËS 26

06

TOKA 30

- 6.1. MENAXHIMI I TOKËS 30
- 6.2. KORNIZA LIGJORE PËR MBROJTJEN E TOKËS 31
- 6.3. MONITORIMI I CILËSISË SË TOKËS 32
- 6.4. DEGRADIMI I TOKËS DHE SHKAKTARËT 33

07

UJËRAT 35

- 7.1. KORNIZA LIGJORE DHE STRATEGJIKE E UJËRAVE 35
- 7.2. UJËRAT SIPËRFAQËSORE 38
- 7.3. MONITORIMI I CILËSISË SË UJËRAVE SIPËRFAQËSORE NË KOMUNËN E GJAKOVËS 39
- 7.4. BURIMET E NDOTJES SË UJËRAVE 51
- 7.5. UJËRAT NËNTOKËSORE 52

08

BIODIVERSITETI 53

- 8.1. BIODIVERSITETI I GJAKOVËS 54
- 8.2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT 55
- 8.3. SEKTORËT KRYESORË ME NDIKIM NË BIODIVERSITET 58
- 8.4. ZONAT E MBROJTURA NATYRORE 62
- 8.5. FLORA DHE VEGJETACIONI I KOSOVËS 63
- 8.6. FLORA NË KOMUNËN E GJAKOVËS 67
- 8.7. FAUNA E KOSOVËS 72
- 8.8. FAUNA NË KOMUNËN E GJAKOVËS 76

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME 78

SHTOJCAT 80

BIBLIOGRAFIA 96

LISTA E TABELAVE

TABELTA 1	STANDARDET E CILËSISË SË AJRIT SIPAS KRITEREVE TË NAAQS	8
TABELTA 2	KLASIFIKIMI I BIZNESEVE DHE PËQINDJA E PJESËMARRJES SË TYRE (KGJ, ANALIZË E SITUATËS MJEDISORE NË KOMUNËN E GJAKOVËS, 2020)	8
TABELTA 3	VDEKJET E PARAKOHSHME SI PASOJË E GRIMCAVE TË PLUHURIT (PM2.5), NO2 DHE O3 NË SHTETET E EUROPËS, 2018	9
TABELTA 4	EMETIMET E GHG NË KOSOVË PËR VITIN 2013	9
TABELTA 5	BURIMET KRYESORE TË EMETIMEVE TË GAZRAVE SERRË NË SEKTORIN E ENERGJISË	9
TABELTA 6	BANESAT SIPAS LLOJIT TË MËNYRËS SË NGROHJES DHE LLOIT KRYESOR TË ENERGJISË SË PËRDORUR NË KOMUNËN E GJAKOVËS	10
TABELTA 7	MJETET MOTORIKE DHE JO-MOTORIKE TË REGJISTRUARA GJATË VITEVE 2011-2020 (ASK-TRANSPORTI TM4, 2020)	11
TABELTA 8	KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË E GAZRAVE SERRË NË SEKTORIN E BUJQËSISË SIPAS IPCC 2006 (RAPORTI GHG 2008-2013)	12
TABELTA 9	GJENERIMI I MBETURINAVE SIPAS ZONAVE DHE SASISË (KGJ - PLANI LOKAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE 2015-2020)	14
TABELTA 10	PASQYRA E PËRGJITHSHME E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE (AMMK - MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË - RAPORT MBI GJENDJEN, 2018)	14
TABELTA 11	NUMRI I VDEKJEVE SIPAS GRUPMOSHËS NË VIT NGA NAA NË KOSOVË (WORLD BANK 2019: AIR POLLUTION MANAGEMENT IN KOSOVO)	18
TABELTA 12	INDEKSI I CILËSISË SË AJRIT PËR PARAMETRAT E MONITORUAR (AMMK - RAPORTI VJETOR PËR GJENDJEN E AJRIT, 2019)	22
TABELTA 13	STANDARDET E STILËSISË SË AJRIT NË KOSOVË KRAHASUAR ME ATO TË OBSH-SË DHE BE-SË	23
TABELTA 14	IHMK - STATISTIKAT VJETORE TË CILËSISË SË AJRIT NË PEJË	26
TABELTA 15	IHMK - STATISTIKAT VJETORE TË CILËSISË SË AJRIT NË PRIZREN	26
TABELTA 16	PËRDORIMI I TOKËS (HA) SIPAS VITEVE 2000, 2006, 2012, 2018 (AMMK, MJEDISI I KOSOVËS - RAPORT I TREGUESVE MJEDISORË, 2020)	27
TABELTA 17	DEPONIA E FLOTACIONIT TË MINIERËS NË DEVË, GJAKOVË (MMPH, AMMK, RAPORT HOTSPOTET MJEDISORE NË KOSOVË, 2011)	29
TABELTA 18	KARAKTERISTIKAT E LIQENIT TË RADONIQIT - GJAKOVË (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, 2015)	33
TABELTA 19	TË DHËNAT PËR LUMIN ERENIK NË GJAKOVË (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, 2015)	34
TABELTA 20	PARAMETRAT E DRINIT TË BARDHË - VLERAT MESATARE VJETORE (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	35
TABELTA 21	VLERAT E OKSIGJENIT TË TRETUR PËR KATËR VITE (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	36

TABELTA 22	VLERA E SHPENZIMIT BIOKIMIK TË OKSIGJENIT PËR KATËR VITE (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	36
TABELTA 23	VLERA E PËRÇËSHMËRISË ELEKTRIKE PËR KATËR VITE (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	37
TABELTA 24	VLERA E PËRÇËSHMËRISË ELEKTRIKE PËR KATËR VITE (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	37
TABELTA 25	VLERAT E AZOTIT TË NITRATEVE PËR KATËR VITE (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	38
TABELTA 26	VLERAT E AZOTIT TË NITRITEVE PËR KATËR VITE (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	39
TABELTA 27	VLERAT E AZOTIT TË AMONIUMIT PËR KATËR VITE (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	39
TABELTA 28	VLERAT E FOSFORIT TË ORTOFOSFATEVE PËR KATËR VITE (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	40
TABELTA 29	VLERAT MAKSIMALE TË LEJUARA PËR METALET E RËNDA NË UJËRAT SIPËRFAQËSORE	41
TABELTA 30	NDOTËSIT KOLEKTIVË SIPAS KOMUNAVE - GJAKOVË (AMMK, KADASTRI I NDOTËSVE TË UJËRAVE TË KOSOVËS)	42
TABELTA 31	NDOTËSIT INDIVIDUALË - GJAKOVË (AMMK, KADASTRI I NDOTËSVE TË UJËRAVE TË KOSOVËS)	42
TABELTA 32	NUMRI I DISA LLOJEVE NË KOSOVË NË KRAHASIM ME ATO NË SHQIPËRI, EUROPË DHE NË BOTË (AMMK, BIODIVERSITETI I KOSOVËS)	44
TABELTA 33	PYJET E KOSOVËS SIPAS LLOJIT, PRONËSISË NË HA DHE PËRQINDJE (AMMK, BIODIVERSITETI I KOSOVËS)	49
TABELTA 34	VLERËSIMI I GJENDJES DHE NUMRIT TË KAFSHËVE TË EGRA NË KOSOVË (MMPH, STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR BIODIVERSITET, 2011-2020)	49
TABELTA 35	AMMK, ZONAT E MBROJTURA NATYRORE (SPECIFIKISHT NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GJAKOVËS)	54
TABELTA 36	KATEGORIZIMI I SPECIEVE BIMORE SIPAS LISTËS SË KUQE TË IUCN-SË (MMPH, LIBRI I KUQ I FLORËS VASKULARE TË KOSOVËS, 2013)	52
TABELTA 37	TRENDI I DEGRADIMIT CILËSOR DHE SASIOR I HABITATEVE TË DISA LLOJEVE TË ZGJEDHURA DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË NË TO (AMMK, MJEDISI I KOSOVËS - RAPORT I TREGUESVE MJEDISORË, 2020)	54
TABELTA 38	LLOJET BIMORE NGA LIBRI I KUQ I FLORËS VASKULARE TË KOSOVË (KGJ, PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË BIODIVERSITET, 2018)	56
TABELTA 39	DISA LLOJE BIMORE ME KARAKTER ENDEMIK NË TERRITORIN E GJAKOVËS (AMMK, BIODIVERSITETI I KOSOVËS)	58
TABELTA 40	KATET E LLOJEVE TË BIMËVE NË ZONAT E ULËTA MBIDETARE (KGJ, PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË BIODIVERSITET, 2019-2024)	59
TABELTA 41	KATEGORIZIMI I LLOJEVE TË PËRFSHIRA NË LIBRIN E KUQ TË FAUNËS SIPAS IUCN (MMPH, LIBRI I KUQ I FAUNËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, 2019)	61

LISTA E FIGURAVE

FIGURA 1	MESATARJA E VJETËRSISË SË AUTOMJETEVE TË REGJISTRUARA (INSTITUTI GAP - EKONOMIA E VETURAVE, 2018)	12
FIGURA 2	NDRYSHIMI I INTENSITETIT TË TRAFIKUT BRENDA DITËS NË RRUGËN TIRANA, GJAKOVË, ME RRETH 1500 AUT/ORË (KGJ, DRAFT PROFILI KOMUNAL I KOMUNËS SË GJAKOVËS, 2020)	13
FIGURA 3	NDRYSHIMI I INTENSITETIT TË TRAFIKUT BRENDA DITËS NË RRUGËN NËNË TEREZA, GJAKOVË, ME RRETH 1000 AUT/ORË(KGJ, DRAFT PROFILI KOMUNAL I KOMUNËS SË GJAKOVËS, 2020)	13
FIGURA 4	INDIKATORËT E EKSPOZIMIT NDAJ GRIMCAVE TË PLUHURIT DHE KUFIRI I OBLIGUAR NË EUROPË, 2016 (EEA - AIR QUALITY IN EUROPE - 2020 REPORT)	19
FIGURA 5	DËMTIMET NË ADN NGA MOSTRAT E GJAKUT TË MARRA NË 3 LOKACIONE PËR MOSHËN NËN 50 (VERDHË) DHE 50 E SIPËR (GJELBËR)	20
FIGURA 6	TEMPERATURA MESATARE SIPAS DY MATËSVE NË GJAKOVË PË PESË VITET E FUNDIT (HTTP://SMARTCITY.E-KOMUNA.COM/SMARTCITY/PUBLIC/SENSOR/2)	26
FIGURA 7	NIVELI I DIOKSIDIT TË KARBONIT NË DY MATËSIT NË GJAKOVË PË KATËR VITE (HTTP://SMARTCITY.E-KOMUNA.COM/SMARTCITY/PUBLIC/SENSOR/2)	26
FIGURA 8	MESATARJA VJETORE E INDEKSIT PËR CILËSINË E AJRIT (AQI) NË GJAKOVË PËR GJASHTË MUAJT E FUNDIT (HTTPS://AIR.PLUMELABS.COM/AIR-QUALITY-IN-GJAKOV%C3%AB-3JWU)	27
FIGURA 9	OKSIGJENI I TRETUR MG/L O ₂ (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	37
FIGURA 10	SHPENZIMI BIOKIMIK I OKSIGJENIT MG/L O ₂ (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	38
FIGURA 11	PËRÇUESHMËRIA ELEKTRIKE MSCM-1 (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	39
FIGURA 12	PËRQËNDRIMI I JOINT HIDROGJEN NË UJË PH (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	39
FIGURA 13	AZOTI I NITRATEVE NË UJË N-NO ₃ - (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	40
FIGURA 14	AZOTI I NITRITEVE NË UJË N-NO ₂ - (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	41
FIGURA 15	AZOTI I AMONIUMIT NË UJË N-NO ₄ + (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	41
FIGURA 16	FOSFORI I ORTOFOSFATEVE NË UJË P-PO ₄₃ - (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	42
FIGURA 17	FOSFORI TOTAL NË UJË P-PO ₄₃ - (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	43
FIGURA 18	PREZENCA E MANGANIT NË PELLGUN E DRINIT TË BARDHË (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	44
FIGURA 19	PREZENCA E HEKURIT NË PELLGUN E DRINIT TË BARDHË (AMMK, RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË KOSOVË, 2015)	44
FIGURA 20	FORMAT JETËSORE TË TAKSONEVE BIMORE NË LIBRIN E KUQ (MMPH, LIBRI I KUQ I FLORËS VASKULARE TË KOSOVËS, 2013)	56
FIGURA 21	RANGIMI I RREZIQEVE QË I KANOSËN BIMËVE (MMPH, LIBRI I KUQ I FLORËS VASKULARE TË KOSOVËS, 2013)	56
FIGURA 22	NUMRI I LLOJEVE ME STATUS TË MBROJTUR Ë KOSOVË 2018 (AMMK, MJEDISI I KOSOVËS - RAPORT I TREGUESVE MJEDISORË, 2020)	63

LISTA E HARTAVE

HARTA 1	DEPONITË ILEGALE NË KOMUNËN E GJAKOVËS (AMMK – MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË – RAPORT MBI GJENDJEN, 2018)	17
HARTA 2	PIKAT E MONITORIMIT TË CILËSISË SË AJRIT NË GJAKOVË SI PJESE E PROJEKTIT “SMART CITY” (HTTP://SMARTCITY.E-KOMUNA.COM/SMARTCITY/PUBLIC/MAP)	25
HARTA 3	ZONA E KONTAMINUAR “HOT SPOT” NË DEVË TË GJAKOVËS (MMPH, AMMK, RAPORT HOTSPOTET MJEDISORE NË KOSOVË, 2011)	31
HARTA 4	STACIONET PËR MONITORIMIN E CILËSISË SË UJËRAVE SIPËRFAQËSORE, GJAKOVË (IHMK)	36
HARTA 5	PIKAT SHKARKUESE NË REGJIONIN E PEJË (AMMK, KADASTRI I NDOTËSVE TË UJËRAVE TË KOSOVËS)	46
HARTA 6	SHTRIRJA E TOKAVE PYJORE NË KOSOVË (HTTPS://WWW.ACADEMIA.EDU/24670393/HARTA_E_SHTRIRJES_S%C3%AB_PYJEVE_N%C3%AB_KOSOV%C3%AB_FOREST_MAP)	52
HARTA 7	LOKALITETET E BIMËVE ENDEMIKE NË KOSOVË (AMMK, BIODIVERSITETI I KOSOVËS)	60

Raporti mjedisor për Komunën e Gjakovës synon të dokumentojë gjendjen e mjedisit përmes të dhënave mbi cilësinë e ajrit, ujërave, tokës dhe biodiversitetit në komunë. Bazuar në literaturën dhe udhëzimet mbi metodat e monitorimit dhe raportimit të gjendjes mjedisore, ky raport përmbledh të dhëna të rëndësishme nga raportet mjedisore të hartuara nga institucionet shtetërore dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë, udhëzuesit e BE-së, kornizës ligjore të Kosovës dhe raporteve evropiane mbi faktorët kryesorë të mjedisit.

Në kapitullin e parë, Burimet e Ndotjes, shtjellohen ndotësit kryesorë të mjedisit dhe origjina e tyre. Në bazë të studimit të raporteve ekzistuese për mjedisin, gazrat e rrezikshme përbëjnë ndotësit kryesorë të ajrit, përderisa pasohen nga shfrytëzimi i biomasës, transporti rrugor, mbeturinat dhe ndotësit agrokemikalë si faktorë me rol të madh në gjendjen e mjedisit. Përmes burimeve të referencuara, të dhënat mbi secilin burim të ndotjes krahasohen në nivel të shtetit dhe specifikohen për komunën e Gjakovës në veçanti.

Gjendja ekzistuese e ujërave, ajrit, tokës dhe biodiversitetit analizohet përmes të dhënave nga raportet e monitorimit të këtyre faktorëve kryesorë të mjedisit.

Përfundimet e nxjerra nga ky raport përshkruhen në pjesën e fundit ku renditen edhe rekomandimet përkatëse ndaj secilës mangësi apo mundësi për përmirësimin e gjendjes mjedisore.

BURIMET E NDOTJES SË MJEDISIT

Ndotja e mjedisit vjen nga burimet natyrore dhe antropogjene, me të cilat kuptohet kontributi i aktivitetit njerëzor në shtimin e ndotësve në mjedis. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, aktivitetet njerëzore me ndikimin më të madh në ndotjen e ajrit përfshijnë: motorët me djegie të brendshme (si naftë dhe benzinë), djegie me lëndë të ngurtë (qymyr, linjit, vaj të rëndë dhe biomasë) për prodhimin e energjisë në familje dhe industri, si dhe aktivitete të tjera industriale (ndërtimi, minierat, prodhimi i çimentos, qeramikës dhe

tullave, dhe shkrirja e metaleve).¹

Planifikimi urban, që imponon përdorimin e mjeteve individuale të transportit, luan rol të madh në sasinë e ndotjes së ajrit. Grimcat e pluhurit (Particulate Matter) janë grimca që thithen përmes frymëmarrjes dhe përbëhen nga sulfatet, nitratet, amoniaku, klorur natriumi, karboni i zi, pluhuri mineral dhe uji. Ato paraqesin rrezik të madh për nga lehtësia e depërtimit në mushkëri dhe në gjakun e njeriut.²

NDOTËSIT	PRIMARE/ SEKONDARE	KOHA MESATARE	NIVELI	BURIMET URBANE	NDIKIMI NË SHËNDET
MONOKSIDI I KARBONIT (CO)	Primar	8 orë	9 ppm (10.31mg/m ³)	Mjetet e transportit	Lodhje, dëmtim i shikimit dhe probleme kardiovaskulare
		1 orë	35 ppm (40.09 mg/m ³)		
DIOKSIDI I AZOTIT (NO₂)	Primar	1 orë	100 ppb (188.18 µm/m ³)	Mjetet e transportit	Ndjeshmëri e rritur e mushkërive dhe zvogëlim i kapacitetit të tyre
	Sekondar	Vjetore	53 ppb (99.73 µm/m ³)		
OZONI (O₃)	Primar dhe Sekondar	8 orë	0.075 ppm (147 µm/m ³)	Ndotësit dytësorë; Reaksionet fotokemikale të mjeteve	Defekte në frymëmarrje dhe kapaciteti i zvogëluar i mushkërive
GRIMCAT E PLUHURIT (PM_{2.5})	Primare	Vjetore	12 µm/m ³	Mjetet e transportit, termocentralet, industria, agrikultura, pluhuri sipërfaqësor, era nga deti	Defekte respiratore dhe kardiovaskulare. Rritje e vdekjeve të parakohshme dhe nga kanceri i mushkërive
	Sekondare	Vjetore	15 µm/m ³		
GRIMCAT E PLUHURIT (PM₁₀)	Primar dhe sekondar	24 orë	35 µm/m ³		
	Primar dhe Sekondar	24 orë	150 µm/m ³		
DIKSIDI I SULFURIT (SO₂)	Primare	1 orë	75 ppb (196.5 µm/m ³)	Termocentralet, mjetet e transportit	Efekt në mushkëri dhe rritje e vdekshmërisë
	Sekondare	3 orë	0.5 ppm (1.31mg/m ³)		

Tabela 1. Standardet e cilësisë së ajrit sipas kritereve të NAAQs

¹ <https://www.who.int/teams/environment-climate-change-and-health/air-quality-and-health/ambient-air-pollution/pollutants/types-of-pollutants>

² <https://www.who.int/teams/environment-climate-change-and-health/air-quality-and-health/ambient-air-pollution/pollutants/types-of-pollutants>

Sektori privat në Gjakovë dhe veprimtaritë ekonomike duhet të merren parasysh sidomos në rastin e disa industrive që marrin pjesë në sasinë e emetimeve të gazrave serrë

në vend. Në bazë të përqindjes më të lartë të aktiviteteve ekonomike mund të vërejmë edhe raportin me sasinë e emetimeve të dëmshme në ajër.

SEKTORI	PËRSHKRIMI	NUMRI I BIZNESEVE	PËRQINDJA %
A	Bujqësia, Gjuetia dhe Pylltaria	166	3.8
D	Industria Përpunuese (tjera)	155	3.5
F	Ndërtimi	306	7.0
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve	1,702	38.8
H	Hotelet dhe Restoranet	505	11.5
I	Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	265	6.0
K	Pasuritë e patundshme, informatika, kërkimet shkencore	219	5.0
O	Aktivitete të shërbimit kolektiv, social dhe individual	498	11.4

Tabela 2. Klasifikimi i bizneseve dhe përqindja e pjesëmarrjes së tyre (KGJ, Analizë e Situatës Mjedisore në Komunën e Gjakovës, 2020)

GAZRAT E DËMSHME²¹

Ekspozimi ndaj ndotësve në ajër është dëshmuar tashmë për ndikimin në shëndet, si vdekjet e parakohshme dhe sëmundjet e ndryshme respiratore. Për të dokumentuar mortalitetin dhe sëmundjet, matjet bëhen përmes të dhënave demografike, të shëndetit dhe të përqendrimeve të gazrave në ajër.³

Gazrat me efekt serrë në Kosovë në vitin 2008 përbënin 9.5 Mt CO₂ eq⁴,

kurse në vitin 2015 ato u rritën në 10 Mt CO₂ eq, pra për gati 5.2% dhe kjo pothuajse vetëm nga energjia e prodhuar nga thëngjilli. Sa i përket emetimeve të gazrave të dëmshme për kokë banori, ato të Kosovës e kalojnë gjysmën e mesatares së BE-së (9.93t), ndërsa emetimet për njësi të Bruto Prodhimit Vendor janë dyfish më të larta se ato të BE-së (0.4kg/EUR).⁵

³ EEA, Air Quality in Europe – 2020 Report

⁴ Mt CO₂ eq – metër ton ekuivalent është njësi që përfaqëson sasinë e gazrave serrë, ndikimi atmosferik i të cilave është standardizuar në CO₂, bazuar në potencialin ngrohës të gazit.

⁵ MMPH, Strategjia për Ndryshime Klimatike 2019-2028 dhe Plani i Veprimit për ndryshime klimatike 2019-2021, 2018

SHTETI	POPULLIMI (1000)	PM _{2.5} (GRIMCAT MË TË VOGLA SE 2.5 µm)		NO ₂		O ₃	
		MESATARJA VJETORE	VDEKJET E PARAKOHSHME	MESATARJA VJETORE	VDEKJET E PARAKOHSHME	MESATARJA VJETORE	VDEKJET E PARAKOHSHME
Kosova	1 799	28.2	4 000	17	90	3 922	80
Shtetet total	539 742	13.5	417 000	17.6	55 000	4 962	20 600

Tabela 3. Vdekjet e Parakohshme si pasojë e Grimcave të Pluhurit (PM_{2.5}), NO₂ dhe O₃ në Shtetet e Evropës, 2018 ⁶

EMETIMET E GHG NË KOSOVË PËR VITIN 2013	Gg CO ₂ eq.
Gjithsej emetime	9568.4
Energjia	8428.4
Proceset industriale	198
Shfrytëzimi i produkteve	36
Bujqësia	690
Pylltaria dhe shfrytëzimi i tokës	-34
Mbeturinat	250

Tabela 4. Emetimet e GHG në Kosovë për vitin 2013 ⁷

⁶ EEA, Air Quality in Europe – 2020 Report

⁷ MMPH, Strategjia për Ndryshime Klimatike 2019-2028 dhe Plani i Veprimit për ndryshime klimatike 2019-2021, 2018

INDUSTRIA ENERGETIKE 2

Sektori i energjisë është shkaktari kryesor i emetimeve të gazrave serrë në Kosovë, me 87% të totalit të emetimeve. Për nga përqindja e emetimeve atë e pasojnë bujqësia dhe shfrytëzimi i tokave me 6%, mbeturinat me 5% dhe industria dhe prodhimi i produkteve me rreth 2.5%. Burimi kryesor për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë është thëngjilli apo linjiti i cili siguron 97% të energjisë së prodhuar. Rrjedhat ujore sigurojnë

vetëm 3% të prodhimtarisë vjetore. Gazrat që emetohen nga termocentralet përmbajnë sasi të dëmshme të squfurit, oksidit të azotit dhe pluhurit. Problem paraqesin edhe ujërat që shfrytëzohen nga termocentralet të cilat pas përdorimit lirohen të patrajtuara, si dhe pluhuri në deponitë e hirit. Ky pluhur shtrihet në rreth 150ha të tokave të punueshme, me afro 40 milionë tonë të hirit që dëmton dheun dhe produktet që rriten në të.⁹

BURIMET E EMETIMEVE	CO ₂ Gg. Eq.	PËRQINDJA (%)
Sektori i energjisë	6431.05	76.3
Sektori i prodhimit dhe ndërtimit	549.33	6.5
Transporti rrugor	965.94	11.5
Sektorët tjerë nga djegia e karburanteve	446.02	5.3
Lëndët djegëse të ngurta	35.85	0.4

Tabela 5. Burimet kryesore të emetimeve të gazrave serrë në sektorin e energjisë

SEKTORI I BANIMIT 2.3

SHFRYTËZIMI I BIOMASËS DHE ENERGISË ELEKTRIKE

Sipas Bankës Botërore, sektori i ndërtimit përfshin 48% të energjisë së konsumuar në Kosovë, me shfrytëzim

të biomasës në 45% dhe energjisë elektrike 44%.

⁹ https://www.researchgate.net/publication/289511362_Gjendja_e_pergjithshme_mjedisore_ne_Kosove_propozime_dhe_sugjerime

Sipas burimeve dhe analizave në nivel shtetëror, sektori i banimit në Kosovë është burimi më i madh i ekspozimit ndaj grimcave të pluhurit $PM_{2.5}$ si pasojë e ngrohjes me djegie të karburanteve të ngurta.¹⁰ Në komunën e Gjakovës pjesa më e madhe e banorëve e shfrytëzojnë drurin si lëndë e ngurtë djegëse për ngrohje ku prej

16,131 objekteve të banimit, 13,571 prej tyre si mjet për ngrohje shfrytëzojnë stufën, ndërsa 749 të tjera shfrytëzojnë energjinë elektrike. Nafta dhe mazuti përdoren relativisht pak, kurse thëngjilli e gazi përdoren më së paku nga të gjitha llojet e energjisë për ngrohje.

KOMUNA E GJAKOVËS	MËNYRA KRYESORE E NGRHJES						
	GJITHSEJ	NGROHJE QËNDRORE	NGROHJE PËRBRENDA	STUFË	OXHAK	NGROHËS I LËVIZSHËM	TJERA
BANESË E ZAKONSHME	16,131	936	487	13,571	380	704	43
PERSONA	94,424	4,144	2,928	82,300	2,125	2,711	184

KOMUNA E GJAKOVËS	LLOJI KRYESOR I ENERGJISË SË PËRDORUR				
	DRU	QYMYR/ THËNGJILL	NAFTË/ MAZUT	GAZ	ENERGJI ELEKTRIKE
BANESË E ZAKONSHME	14,268	34	1,020	40	749
PERSONA	86,457	236	4,559	174	2,922

Tabela 6. Banesat sipas llojit të mënyrës së ngrohjes dhe llojit kryesor të energjisë së përdorur në Komunën e Gjakovës

¹⁰ World Bank, Air Pollution Management in Kosovo, 2019

TRANSPORTI RRUGOR²4

Mesatarja e përdorimit të automjeteve është rritur për 8.5% në gjashtë vitet e fundit. Sipas studimeve, transporti rrugor është përgjegjës për 10% të gazrave serrë në vend. Përveç pasojave në mjedis, ndotja e këtij niveli ndikon edhe në ekonominë e vendit, me 46 milionë Euro vetëm për vitin 2018,

prej të cilave 15% nga dioksidi i Azotit dhe 85% nga emetimet e grimcave të pluhurit PM_{2.5}.¹¹ Ndotja nga automjetet mund të zvogëlohet në vitet e ardhshme me përdorimin e automjeteve më moderne, por lirimi i gazrave serrë do të rritet në proporcion me rritjen ekonomike.

KOMUNA E GJAKOVËS	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
VETURA	170,321	176,398	222,537	236,145	281,847	260,291	273,862	280,422	291,295	292,902
AUTOMJET TRANS 3.5 DHE MBI 3.5T	10,877	11,547	15,352	15,769	18,330	17,963	18,559	33,889	291,295	19,060
AUTOMJET TRANS NËN 3.5T	17,901	18,225	24,659	26,949	30,846	31,285	32,299	19,371	19,379	35,705
KOMBIBUSET	2,698	2,520	3,225	3,161	3,212	2,841	2,535	2,917	2,977	1,768
AUTOBUSET	1,117	1,298	1,570	1,697	2,124	1,916	1,949	2,326	2,135	1,794
MOTOÇIKLETA	546	809	1,488	1,540	1,849	1,790	1,690	2,038	2,087	1,694
TRAKTORË	39	137	776	1,036	1,849	613	523	1,791	1,851	641
RIMORKIO NËN 3.5T	101	117	217	250	286	288	288	572	681	297
RIMORKIO 3.5 DHE MBI 3.5T	1,766	1,800	2,283	2,281	2,707	2,628	2,735	305	271	3,101
GJITHSEJ	205,366	212,851	272,107	288,828	342,142	319,615	334,440	343,631	355,829	356,962

Tabela 7. Mjetet motorike dhe jo-motorike të regjistruara gjatë viteve 2011-2020 (ASK-Transporti TM4, 2020)

¹¹ World Bank Group, Kosovo: A Future of Green Transport and Clean Air

Vjetërsia mesatare e veturave në Kosovë është rreth 19 vite, 10 vite më shumë se mesatarja e veturave që qarkullojnë brenda Bashkimit Evropian, ndërsa ato të importuara 6-7 vite.¹² Sipas numrit të veturave të regjistruara në bazë të komunave, në

Gjakovë në vitin 2016 janë regjistruar 17,043 ose 5.33% e numrit total të veturave të regjistruara për këtë vit. Në bazë të regjioneve, regjistrimi i veturave në regjionin e Gjakovës përbën 11% të numrit total.¹³




Figura 1. Mesatarja e Vjetërsisë së automjeteve të regjistruara (Instituti GAP - Ekonomia e Veturave, 2018)




Figura 2. Ndryshimi i intensitetit të trafikut brenda ditës në rrugën Tirana, Gjakovë, me rreth 1500 aut/orë (KGJ, Draft Profili Komunal i Komunës së Gjakovës, 2020)




Figura 3. Ndryshimi i intensitetit të trafikut brenda ditës në rrugën Nënë Tereza, Gjakovë, me rreth 1000 aut/orë (KGJ, Draft Profili Komunal i Komunës së Gjakovës, 2020)

¹² World Bank Group, Kosovo: A Future of Green Transport and Clean Air

¹³ <https://veturat.institutigap.org/#regjistrimi-sipas-regjioneve>

BUJQËSIA, PYLLTARIA ²⁵

Sektori i bujqësisë paraqet 11.% të BPV-së (Bruto Prodhim Vendor)dhe përbën 26.7% të punësimit në vend. Përderisa mbetet sektor i rëndësishëm ekonomik, bujqësia, pylltaria dhe shfrytëzimi i tokës përbëjnë 13% të sasisë së përgjithshme të emetimeve të gazrave serrë. Pylltaria konsiderohet thithës i karbonit atmosferik por edhe kontribuesi i dytë në vend për nga sasia e emetimit të dioksid karbonit, me rreth 2.750 mijë tonelata CO₂.¹⁴ Vetëm sektori i bujqësisë përbën

7% të emetimit të gazrave serrë në Kosovë, me rreth 700 milionë ton CO₂ eq. Emetimet e metanit nga fermentimi enterik (procesi tretës i kafshëve) dhe emetimet e dioksidit të azotit dhe metanit nga menaxhimi i plehrave të kafshëve me 550 mijë ton CO₂ rradhiten si nënsektor i parë i sektorit të bujqësisë. Nënsektori i dytë përfshin fertilizimin e tokës dhe djegien e biomasës me emetime indirekte të azotit rreth 150 mijë ton CO₂ eq çdo vit.

¹⁵

KATEGORIA SIPAS IPCC 2006	GAZRAT		
	CO ₂	CH ₄	N ₂ O
3.A - BAGËTIA			
3.A.1 - FERMENTIMI ENTERIK		✓	
3.A.2 - MENAXHIMI I PLEHUT		✓	✓
3.C - BURIMET E AGREGUARA DHE BURIMET E EMETIMIT TË JO-CO2 NË TOKË			
3.C.1 - EMETIMET DHE DJEGIA E BIOMASËS			
3.C.2 - EMETIMET NGA DJEGIA E BIOMASËS		✓	✓
3.C.3 - APLIKIMI I UREA-S	✓		
3.C.4 - EMETIMET DIREKTE TË N ₂ O NGA MENAXHIMI I TOKAVE/DHEUT			✓
3.C.5 - EMETIMET INDIREKTE TË N ₂ O NGA MENAXHIMI I TOKAVE/DHEUT			✓
3.C.6 - EMETIMET INDIREKTE TË N ₂ O NGA MENAXHIMI I PLEHUT			✓

Tabela 8. Kategoritë dhe nënkategoritë e gazrave serrë në sektorin e bujqësisë sipas IPCC 2006 (Raporti GHG 2008-2013)

¹⁴ MMPH, Strategjia për Ndryshime Klimatike 2019-2028 dhe Plani i Veprimit për ndryshime klimatike 2019-2021, 2018

¹⁵ AMMK, Emetimi i Gazrave Serrë në Kosovë 2008-2013, 2015

Metani (CH₄) përfshin 77% të gazrave të emetuara nga ky sektor, Oksidi i Azotit (N₂O) 20% dhe Dioksidi i Karbonit (CO₂) 3%.

Sa i përket sektorit të pylltarisë, është sektori i vetëm i akumulimit të gazrave

serrë në kuadër të emetimeve totale në Kosovë. Burimet e emetimeve të gazrave serrë në këtë kategori përfshijnë: tokat pyjore, bujqësore, kullotat, tokat e lagura, vendbanimet dhe tokat tjera.

NDOTËSIT NGA BURIMET ²⁶

Kimikatet janë substanca kimike që gjejnë përdorim në bujqësi në formën e pesticideve dhe insekticideve, në dezinfektim dhe në praktika shkencore e industriale. Menaxhimi i plehut, si në sektorin e tretë të bujqësisë, konsiderohet një nga sektorët e ndotësve të mëdhenj me emetim rreth 800 mijë tonelata CO₂ eq.¹⁶ Varësia e agrikulturës në kimikate për trajtimin e insekteve të dëmshme, sëmundjet dhe barërat e këqija ka bërë që këto kimikate të kushtëzojnë sigurinë e ushqimit dhe shëndetin e njeriut pasi që ato mund të dëmtojnë edhe mikroorganizmat e shëndetshëm dhe mund të krijojnë rezistencë antibakteriale. Këto kimikate mund të ndikojnë në përqëndrimin e azotit dhe fosforit në dhe, si dhe mund të shkaktojnë transformime të tjera në lëndët ushqyese.¹⁷

AGROKEMIKALE

Disa nga agrokemikalet janë: Pesticidet, insekticidet, herbicidet, fungicidet dhe plehurat. Efektet e tyre shpërndahen edhe jashtë tokave bujqësore, duke përfshirë ujërat, ajrin dhe shëndetin e njeriut në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në Kosovë shpenzohen rreth 461 ton pesticide në vit, prej të cilave: insekticide 306 ton, fungicide 106 ton, herbicide 3 ton, rodenticide 42 ton dhe akaricide 4 ton. Përveç importit të rritur të këtyre materieve kimike, përdoruesit nuk janë të trajnuar në përdorimin e tyre, prandaj mund të ketë keqpërdorime që ndikojnë negativisht në ajër dhe në mirëqenien e mjedisit natyror në veçanti.¹⁸

MENAXHIMI I MBETURINAVE ²⁷

Emetimi nga sektori i mbeturinave përfshin 3% të emetimit të gazrave serrë dhe ndahet në nënkategori të rëndësishme për trajtim: deponitë e menaxhuara, të pamenaxhuara dhe ilegale; djegia e mbeturinave;

shkarkimi dhe trajtimi i ujërave të zeza. Sipas llojeve të gazrave serrë, nga sektori i mbeturinave metani përbën 88% të emetimeve, oksidi i azotit 14% dhe dioksid karboni 1%.¹⁹

¹⁶ <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/B9780081030172000076>, Impact of agrochemicals on soil health

¹⁷ MMPH, Strategjia dhe Plani i Veprimt për Biodiversitetin 2011-2020

¹⁸ AMMK, Emetimi i Gazrave Serrë në Kosovë 2008-2013, 2015

¹⁹ AMMK, Emetimi i Gazrave Serrë në Kosovë 2008-2013, 2015

Sasia e mbeturinave komunale të deponuara në deponitë sanitare ka pësuar rritje konstante ndër vite. Në vitin 2009 janë deponuar 24,720,665 ton, kurse në vitin 2019 gati dyfishi i kësaj sasive ose 44,988,181 ton.²⁰

Mbeturinat e ngurta të parrezikshme që prodhohen në Kosovë përfshijnë mbeturinat komunale (MK) nga amvisëritë, mbeturinat komerciale (Mko), ato të ndërtimit dhe demolimit (N&D), si dhe mbeturinat e vëllimshme (MV). Ligji për mbeturina nr. 2012/04-L-060 merr për bazë standardet evropiane dhe krahason detyrat në kuadër të shtetit. Sipas këtij ligji, komunat janë përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave përmes departamenteve dhe inspektorateve komunale, për modelin e operatorit për

mbledhje, për caktimin e tarifave dhe për mënyrën e mbledhjes së mbeturinave. Mënyra e organizimit të mbledhjes së mbeturinave në Kosovë bëhet përmes shtatë kompanive regjionale të cilat i dërgojnë mbeturinat në stacione transferi e pastaj deponohen në deponi sanitare ose drejtpërdrejtë. Nga shtatë deponi regjionale, katër konsiderohen josanitare.²¹

Në Gjakovë, përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave komunale është ndërmarrja publike KRM "Çabrati" dhe i shërben vetëm 58 nga gjithsej 91 vendbanime të komunës, ku 33 vendbanime nga zonat rurale mbeten jashtë sistemit të menaxhimit të mbeturinave.

GJENERIMI I MBETURINAVE TË VLERËSUARA

MBETJET E GJENERUARA PËR PERSON [KG/BANOR] – MESATARJA	1.2KG
URBANE	1.5KG
PARA – URBANE	1.2KG
RURALE	1.0KG
RURALE - THELLE	0.9KG

VLERËSIMI I GJENERIMIT TË MBETURINAVE – TË PËRLOGARITURA

TOTALI I MBETJEVE TË GJENERUARA [T/DITË]	113
TOTALI I MBETJEVE TË GJENERARA [T/VIT]	14,099
TOTALI I MBETJEVE TË MBLEDHURA 65 TON NË DITË PUNE – [T/VIT]	17,225

Tabela 9. Gjenerimi i Mbeturinave Sipas Zonave dhe Sasisë (KGJ – Plani Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave 2015–2020)

²⁰ AMMK, Mjedisi i Kosovës – Raporti i Treguesve Mjedisore, 2020

²¹ AMMK, Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë – Raport mbi Gjendjen, 2018

STACIONI TRANSFER I MBETURINAVE


KRM "Çabrati" bën mbledhjen e mbeturinave në ditët e caktuara të vendbanimeve dhe i transferon ato në Stacionin e Transferit në periferi të qytetit para deponimit përfundimtar në deponinë kryesore sanitare në Prizren (Landovicë). Sasia e mbledhur e mbeturinave brenda një dite është afërsisht 60 - 70 ton. Sipas vlerësimit të bërë nga ndërmarrja, gjendja në këtë Stacion Transfer është alarmante,

me mbi 60 mijë ton mbeturina të grumbulluara dhe në distancë më të vogël se 100m nga vendbanimet e komunitetit romë në periferi të qytetit. Në gusht të vitit 2020 është marrë vendim nga Komuna e Gjakovës në pajtueshmëri me deponinë e Prizrenit për bartjen e mbeturinave atje dhe ka filluar të bëhet pastrimi i këtij stacionit transfer në afat prej 45 ditësh.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME				
	RAJONI	SIP. (KM ²)	NR. I BANORËVE (2011)	NR. AMVISËRIVE (2011)
R7	Rajoni i Gjakovës	959	140,659	22,960
	Kosovë	10,906	1,779,521	307,014

	MBULIMI			ARKËTIMI	DEPONITË ILEGALE	
	GJITHSEJ KLIENTË (2016)	GJITHSEJ KLIENTË TË SHËRBYER (12/2016)	MBULIMI	SHKALLA E ARKËTIMIT	NUMRI I DEPONIVE ILEGALE (2017)	NUMRI I DEPONIVE ILEGALE (KM ²)
R7	16,131	936	487	13,571	704	43
	94,424	4,144	2,928	82,300	2,711	184

Tabela 10. Pasqyra e përgjithshme e menaxhimit të mbeturinave (AMMK – Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë – Raport Mbi Gjendjen, 2018)



LEGJENDA

- Deponitë ilegale - 2017
- Kufinjët Komunal
- Kufinjët e Zonave Kadastrale
- Zona të Pa-Banuara

MBULUESHMËRIA NË VENDBANIME

- 0%
- 1 - 35%
- 36 - 70%
- 71 - 100%

Harta 1. Deponitë Ilegale në Komunën e Gjakovës (AMMK – Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë – Raport Mbi Gjendjen, 2018)

Në anketën e vitit 2017 janë identifikuar 95 deponi ilegale apo 0.14 deponi ilegale për m². Shkalla e reciklimit

të mbeturinave është rreth 5% dhe sipas parashikimeve, ajo mund të arrijë në 23% në vitet e ardhshme.²²

MBETURINAT E RREZIKSHME INDUSTRIALE, KEMIKALE DHE MJEKËSORE

Mbeturinat e rrezikshme përfshijnë lëngjet, mbeturinat mjekësore dhe mbeturinat nga veprimtaritë e bujqësisë, industrisë dhe pylltarisë.²³ Në Gjakovë janë identifikuar disa deponi të mbeturinave të rrezikshme industriale dhe të kimikateve që kalojnë sasinë prej 5 ton për secilin lokacion:

- New Co Jatex (ish Ndërmarrja JATEX), mbeturina me origjinë nga prodhimi i tekstilit,
- New Co Miniera Devë, mbeturina me origjinë minerare,
- Metaliku, mbeturina me origjinë nga procesimi i metaleve, dhe
- New Co Emin Duraku - Devolli, mbeturina me origjinë nga procesimi i tekstilit.²⁴

Përveç mbeturinave industriale, komuna e Gjakovës përballet edhe me kontaminimin e mbeturinave të ngurta komunale nga mbeturinat mjekësore, si: shiringat e përdorura, gjaku, mbetjet nga kultura biologjike, mbetjet anatomike dhe materialet nga intervenimet kirurgjike. Edhe pse në rajonin spitalor është i instaluar impianti për trajtimin e këtyre mbetjeve, ai përdoret rrallë dhe me kapacitet deri në 10kg/ditë nga 1500-1800kg/ditë të parapara.

²² AMMK, Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë – Raport mbi Gjendjen, 2018

²³ AMMK, Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë – Raport mbi Gjendjen, 2018

²⁴ KGJ, Plani Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave 2015-2020, 2015

NDIKIMET E AJRIT TË NDOTUR NË SHËNDETIN E NJERIUT

Ajri i ndotur ka ndikim të madh në shëndetin e njeriut, sidomos në zonat urbane që i ekspozohen më shumë gazrave të dëmshme. Ndotja e ajrit luan rol edhe në ekonominë e vendit duke e zvogëluar jetëgjatësinë, duke i rritur shpenzimet mjekësore dhe me zvogëlimin e produktivitetit në shumë sektorë të ekonomisë.²⁵

Kimikatet e rrezikshme shpërndahen në mjedis përmes aktivitete njerëzore ose në mënyrë natyrale dhe mund të shkaktojnë efekte të rënda në shëndetin e njeriut. Emetimet nga djegia e shtuar e biomasës në shekullin e fundit janë përgjegjëse për lirim të Oksidit të Karbonit (CO), Dioksidit të Sulfurit (SO₂), Oksidit të Azotit (NO_x), Ozonit (O₃), metaleve të rënda dhe grimcave të thithshme të pluhurit (PM_{2.5} dhe PM₁₀). Ndotja e ajrit mund të ketë efekte kronike e akute në shëndetin njerëzor, duke shkaktuar dëme në shumë organe dhe sisteme të trupit. Sëmundjet dhe komplikimet mund të shfaqen në forma të lehta e të pavërejtshme deri te ato më të rëndat, si: sëmundje kronike të frymëmarrjes dhe zemrës, kancer i mushkërive, infektive akute në frymëmarrje te fëmijët dhe bronhit kronik te të rriturit, keqësim i sëmundjeve ekzistuese të zemrës dhe mushkërive ose sulme astme. Përveç sëmundjeve që mund ta përcjellin njeriun gjatë jetës, thithja e ajrit të ndotur është lidhur edhe me vdekje të parakohshme dhe jetëgjatësi më të shkurtë në masë.²⁶

²⁵ EEA, Air Quality in Europe - 2020 Report

²⁶ <https://www.sciencedirect.com/science/article/abs/pii/S0269749107002849> Human Health Effects of Air Pollution, Elsevier




Figura 4. Indikatorët e ekspozimit ndaj grimcave të pluhurit dhe kufiri i obliguar në Evropë, 2016 (EEA - Air Quality in Europe - 2020 Report)

Disa studime janë bërë në raportin e ajrit të ndotur dhe shëndetin e njeriut duke përfshirë edhe një studim në ndikimin e grimcave të rrezikshme në dëmtimin e ADN-së së njeriut. Në Kosovë janë identifikuar disa hot-spote apo zona të koncentrimin të ndotësve, kryesisht në deponi sanitare të mbeturinave, deponitë e minierave, të pesticideve, zonat agrikuturore dhe ato të mbledhjes së kimikateve dhe mbetjeve të rrezikshme.

Ndikimi i ajrit të ndotur në organizmin e njeriut mund të matet përmes markerëve klinikë, si funksionet e frymëmarrjes ose incidentet e sëmundjeve, por edhe përmes biomarkerëve që reflektojnë sëmundjet si kanceri ose sëmundjet e zembrës. ADN-ja e dëmtuar konsiderohet biomarker i rrezikut ndaj kancerit. Sipas rezultateve të studimit, personat që jetojnë në afërsi të burimeve të ndotjes janë dukshëm më të dëmtuar se pjesa tjetër e popullsisë.

27




Figura 5. Dëmtimet në ADN nga mostrat e gjakut të marra në 3 lokacione për moshën nën 50 (verdhe) dhe 50 e sipër (gjelbër) ²⁸

GRUPMOSHA	0-4	5-14	15-49	50-69	70+	GJITHSEJ
SËMUNDJE ISKEMIKE TË ZEMRËS	0	0	56	102	139	296
SULM NË ZEMËR	0	0	30	213	145	388
SËMUNDJE KRONIKE OBSTRUKTIVE TË MUSHKËRIVE	0	0	1	6	16	22
KANCER NË MUSHKËRI	0	0	8	21	18	47
SËMUNDJE E SISTEMIT TË POSHTËM RESPIRATOR	1	1	0	3	2	7
GJITHSEJ	1	1	95	344	319	760

Tabela 11. Numri i vdekjeve sipas grupmoshës në vit nga NAA në Kosovë (World Bank 2019: Air pollution management in Kosovo)

²⁸ https://www.researchgate.net/publication/292881664_Atmospheric_pollution_in_Kosovo_is_associated_with_increased_DNA_damage_in_the_human_population (A-vdulla J Alija, Fisnik Asllani, Ismet D Bajraktari, Andrew Richard Collins, Shemsedin Dreshaj)

KORNIZA INSTITUCIONALE 4

PËR MONITORIMIN E GJENDJES SË MJEDISIT

Me Ligjin Nr. 03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit harmonizohen zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me mbrojtjen e mjedisit sipas koncepteve të zhvillimit të qëndrueshëm. Organet përgjegjëse për administrimin e mbrojtjes së mjedisit sipas ligjit për mbrojtjen e mjedisit janë Qeveria, Ministria dhe Komunat.

Me qëllim të monitorimit të cilësisë së mjedisit, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit themelon Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe i cakton detyrat përkatëse:

- 1.1 Të sigurojë informacionin e duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit;
- 1.2 Të sigurojë informacionin e duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit;
- 1.3 T'i vendosë dhe t'i mbajë qendrat referente me bazat e të dhënave për përcjelljen e mjedisit (të dhënat socio-ekonomike, presionet në mjedis, gjendjen dhe kualitetin e mjedisit);
- 1.4 Të zhvillojë procedurat për përpunimin e të dhënave të grumbulluara për mjedisin dhe vlerësimin e tyre (modelimin, prezantimin dhe paraqitjen vizuale);
- 1.5 Të kryejë punët profesionale gjatë përcaktimit të përmbajtjes, metodologjisë dhe mënyrës së përcjelljes së gjendjes së mjedisit;
- 1.6 Të avancojë dhe krahasojë cilësinë e të dhënave për mjedisin;
- 1.7 Të hartojë raporte për gjendjen e përgjithshme të mjedisit në Kosovë, synimeve, si dhe të raportojë për sektorët kryesorë (ajrin, tokën, ujin, llojllojshmërinë biologjike, ndryshimet klimatologjike);
- 1.8 Të hartojë raporte për çështjet e caktuara për mbrojtjen e mjedisit siç janë rajonet me radioaktivitet të shtuar, cilësia e mjedisit, shëndeti dhe ngjashëm;
- 1.9 Kryen punë këshillëdhënëse për përcaktimin, mbajtjen dhe përcjelljen e projekteve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;
- 1.10 Të ndihmojë organet e administratës në zhvillimin e formave të reja të politikës për mbrojtjen e mjedisit dhe përcjelljen e zbatimit të planeve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;
- 1.11 Të bashkëpunojë me Agjencinë Evropiane të Mjedisit – AEM e cila është në përbërje të Rrjetit Evropian për Informim dhe Vëzhgim – RREIV;

- 1.12** Të bashkëpunojë me institucionet dhe organizmat tjerë ndërkombëtarë për mbrojtjen e mjedisit;
- 1.13** Të sigurojë qasjen në të gjitha informacionet për mjedisin e Kosovës sipas standardeve të AEM;
- 1.14** Shfrytëzimi dhe këmbimi ndër-shtetëror i të dhënave për mjedis do të rregullohet me ligj të veçantë.

AMMK kryen edhe punë të tjera tëparacaktuara në aktin për themelim që shërbejnë për realizimin e veprimtarisë së AMMK të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Institutet dhe Drejtoritë e AMMK-së përfshijnë: Drejtorinë për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit, Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, Institutin Hidrometreologjik të Kosovës, Drejtorinë e Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna dhe Drejtorinë Parku Kombëtar Sharr.

DREJTORIA E MONITORIMIT, VLERËSIMIT DHE RAPORTIMIT MJEDISOR

- Organizon monitorimin, planet strategjike dhe programet;
- Grumbullon të dhëna për parametrat mjedisorë dhe indikatorët e ndotjes
- Monitoron faktorët natyrorë, ndryshimin e gjendjes mjedisore dhe kushtet në lidhje me ujin, ajrin, dheun, pyllin, biodiversitetin, zhurmën, vibrimin dhe mbeturinat;
- Harton raportet e përgjithshme dhe sektorale për gjendjen e mjedisit.

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

- Mbledhja dhe përpunimi i shënimeve lidhur me mbrojtjen e natyrës
- Harton bazën e të dhënave për llojet e bimëve, kërpudhave dhe shtazëve, tipeve të vendbanimit, ekosistemeve dhe peisazheve;
- Monitoron gjendjen e larmisë biologjike dhe peisazhore dhe propozon masat për mbrojtjen e tyre;
- Përgatit bazën profesionale për mbrojtjen e pjesëve të natyrës;
- Harton bazën profesionale për nevojat e përcaktimit të kushteve për mbrojtjen e natyrës, menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe shfrytëzimi i të mirave të natyrës;
- Kryen analiza statistikore, unifikimin e rezultateve dhe hartimin e raportit për gjendjen dhe mbrojtjen e natyrës;
- Merr pjesë në zbatimin e akteve ndërkombëtare në mbrojtjen e natyrës.

INSTITUTI HIDROMETEROROLOGJIK I KOSOVËS

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit themelor të stacioneve hidrologjike dhe meteorologjike dhe organizimi i matjeve dhe vërtetimet e elementeve dhe dukurive;
- Studimi, përpunimi, ruajtja, këmbimi dhe shpallja e të dhënave dhe rezultateve hidrometeorologjike dhe të hulumtimeve në rrjetin e monitorimit;
- Kryerja e matjeve, vërtetimeve meteorologjike me radar dhe kryerja e matjeve dhe vërtetimeve hidrometeorologjike sistematike në ujërrjedhat e lumenjve në rastet e zakonshme dhe në rastet e çrregullimeve;
- Përcjellja sistematike dhe konstatimi i ndotjes së ajrit, të reshurave atmosferike, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të burimit të parë dhe tokës, studimi dhe eprognozimi i kushteve hidrometeorologjike të ndotjes së mjedisit dhe paralajmërimi i fatkeqësive elementare hidrometeorologjike;
- Dhënia e raporteve, parashikimeve dhe paralajmërimeve të organeve kompetente qendrore dhe lokale mbi dukuritë hidrometeorologjike dhe studimi i motit, klimës, ujërave dhe ndikimit të tyre në biosferë.
- Hulumtimi i ndryshimit të motit, klimës dhe ujërave nga ndikimi artificial dhe studimi i metodave të veprimeve artificiale mbi motin, klimën dhe ujërat.

Në ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës , në nenin 20, me qëllim të zhvillimit dhe përparimit hulumtues dhe projektues, Ministria themelon **Institutin e Kosovës për Ujëra**, , si organ të pavarur. Detyra e Institutit të Kosovës për Ujëra përcaktohen me anë të Statusit për Veprimtarinë e Institutit.

Sipas Ligjit Nr. 02/L-78 dhe UA Nr. 16/2012, **Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike** është përgjegjës për monitorimin e ujit për pije.



Ndotja e ajrit si problem global kërcënon jo vetëm shëndetin njerëzor, por edhe ekosistemet në tokë. Sipas Komisionit Evropian, ndotja e ajrit është rreziku i dytë më i madh mjedisor për shëndetin e njeriut dhe radhitet menjëherë pas ndryshimeve klimatike. Edhe pse ndotja e ajrit ndikon te të gjithë, disa grupe janë më shumë të ndikuar nga pasojat që shkaktohen, siç janë: fëmijët, të moshuarit, gratë shtatzëna dhe personat me sëmundje ekzistuese. Kategorizimi i shoqërisë në bazë të të ardhurave duhet konsideruar gjithashtu meqë një shtresë më e varfër e popullsisë zakonisht jetojnë afër rrugëve të ngarkuara të transportit, në afërsi të deponive të mbeturinave e zonave industriale, që i bën ata disa herë më të ekspozuar ndaj ndotësve se pjesa tjetër e popullsisë. Varfëria energjetike është faktor i rëndësishëm në pjesën jugore, lindore

dhe qendrore të Evropës meqë imponon djegien e materialeve të ngurta të cilësisë së ulët, si druri dhe thëngjilli. Pjesa e popullsisë që i shfrytëzojnë ato i ekspozohen grimcave të pluhurit ($PM_{2.5}$ dhe PM_{10}) dhe Hidrokarbureve Aromatike Policiklike (HAP) si në hapësirat e hapura ashtu edhe në ato të mbyllura.

Ajri i ndotur është provuar të ketë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në ekosistemet natyrore dhe në biodiversitetet. Oksidet e azotit (NO_x) që janë shuma e oksidit të azotit (NO) dhe e amoniakut (NH_3) kanë ndikim në jetën e gjallesave në tokë dhe në ujë. Së bashku me dioksidin e sulfurit (SO_2), oksidet e azotit ndikojnë në aciditetin e dheut, të liqeneve dhe lumenjve, duke shkaktuar humbjen e biodiversitetit. Ozoni atmosferik (O_3) dëmton të mbjellat agrikulturore, pyjet dhe bimët duke zvogëluar shkallën e tyre të rritjes.²⁹

Janë tri cikle të rëndësishme të ndotësve të ajrit në mjedis:

- Cikli i parë përfshin procesin e emetimit, që karakterizohet me parametrat si: lloji i ndotësve, sasia, shkalla e përhapjes, temperatura, shpejtësia dhe koha e materialit të emetuar;
- Cikli i dytë është shpërndarja atmosferike e ndotësve. Ky përfshin faktorët fizikë e kimikë, si: reaksionet fotokimike dhe distanca mes burimit të ndotjes dhe zonës së ndikuar.
- Procesi i depozitimit apo fundërrimit i takon ciklit të tretë. Depozitimi nënkupton ndikimin lokal të ndotësve në mjedis. Ai varet nga kushtet e motit ose ndryshimit klimatik, siç është përmbysja e temperaturës ose e reshjeve dhe kohëzgjatja e tyre.³⁰

²⁹ EEA, Air Quality in Europe - 2020 Report

³⁰ https://www.researchgate.net/publication/320497786_SOURCES_OF_AIR_POLLUTION_ENVIRONMENTAL_IMPACTS_AND_EXPLOITATION_OF_NATURAL_RESOURCES_IN_KOSOVO (Adem Dreshaj, Bedri Millaku, Sabiha Shala, Afrim Selimaj, Halit Shabani, CBUNI.CA, 2017)

KORNIZA LIGJORE PËR CILËSINË E AJRIT

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit. Nr. 03/L-025, Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Nr. 03/L-160, dhe Ligjit për Veprimtarinë Hidrometeorologjike, Nr. 02/L-79, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës moni-

torojnë cilësinë e ajrit në Kosovë me anë të 12 stacioneve të shpërndara në disa qytete. Këto stacione monitorojnë sasinë e pluhurit grimcor (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$), NO/NO_2 , SO_2 , CO dhe O_3 , të cilat arrijnë nivelet më të larta në vitin 2019.

³¹

CILËSIA	SHUMË E MIRË	E MIRË	E MODERUAR	E PASHËN-DETSHME	E RREZIKSHME PËR SHËNDETIN
GRIMCAT E PLUHURIT MË TË VOGLA SE 2.5 μM ($PM_{2.5}$)	0-10	10-20	20-25	25-50	50-800
GRIMCAT E PLUHURIT MË TË VOGLA SE 10 μM (PM_{10})	0-20	20-35	35-50	50-100	100-1200
DIOKSIDI I AZOTIT (NO_2)	0-40	40-100	100-200	200-400	400-1000
OZONI (O_3)	0-80	80-120	120-180	180-240	240-600
DIOKSIDI I SULFURIT (SO_2)	0-100	100-200	200-350	350-500	500-1250

Tabela 12. Indeksi i cilësisë së ajrit për parametrat e monitoruar (AMMK – Raporti Vjetor për Gjendjen e Ajrit, 2019)

NDOTËSIT	PERIUDHA MESATARE	STANDARDI PËR CILËSINË E AJRIT NË KOSOVË	STANDARDI PËR CILËSINË E AJRIT NË BE	VLERA E SUGJERUAR E CILËSISË SË AJRIT NGA OBSH
PM_{10}	Mesatarja vjetore	40 $\mu g/m^3$	40 $\mu g/m^3$	20 $\mu g/m^3$
	24 orë	50 $\mu g/m^3$	50 $\mu g/m^3$	50 $\mu g/m^3$
	24 orë (pragu i informimit)	100 $\mu g/m^3$	-	-
	24 orë (pragu i vigjilimit)	100 $\mu g/m^3$	-	-
$PM_{2.5}$	Mesatarja vjetore	25 $\mu g/m^3$	25 $\mu g/m^3$	10 $\mu g/m^3$
	24 orë			
O_3	Mesatarja e maksimumit 8-orësh në ditë	120 $\mu g/m^3$ (objektiva afatgjate)	120 $\mu g/m^3$	100 $\mu g/m^3$
	1 orë (pragu i informimit)	180 $\mu g/m^3$	-	-
	1 orë (pragu i vigjilimit)	240 $\mu g/m^3$	-	-

³¹ AMMK, Raporti Vjetori për Gjendjen e Ajrit, 2019

NO₂	Mesatarja vjetore 1 orë Pragu i vigjilimit	40 µg/m ³ 200 µg/m ³ 400 µg/m ³	40 µg/m ³ 200 µg/m ³ -	40 µg/m ³ 200 µg/m ³ -
SO₂	24 orë 1 orë Pragu i vigjilimit 10 minuta	125 µg/m ³ 350 µg/m ³ 500 µg/m ³ -	125 µg/m ³ 350 µg/m ³ - -	20 µg/m ³ 500 µg/m ³ - 500 µg/m ³
CO	Mesatarja e maksimumit 8 orësh në ditë Mesatarja e maksimumit 1-orësh në ditë	10 µg/m ³ -	10 µg/m ³ -	10 µg/m ³ 30 µg/m ³
PLUMBI	Mesatarja vjetore	0.5 µg/m ³	0.5 µg/m ³	0.5 µg/m ³
BENZENET	Mesatarja vjetore	5 µg/m ³	5 µg/m ³	-

Tabela 13. Standardet e cilësisë së ajrit në Kosovë krahasuar me ato të BE-së dhe vlerat e sugjeruara nga OBSH

CILËSIA E AJRIT NË ⁵2 KOMUNËN E GJAKOVËS


Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) bën monitorimin e cilësisë së ajrit sipas mandatit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Nr. 03/L-160. Ky institut bën monitorimin e cilësisë së ajrit në disa pika të qyteteve të ndryshme, por Gjakova nuk bën pjesë në këtë listë, duke pamundësuar planifikimin dhe veprimin drejt përmirësimit të parametrave të ajrit.

Në krahasim me qytetet tjera të Kosovës, Gjakova ka ajër të pastër dhe relativisht të kontrollueshëm. Sezonat e ftohta janë ato që detyrojnë djegien e

qymyrit dhe drurit si burime për ngrohje, por faktor me rol të madh në ndotje është edhe Ngrohtorja e Qytetit "SH.A. Gjakovë" e cila si lëndë të parë për djegie përdor mazutin.³² Projekti "Smart City" i realizuar në Gjakovë ka për qëllim monitorimin e vazhdueshëm të ajrit përmes dy pikave/mjeteve të vendosura në qendër të qytetit dhe në dalje të qytetit në anën e Prizrenit. Matjet për temperaturën, dioksid karbonin, lagështinë e ajrit, shpejtësinë dhe drejtimin e erës bëhen në vazhdimësi dhe raportohen në kohë reale në webfaqen e projektit.³³

³² KGJ, Analizë e Situatës Mjedisore në Komunën e Gjakovës, 2020

³³ <http://smartcity.e-komuna.com/smartcity/public/> SmartCity Gjakovë



Harta 2. Pikat e monitorimit të cilësisë së ajrit në Gjakovë si pjesë e projektit "Smart City" (<http://smartcity.e-komuna.com/smartcity/public/map>)

Në mungesë të të dhënave dhe stacioneve për matjen e cilësisë së ajrit nga IHMK në Gjakovë, të dhënat e paraqitura më poshtë janë marrë nga webfaqe të ndryshme që bëjnë monitorimin e ajrit dhe e paraqesin atë

në kohë reale. Shumë prej tyre tregojnë vetëm Treguesin e Cilësisë së Ajrit (AQI), nivelin e dioksidit të karbonit dhe pluhurin grimcor (PM) dhe atë në historik të shkurtër për një javë, një muaj ose më së largu për gjashtë muaj.




Figura 6. Temperatura mesatare sipas dy matësve në Gjakovë për pesë vitet e fundit (<http://smartcity.e-komuna.com/smartcity/public/sensor/2>)




Figura 7. Niveli i dioksidit të karbonit në dy matësit në Gjakovë për katër vite (<http://smartcity.e-komuna.com/smartcity/public/sensor/2>)




Figura 8. Mesatarja vjetore e Indeksit për Cilësinë e Ajrit (AQI) në Gjakovë për gjashtë muajt e fundit (<https://air.plumelabs.com/air-quality-in-Gjakov%C3%AB-3jWu>)

Sipas të dhënave online, Indeksi për Cilësinë e Ajrit (AQI) merr parasysh të gjithë ndotësit në ajër dhe jep një vlerë të caktuar. Sa më e madhe vlera e këtij treguesi, aq më i lartë është niveli i ndotjes së ajrit. Ndotësit kryesorë që merren parasysh në këtë vlerë janë pluhuri grimcor ($PM_{2.5}$ dhe PM_{10}), dioksidi i azotit (NO_2) dhe ozoni (O_3). Sipas Fig. 7, 292 ditë në gjashtë muajt e fundit kanë rezultuar me cilësi të

moderuar të ajrit, me vlerë rreth 25-45 AQI, vetëm 33 ditë me cilësi shumë të mirë të ajrit, me vlerë nën 20 AQI, dhe 37 ditë me rrezikshmëri të lartë, me vlerën mbi 50 AQI. Vlerat më ekstreme të rrezikshmërisë arrijnë në ditën e fundit të muajit dhjetor dhe fillimit të muajit janar, ku niveli i pluhurit grimcor $PM_{2.5}$ arrin vlerën $43 \mu g/m^3$, PM_{10} - $63 \mu g/m^3$, NO_2 - $21 \mu g/m^3$ dhe O_3 - $33 \mu g/m^3$.³⁴

³⁴ <https://air.plumelabs.com/air-quality-in-Gjakov%C3%AB-3jWu>

Si arsye për disa nga vlerat e larta të parametrave të ndotësve në ajër për Komunën e Gjakovës konsiderohen edhe numri i madh i automjeteve dhe vendparkingjet e limituara për parkimin e tyre, mungesa e hapësirave të gjelbërta si dhe rritja e shpejtë e industrisë së ndërtimit në zonat urbane.

Në mungesë të të dhënave specifike për cilësinë e ajrit në Gjakovë nga IHMK-ja, vlerat e sipërhënuara mund t'i krahasojmë me vlerat mesatare të ndotësve të regjistruar në dy vitet e fundit në stacionin e Pejës dhe Prizrenit si regjionet më të afërta me komunën e Gjakovës.

PEJË	PARAMETRAT	PËRQËNDRIMI MESATAR PËR 2018	PËRQËNDRIMI MESATAR PËR 2019	PËRQËNDRIMI MESATAR PËR 2020	PËRQËNDRIMI MESATAR PËR 2021
	PM ₁₀	28.0 µg/m ³	30.2 µg/m ³	36.4 µg/m ³	44.5 µg/m ³
	PM _{2.5}	20.1 µg/m ³	27.5 µg/m ³	28.7 µg/m ³	37.9 µg/m ³
	NO ₂	-	13.9 µg/m ³	14.3 µg/m ³	25.1 µg/m ³
	O ₃	-	17.0 µg/m ³	35.9 µg/m ³	48.7 µg/m ³
	CO	-	0.8 mg/m ³	0.6 mg/m ³	1.0 mg/m ³

Tabela 14. IHMK - Statistikat vjetore të cilësisë së ajrit në Pejë

PRIZREN	PARAMETRAT	PËRQËNDRIMI MESATAR PËR 2018	PËRQËNDRIMI MESATAR PËR 2019	PËRQËNDRIMI MESATAR PËR 2020	PËRQËNDRIMI MESATAR PËR 2021
	PM ₁₀	23.1 µg/m ³	30.9 µg/m ³	29.6 µg/m ³	29.6 µg/m ³
	PM _{2.5}	16.6 µg/m ³	22.6 µg/m ³	22.1 µg/m ³	23.4 µg/m ³
	NO ₂	18.7 µg/m ³	14.2 µg/m ³	17.8 µg/m ³	24.2 µg/m ³
	O ₃	63.6 µg/m ³	54.4 µg/m ³	58.8 µg/m ³	50.4 µg/m ³
	CO	0.8 µg/m ³	0.8 mg/m ³	0.4 mg/m ³	0.6 mg/m ³

Tabela 15. IHMK - Statistikat vjetore të cilësisë së ajrit në Prizren



Dheu është faktor kompleks dhe kritik për jetën në tokë, pasi që përban 25% të biodiversitetit dhe prodhon 95% të ushqimit që konsumojmë. Pas vitit 2000, në Kosovë është shtuar numri i fermave dhe i tokave bujqësore e me to edhe përdorimi i plehrave për

fertilizim, kimikatet, insekticidet dhe produktet tjera me ndikim të madh në ndotjen e mjedisit. Sipas ASK-së, në vitin 2019 janë përdorur rreth 76,467 ton fertilizere të cilët përmbajnë azot dhe ky numër sa vjen e rritet në krahasim me vitet paraprake.³⁵

MENAXHIMI I TOKËS¹

Aktualisht, Kosova ka një sipërfaqe prej 10,887km², 557,000 ha prej të cilave janë toka bujqësore, 464,800 ha toka pyjore dhe 46,900 ha me destinime tjera. Janë rreth 180,000 ekonomi shtëpiake bujqësore me 80% të fermave me sipërfaqe më të vogël se 4ha dhe 0.6% të tyre me sipërfaqe

mbi 10ha. Mesatarja e fermave për familje në vend është 2.2-2.4 ha tokë e punueshme e fragmentuar në 6-8 ngastra. Për dallim nga numri i madh i fragmentimit të tokës në Kosovë, në vendet e BE-së, madhësia mesatare e fermave familjare është 19.45 ha.³⁶

TIPI I TOKËS	HA NË VITIN 2000	HA NË VITIN 2006	HA NË VITIN 2012	HA NË VITIN 2018
SIPËRFAQET ARTIFICIALE (ZONA NDËRTUESE)	24,978.47	32,919.39	50,597.97	51,057.52
ZONA BUJQËSORE	444,320.72	439,971.2	416,336.95	416,167.22
PYJET DHE FUSHAT GJYSMËNATYRORE	618,895.06	614,290.59	621,110.61	620,819.78
TOKA TË LAGËTA	0	985.101	131.348	131.348
TRUPAT UJORË	2,323.47	2,351.43	2,340.84	2,340.84
GJITHSEJ	1,090,517.7	1,090,517.7	1,090,517.7	1,090,517.7

Tabela 16. Përdorimi i tokës (ha) sipas viteve 2000, 2006, 2012, 2018 (AMMK, Mjedisi i Kosovës – Raport i Treguesve Mjedorë, 2020)

³⁵ AMMK, Mjedisi i Kosovës – Raporti i Treguesve Mjedorë, 2020

³⁶ MBPZHR, Strategjia për Konsolidimin e Tokës 2010-2020, 2010

Në vitin 1979, në Kosovë filloi programi i komasacionit të tokave i mbështetur nga Banka Botërore. Rregullimi i tokës bujqësore me komasacion është aplikuar në komunat që janë nën rrjetat e sistemeve ujitëse "Ibër Lepenc" dhe "Radoniqi". Rregullimi i tokave në sistemin e ujitjes "Radoniqi"

është bërë në Prizren në 6 zona, në Rahovec në 11 zona dhe në Gjakovë në 16 zona kadastrale. Ky program mbeti i papërfunduar që nga vitet 80-të dhe shumë toka u kthyen në gjendjen e mëparshme ose u përballën me ndryshime tjera.

KORNIZA LIGJORE PËR MBROJTJEN E TOKËS

Meqë formimi i dheut është proces shumë i ngadalshëm, dheu duhet të konsiderohet burim i papërtërishëm. Prandaj, dheu është faktori më i rëndësishëm për prodhimin bujqësor dhe sigurinë e ushqimit, natyrës e ruajtjes së biodiversitetit dhe për uljen e efekteve të ndryshimeve klimatike dhe adaptimit ndaj tyre. Politika e Bashkimit Evropian mbi dheun dhe mbrojtjen e tij mbështetet në disa direktiva të aprovuara mbi emetimet industriale, përgjegjësinë mjedisore, vlerësimin e ndikimeve në mjedis, menaxhimin të ujërave të zeza, përdorimit të plehrave artificiale, të merkurit dhe mbi rregullimin e shfrytëzimit të tokës.³⁷

Si përgjigje ndaj krizës klimatike dhe ndikimeve të saj në mjedis, Bashkimi Evropian ka miratuar një Strategji Tematike për Mbrojtjen e Dheut, e cila identifikon kërcënimet kryesore të tokës, si: erozioni, vërshimet dhe rrëshqitja e dheut, zvogëlimi i materieve organike, kripëzimi, ngjeshja, ndotja dhe humbja e biodiversitetit të dheut. Kjo strategji përmban komunikimin nga Komisioni të institucionet tjera evropiane, propozimin për kornizat e direktivave dhe vlerësimin e ndikimeve në tokë.

Në Kosovë, menaxhimi i tokës rregullohet përmes ligjit kryesor për mbrojtjen e mjedisit, Nr.03/L-025, dhe përmes dy ligjeve tjera specifike, si: Ligji për tokën bujqësore, Nr.02/L-26, dhe ligji për rregullimin e tokës, Nr.04/L-040. Përderisa ligji për mbrojtjen e mjedisit parasheh sistem të integruar për mbrojtje, zvogëlim të rrezikut për ndotjen e mjedisit, të jetës dhe shëndetit të njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, ligji për tokën bujqësore thekson rëndësinë e shfrytëzimit, mbrojtjes, rregullimit dhe qiradhënies së tokës bujqësore me qëllim të ruajtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme dhe të qëndrueshme. Përgjegjësitë e institucioneve ndaj rregullimit të tokave, ndërmarrjes së masave për zmadhimin e tokave bujqësore, pyjeve dhe tokave pyjore për shfrytëzim racional dhe ekonomik, si dhe planifikimi e financimi i proceseve definohehen përmes ligjit për rregullimin e tokës. Në kuadër të angazhimeve të qeverisë, ajo ka miratuar Strategjinë për Konsolidimin e Tokës 2010-2020, e cila ka për qëllim sigurimin e shfrytëzimit racional të tokës bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe mbështetjen për zhvillimin e bujqësisë.

³⁷ https://ec.europa.eu/environment/soil/index_en.htm#:~:text=At%20the%20moment%2C%20only%20a

MONITORIMI I CILËSISË SË TOKËS

Monitorimi i gjendjes së mjedisit dhe emetimeve në mjedis ku përfshihet edhe dhe është përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor sipas ligjit për mbrojtjen e mjedisit. Megjithatë, në Kosovë nuk ka sistem të monitorimit të cilësisë së tokës (dheut). Studimi i vetëm mbi ndotjen e tokës bujqësore në Kosovë është bërë në vitin 2013 si pjesë e projektit me të njëjtin titull nga GIZ IS (DE) dhe NIRAS (PL), raport ky i cili nënvizon detyrat dhe aktivitetet kryesore të kryera me propozime për të ardhmen. Ky studim përfshiu vetëm 17 komuna të Kosovës, duke mos përfshirë komunën e Gjakovës. Në këtë raport përmenden “pikat e nxehta” mjedisore apo hotspotet si zona me potencial të lartë të ndotjes të cilat

janë identifikuar dhe klasifikuar në raportin e vitit 2011, Hotspotet Mjedisore në Kosovë, të hartuar nga MMPH dhe AMMK. Në kuadër të një programi rehabilitimi të viteve 2007-2009, është bërë mbyllja dhe rehabilitimi i disa deponive të vjetra komunale, si ajo në Gjakovë në vitin 2007. Këto “pika të nxehta” apo hotspotet përfshijnë 28 pika me sipërfaqe prej 9.94km² apo 0.09% të territorit të Kosovës.³⁸ Ato kategorizohen si: Hotspotet nga kimikatet, nga aktivitetet bujqësore, nga sektori i transportit, nga deponitë sanitare, nga sektori i industrisë, nga sektori minerar dhe nga materiet radioaktive. Në Gjakovë, si njëra nga komunat më të prekura nga hotspotet, janë identifikuar deponitë e flotacionit nga fabrika e pasurimit në Devë. Që nga fundi i Luftës së II-të Botërore e deri në vitin 1956, xehet e kromit shfrytëzoheshin nga “Deva Holding Company”. Kjo deponi ka ndikim të madh negativ në shëndetin publik dhe në mjedis, duke kontaminuar ujërat, ajrin dhe tokën me xeherore të kromit. Këto xehe gjenden në disa lokacione, por vendburimet e tyre janë në sipërfaqe të vogla. Ato paraqiten më së shumti në pjesën lindore të masivit dhe zonën perëndimore mes fshatrave Petkoviq dhe Labuçevë. Kromi ka përbërje kimike të Cr₂O₃ me pjesëmarrje 35-55%, Al₂O₃ me 8-23% dhe FeO rreth 13%. Kjo deponi kromi ka sipërfaqe prej 5.23 ha dhe vlerësohet si burim i ndotjes me metale të rënda që dëmton mjedisin dhe prek rrjedhat ujore të zonës.



Harta 3. Zona e kontaminuar “hot spot” në Devë të Gjakovës (MMPH, AMMK, Raport Hotspotet mjedisore në Kosovë, 2011)

³⁸ MMPH, AMMK, Raport Hotspotet Mjedisore në Kosovë, 2011

NR	VENDI	AKTIVITETI	SIPËRFAQJA	BURIM POTENCIAL I NDOTJES – METALE TË RËNDA
1	FLOTACIONI I MINIERËS SË KROMIT NË DEVË	DEPONIA E METALEVE TË RËNDA	5.23 HA	✓

Tabela 17. Deponia e flotacionit të minierës në Devë, Gjakovë (MMPH, AMMK, Raport Hotspotet mjedisore në Kosovë, 2011)

Sot, rajoni i Gjakovës nuk ka më rezerva të xeheve të kromit, por besohet se në lugun Boka e Gjonit gjindet rezerva prej 100,000 ton të kategorive A+B me rreth 16% Cr₂O, kurse në vjën Ponoshec-Morinë ndodhen vendburime të kromit me përmbajtje Cr₂O₃ prej 20-30%. Në masivin e serpentinit të Gjakovës janë gjetur vendburime të merkurit në vlera me diapazon prej 220-760 ppml nga 10 mostra të mbledhura në Devë, Popovc, Goden dhe në rrëzën veriore të malit Pashtrik. Në zona të afërta, në Pashtrik, Devë, Ponoshec-Popovc, Sukë të Crmjanit, Sukë të Radoniqit dhe në Hereq, janë gjetur poashtu edhe pika të mineralizimeve të bakrit, edhe pse jo

në përqëndrim të mjaftueshëm për të sugjeruar hapjen e një miniere. Sa i përket qymyrit dhe linjtit, rajoni i Gjakovës ka një vendburim cilësor të klasës së III-të në Kosovë. Qymyri përmban hir 17-21%, lagështi 44% dhe fuqi kalorike 58600-7530 kJ/kg. Zonë me potencial të rezervave të mineralizimit të linjtit konsiderohet pjesa veriore e komunës së Gjakovës, fshati Jabllanicë me rrethinë.

Sa i përket përshtatshmërisë së tokës bujqësore (bonitetit) në Gjakovë, tokat janë klasifikuar në tri kategori:

Tokë e mirë – Klasa I, II, III 40%; **Tokë e mesme** – Klasa IV, V 20%; **Tokë e varfër** – Klasa V, VI 40%.³⁹

DEGRADIMI I TOKËS⁴ DHE SHKAKTARËT

Zgjerimi i pakontrolluar urban, ndotja mjedisore dhe dëmtimi i burimeve natyrore janë disa nga faktorët që përfshihen në menaxhimin e tokës. Degradimi i tokës është term që nënkupton keqpërdorimin e tokës, ujit,

bimësisë, ajrit, klimës dhe relievit. Rënia e prodhimit bujqësor dhe prezantimi i përbërësve të dëmshëm kimikë që ndikojnë edhe në shëndetin e njeriut janë gjithashtu faktorë të degradimit të tokës.

³⁹ KGJ, Profili Komunal i Komunës së Gjakovës, 2020

Llojet e degradimit të tokave përfshijnë:

- **Erozioni** i shkaktuar nga uji ose era;
- **Ulja e pjellorisë** në mungesë të materies organike dhe ushqyese, degradimit të vetive fizike dhe ndotjeve nga plehurat, pesticidet dhe uji i ndotur;
- **Moqalizimi** si pasojë e ngritjes së nivelit të ujërave nëntokësorë, ujitjes jopërkatese ose kullimit jo të mirë;
- **Kripëzimi** me koncentrim të madh të kriprave si pasojë e ujërave të ndotura ose të kripëzuara;
- **Sedimentimi** si pasojë e vërshimeve që bartin materie të ndryshme nga uji;

- **Ulja e nivelit të ujit nëntokësor** nga shfrytëzimi i madh i tyre;
- **Zhveshja nga vegjetacioni** i tokave e shkaktuar nga prerja e pyjeve, ndërrimit të destinimit të tokës dhe aktivizimi i erozionit.⁴⁰

Shkaktarët kryesorë të degradimit të tokës janë shfrytëzimi i papërshtatshëm i tyre, ndërrimi i destinimit të përdorimit, përdorimi i lartë i pesticideve dhe plehrave artificiale, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve natyrore, si: pyjet, ujërat, gurët dhe zhavori, mineralet. Në Gjakovë, deponitë ilegale të mbeturinave dhe urbanizmi i pakontrolluar janë disa nga shaktarët kryesorë të degradimit të tokave.

EROZIONI I DHEUT DHE SEDIMENTIMI

Erozioni i dheut është një nga faktorët me rol më të madh në degradimin e tokës dhe ndodh si pasojë e heqjes së shtresës së sipërme të tokës nga sipërfaqja, e cila dihet se përmban materie të nevojshme organike për fertilitet dhe rritje të qëndrueshme të vegjetacionit. Me heqjen e kësaj shtrese, toka humbet përbërësit organikë që si pasojë zvogëlojnë biomasën bimore dhe e kthejnë atë në tokë të djerrë. Shkaktarë kryesorë për një degradim të tillë janë aktivitetet ndërtimore, me rastin e hapjes së themeleve, transportimit të materialeve të ndërtimit nga toka të grupuara që e bëjnë dheun më lehtë të rrëshqitshëm dhe të prirur për erozion. Minimi, nxjerrjave e ujërave nëntokësore, projektet e ndërtimit të rrugëve, rezervoaret e ujit, gur-

gdhendja dhe shfrytëzimi i tepërt i një toke për kullrosjen e kafshëve janë disa nga faktorët aktualë dhe potencialë për erozion të dheut.

Përderisa erozioni përfshin shkëputjen, transportimin dhe depozitimin e dheut, sedimenti transportohet nga rrjedhat e ujit në pjerrtësira me rastin e reshjeve. Në zonat me pjerrtësi të ulët, sedimenti depozitohet duke filluar nga gurët me madhësinë më të madhe, ndërsa agregatet e vogla vazhdojnë të pëcillen tutje. Për këtë arsye, madhësia e sedimentit ka rëndësi në procesin e erozionit dhe depozitimit të dheut.⁴¹

Në komunën e Gjakovës, zonat e rrezikuara nga erozioni janë: Botushë – Brovinë, Morinë – Popoc, Goden – Pjetërshan dhe Moglicë.

⁴⁰ KGJ, Plani Lokal i Veprimt në Mjedis 2018-2023

⁴¹ <https://www.sciencedirect.com/topics/engineering/erosion>

RRËSHQITJA E DHEUT

Rajoni i Rrafshit të Dukagjinit ka llojllojshmëri litostratigrafike, me përbërje komplekse të terrenit. Si aktivitete të shpeshta të tokës janë shpëlarja e shpejtuar dhe gërryerjet, rrëketë me rrëshqitje dhe shembje të dheut, me ç'rast barten materialet sterile. Rrëshqitjet, të cilat ndodhin më

së shumti në periudhën e pranverës, mars-prill, në vjeshtë, tetor-nëntor-dhjetor dhe në atë dimërore, janar-shkurt, shkaktohen nga aktivitetet njerëzore, si: gërmimet me rastin e aktiviteteve ndërtimore, ndryshimet e destinimit të tokës dhe nga kombinime tjera natyrore e njerëzore.⁴²



Kosova ka numër të kufizuar të burimeve të ujit të freskët dhe kjo mungesë paraqet rrezik për të ardhmen e afërt, duke konsideruar ndryshimet klimatike dhe rritjen e temperaturave e me to edhe thatësinë. Burimet kryesore të furnizimit me ujë

të freskët janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë, në pesë pellgje lumenjsh: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës, Lepenci dhe Pellgu i Plavës. Furnizimi mesatar vjetor për një person në Kosovë është rreth 1,600 m³/person/vit.⁴³

KORNIZA LIGJORE DHE STRATEGJIKE E UJËRAVE

Kosova i është qasur afrimit të standardeve mjedisore të BE-së dhe po punohet në zhvillimin e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi, duke përfshirë edhe mbrojtjen e

ujërave. AMMK gjithashtu ka punuar edhe në adaptimin e legjislacionit sekondar që përfshin udhëzimet administrative, rregulloret dhe vendimet.

⁴² KGJ, Profili Komunal i Komunës së Gjakovës, 2020

⁴³ AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Republikën e Kosovës, 2015

DIREKTIVAT E BASHKIMIT EVROPIAN PËR UJËRA

Në vendet e BE-së, menaxhimi i ujërave rregullohet përmes tetë direktivave të përshkruara më poshtë:

1. Direktiva kornizë për ujërat **(2000/60/EC)** – e ratifikuar më 23 tetor 2000
Kjo direktivë ka për qëllim mirëmbajtjen e “statusit të lartë” të ujit aty ku ekziston duke parandaluar çdo keqësim të gjendjes ekzistuese të ujërave dhe arritjen e së paku “statusit të mirë” në raport me të gjitha ujërat deri në 2015.
Qëllimi i kësaj direktive është që të ruajë, të mbrojë dhe të përmirësojë cilësinë e mjedisit dhe të plotësojë Direktivën 2000/60/EC për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.
2. Direktiva për ujërat e ndotura urbane **(91/171/EEC)** – e ratifikuar më 21 maj 1991
Në këtë direktivë parashihet mbrojtja e ujërave nga efektet negative nga shkarkimet e ujërave të zeza urbane nga disa sektorë industrialë.
Direktiva e standardeve mjedisore në fushën e politikave të ujit **(2008/105/EC)** – e ratifikuar më 16 dhjetor 2008
Në përputhje me Nenin 1 të kësaj direktive dhe Nenin 4 të Direktivës 2000/60/EC, Shtetet Anëtare do të zbatojnë WQS të përcaktuara në pjesën A të shtojcës I-rë të kësaj direktive për trupat e ujërave sipërfaqësore.
3. Direktiva për ujin e pijes **(98/83/EC)** – e ratifikuar më 3 nëntor 1998
Të mbrohet shëndeti i njeriut nga efektet e padëshiruara të çfarëdo kontaminimi të ujit që synohet të përdoret për konsum njerëzor, duke siguruar që uji i pijshëm është i shëndetshëm dhe i pastër.
Direktiva Specifikimi teknik i analizave kimike dhe monitorimi i statusit të ujërave **(2009/90/EC)** – e ratifikuar më 31 korrik 2009
Planet e menaxhimit të rrezikut të përmbytjeve do të adresojnë të gjitha aspektet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duke u fokusuar në parandalimin, mbrojtjen, gatishmërinë e duke përfshirë edhe parashikimet e përmbytjeve dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm sipas karakteristikave të pellgut lumor të veçantë ose nën-pellgut.
4. Direktiva për nitratet **(91/676/EEC)** – e ratifikuar më 12 dhjetor 1991
Parasheh reduktimin e ndotjes së ujërave që shkaktohet nga nitratet nga burimet bujqësore dhe parandalimi i mëtutjeshëm i ndotjes së tillë.
Direktiva për ujërat nëntokësore **(2006/118/EC)** – e ratifikuar më 12 dhjetor 2006
Kjo direktivë parasheh mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga përkeqësimi dhe ndotja kimike. Kjo direktivë paraqet rëndësi për ekosistemet e ujërave nëntokësore të varura dhe për përdorimin e ujërave nëntokësore në furnizimin me ujë për konsum njerëzor.
5. Direktiva për menaxhimin e cilësisë së ujit për larje **(2006/7/EC)** – e ratifikuar më 15 shkurt 2006

INFRASTRUKTURA LIGJORE PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE NË KOSOVË

Baza ligjore e rregullimit të ujërave në Kosovë përbëhet nga legjislacioni primar dhe sekondar. Legjislacioni primar përmban këto ligje:

Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës

– që ka për qëllim të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve ujore të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin shoqëror-ekonomik të Kosovës; Të themelojë procedurat dhe parimet udhëzuese për shpërndarjen optimale të burimeve ujore sipas shfrytëzimit dhe qëllimit; Të sigurojë mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, mbi-shfrytëzimi dhe keqpërdorimi; Të përcaktojë kornizën institucionale për administrimin e burimeve ujore.

Ligji Nr. 02/L-79 për Veprimtarinë Hidrometeorologjike – ka për qëllim të rregullojë punët hidrometeorologjike dhe mënyrën e kryerjes së tyre.

Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike – përcakton institucionet përgjegjëse për zbatimin e politikave në shëndetësi, përcakton detyrat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe detyrat për monitorimin e kualitetit të ujit të pijes.

Ligji Nr. 03/L-086 për Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit, Kanalizimit dhe Mbeturinave – themelon Zyrën Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) dhe krijon kornizën ligjore për rregullimin ekonomik të kompanive publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Ligji Nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore – rregullon organizimin dhe administrimin e ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore në Kosovë, ndarjen e përgjegjësisë të subjekteve të ujitjes dhe kullimit, formimin dhe regjistrimin e kompanive të ujitjes, tarifat e ujit për ujitje, afarizmin e shoqatave dhe çështjet tjera lidhur me ujitjen dhe kullimin.

Legjislacioni sekondar përmban udhëzime administrative të dala nga Ligji për Ujëra dhe Ligji për Shëndetin Publik:

Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 – kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik në trupin ujqor;

Udhëzimi Administrativ Nr.26/2013 – përcaktimi i mënyrës së evidentimit dhe formës së legjitimacionit të inspektoratit për ujëra;

Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2013 – për sistemin informati ujqor;

Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2012 – për cilësinë e ujit që përdoret për konsum nga njerëzit;

Udhëzimi Administrativ Nr. 28/2013 – për Zonat e Mbrojtura Sanitare;

Udhëzimi Administrativ Nr. 24/05 – mbi përmbajtjen, formën, kushtet dhe procedurën e lëshimit dhe mbajtjes së lejes ujore;

Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2006 – për strukturën e pagesave të ujit.

UJËRAT SIPËRFAQËSORE⁷²

Sipas Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, ujërat sipërfaqësore përfshijnë ujërat e brendshme, përveç ujit nëntokësor, ujërat e përkohshme dhe ujërat bregdetare, me përjashtim të statusit kimik për të cilin ai duhet të përfshijë gjithashtu ujërat territoriale⁴⁴

Lumenjtë me prurjen më të madhe brenda vitit janë në Pellgun e Drinit të Bardhë në Rrafshin e Dukagjinit. Monitorimi i ndotjes së ujërave në Kosovë bëhet vetëm për rrjedhat e lumenjve, ndërkohë që në kategori-

zimin kategorizimin e ujërave sipërfaqësore hyjnë edhe liqenet, duke përfshirë edhe ato artificiale të cilat u akumuluan pas viteve të 70-ta nga nevoja për furnizim me ujë të pijshëm. Me shtimin e popullatës, grumbullimi i ujit nga lumenjtë u bë i domosdoshëm jo vetëm për furnizim me ujë të pijshëm, por edhe për përdorim në industri e bujqësi.

Akumulimet kryesore në Kosovë janë: Liqeni Gazivoda, Liqeni i Batllavës, Liqeni i Badovcit, Liqeni i Liçovit, Liqeni i Radoniqit dhe Liqeni i Përlepticës.

REZERVUARI	LUMI	SIP. E UJËMBLEDHËSIT	SHFRYTËZUES VËLLIMI MILION (M3)	GJITHSEJ VËLLIMI MILION (M3)	VITI I NDËRTIMIT
RADONIQ	Përrua	130	102	116.6	1982

LARTËSIA E DIGËS (M)	TERRITORI I UJITUR NGA SISTEMI	PËR UJITJE	UJË TË PIJES	INDUSTRI
61	Gjakovë Rahovec Prizren	10,000 ha	PO	JO

Tabela 18. Karakteristikat e Liqenit të Radoniqit - Gjakovë (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Republikën e Kosovës, 2015)

⁴⁴ Ligji për Ujërat e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>

MONITORIMI I CILËSISË SË^{7.3} UJËRAVE SIPËRFAQËSORE NË KOMUNËN E GJAKOVËS

Territori i komunës së Gjakovës ka rezerva të kufizuara të burimeve të ujërave dhe shumë prej tyre janë shumë të ndotura, e cila shkaktohet kryesisht nga shkarkimet e ujërave të zeza sanitare dhe ujërave industriale,

edhe pse industria në Gjakovë është pak aktive. Lumenjtë dhe rrjedhat ujore në territorin e Gjakovës i përkasin pellgut ujqor të Drinit të Bardhë: Lumi Erenik, Lumi Krena dhe Lumi Trakaniq.

LUMI	SIP. (S) KM ²	GJATËSIA E LUMIT (L) KM	PRURJA (Q) M ³ /S	(Q) SEK/KM ²	PJERRTËSIA %
ERENIK	519.3	51.74	12.16	26.73	3.9


PERIMETRI I PELLGUT (KM)	RRJEDHJA VJETORE x10 ⁶ (M ³)	RESHJET EFEKTIVE (MM)	RESHJET MESATARE (MM)	DERDHJA
109	383.04	841.8	1515	Deti Adriatik

Tabela 19. Të dhënat për lumin Erenik në Gjakovë (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Republikën e Kosovës, 2015)

Pellgu i Drinit të Bardhë përfshin 10 lumenj me 23 stacione monitoruese (10 stacione janë referente dhe monitorohen 2 herë në vit, ndërsa 13 janë stacione përgjatë rrjedhjes së lumenjve dhe monitorohen 11 herë në vit). Stacioni i parë i monitorimit të cilësisë së ujit në Lumin Erenik ndodhet në bjeshkët mbi fshatin Jasiq të komunës së Junikut, ku nuk ka ndikim nga veprimi njerëzor.

Stacioni i dytë është i vendosur afër takimit me lumin e Drinit të Bardhë, te Ura e Terzive, ku cilësia e ujit është shumë e ulët nga sasia e detergjentëve dhe e cila shkakton një shkumë të vazhdueshme në sipërfaqen e lumit. Këtë ndikim supozohet ta kenë veprimtaritë për pastrimin kimik të rrobave, autolarjet ose industritë që veprojnë përreth.⁴⁵

⁴⁵ AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Republikën e Kosovës, 2015



Harta 4. Stacionet për monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore, Gjakovë (IHMK)

Parametrat e monitoruar në stacionet matëse në Gjakovë përfshijnë: Lagështinë relative – Rh (%); Sasinë e reshjeve (mm); Shtypjen e ajrit (hPa); Temperaturën kontinuele (°C); Shpejtësinë dhe drejtimin e erës (m/s); Radiacionin (W/m²).

Më poshtë janë paraqitur vlerat mesatare vjetore të parametrave në pellgun e Lumit të Drinit të Bardhë, të cilat janë të pandryshueshme si në hyrje edhe në dalje të tij.

PARAMETRAT	SIMBOLI	NJËSIA	SHPESHTËSIA E MATJEVE/VIT	VLERAT KUFITARE BAZUAR NË UA NR. 30/2014
PARAMETRAT FIZIKË				
Përçueshmëria elektrike	x	μScm-1	11	
Përqëndrimi i jonit hidrogjen	pH	0-14		6.5 ≤ pH ≤ 9.0
PARAMETRAT KIMIKË				
Oksigjjeni i tretur	OT	mg/l O ₂	11	
Shpenzimi biokimik i oksigjenit	SHBO ₅	mg/l O ₂	11	2mg/l O ₂
Azoti i nitrateve	N-NO ₃	mg/l N	11	
Azoti i nitriteve	N-NO ₂	mg/l N	11	0.6mg/l
Azoti i amoniumit	N-NH ₄	mg/l N	11	
Fosfori i ortofosfateve	P-PO ₄₃	mg/l P	11	1.0
Fosfori total (poli+orto)	Ptot.	mg/l	11	2 mg/l

Tabela 20. Parametrat e Drinit të Bardhë – Vlerat mesatare vjetore (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

Oksigjeni i tretur (O₂ tretur) është masë për sasinë e tretur të oksigjenit në ujë, sasi e cila mundëson jetën e

organizmave të ujit. Përmes sasisë së oksigjenit të tretur mund të kuptohet shumë rreth cilësisë së ujit.⁴⁶




Figura 9. Oksigjeni i tretur mg/l O₂ (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

VLERA MESATARE	VITI I MONITORIMIT			
	2010	2011	2012	2013
Minimale	/	5.99 mg/l O ₂	6.61 mg/l O ₂	5.92 mg/l O ₂
Maksimale	7.5 mg/l O ₂	8.99 mg/l O ₂	10.22 mg/l O ₂	10.53 mg/l O ₂

Tabela 21. Vlera e oksigjenit të tretur për katër vite (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

⁴⁶ https://www.usgs.gov/special-topic/water-science-school/science/dissolved-oxygen-and-water?qt-science_center_objects=0#

Shpenzimi biokimik i oksigjenit (SHBO₅) është sasia e oksigjenit të tretur që nevojitet ose kërkohet për organizmat biologjikë aerobikë në mënyrë që të bëjnë shpërbërjen e materieve organike prezente në ujë me

temperaturë dhe kohë specifike. Vlera e SHBO₅ shprehet në miligram të oksigjenit të konsumuar për një litër ujë mostër në periudhë inkubimi prej pesë ditësh, në temperaturë 20 °C.⁴⁷




Figura 10. Shpenzimi biokimik i oksigjenit mg/l O₂ (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

VLERA MESATARE	VITI I MONITORIMIT			
	2010	2011	2012	2013
Minimale	/	/	2.22 mg/l O ₂	2.25 mg/l O ₂
Maksimale	7.81 mg/l O ₂	6.20 mg/l O ₂	6.95 mg/l O ₂	6.25 mg/l O ₂

Tabela 22. Vlera e shpenzimit biokimik të oksigjenit për katër vite (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

⁴⁷ <https://www.eea.europa.eu/data-and-maps/indicators/oxygen-consuming-substances-in-rivers/oxygen-consuming-substances-in-rivers-10>

Përçueshmëria elektrike (PE) është aftësia e ujit për të përcjellë rrymën elektrike. Jonet në ujë e mundësojnë këtë dhe sa më e lartë sasia e kripës në ujë, aq më e lartë është aftësia për përcimin e rrymës elektrike. Rëndësia

e këtij parametri qëndron në identifikimin e ndryshimeve në ujë, si në rastin e ndërhyrjes së ujërave të kripura, por edhe për të përcaktuar nivelin e ndotjes të ujërave të freskëta në mjedis.⁴⁹




Figura 11. Përçueshmëria elektrike μScm^{-1} (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

VLERA MESATARE	VITI I MONITORIMIT			
	2010	2011	2012	2013
Minimale	101.6 μScm^{-1}	112 μScm^{-1}	166 μScm^{-1}	99.5 μScm^{-1}
Maksimale	689 μScm^{-1}	769 μScm^{-1}	695 μScm^{-1}	730 μScm^{-1}

Tabela 23. Vlera e përçueshmërisë elektrike për katër vite (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

⁴⁹ <https://www.aquaread.com/blog/what-is-electrical-conductivity-and-why-is-it-important/>

Përqëndrimi i jonit hidrogjen (pH) është parametër për të caktuar sa acidik/bazik është uji. Shkalla e aciditetit shkon prej 0 deri në 14, ku 7 është vlera neutrale. pH-të më të ulëta

se 7 tregojnë aciditet, kurse ato më të larta se 7 tregojnë bazë. Ky është parametër me shumë rëndësi në përcaktimin e kualitetit të ujit.⁴⁹




Figura 12. Përqëndrimi i jonit hidrogjen në ujë pH (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

VLERA MESATARE	VITI I MONITORIMIT			
	2010	2011	2012	2013
Minimale	7.74	7.45	7.80	7.94
Maksimale	8.34	8.55	8.30	8.39

Tabela 24. Vlera e përçueshmërisë elektrike për katër vite (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

⁴⁹ https://www.usgs.gov/special-topic/water-science-school/science/ph-and-water?qt-science_center_objects=0#qt-science_center_objects

Azoti i nitateve (N-NO₃-) është përbërës inorganik që mund të krijohet në kushte natyrore apo artificiale. Nitratat në ujn e pijshëm maten përmes sasisë së azotit prezentë ose të azotit dhe të oksigjenit bashkë. Atë mund të gjenden në ujërat

sipërfaqësore dhe ato nëntokësore si pasojë e aktiviteteve bujqësore dhe të shkarkimit të ujërave të zeza. Standardi për limitin e prezencës është 10 mg/l, dhe çdo sasi mbi këtë vlerë mund të jetë e rrezikshme për fëmijët e vegjël.⁵⁰




Figura 13. Azoti i nitateve në ujë N-NO₃- (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

VLERA MESATARE	VITI I MONITORIMIT			
	2010	2011	2012	2013
Minimale	/	/	/	/
Maksimale	1.973 mg/l N-NO ₃	2.363 mg/l N-NO ₃	1.825 mg/l N-NO ₃	4.848 mg/l N-NO ₃

Tabela 25. Vlerat e azotit të nitateve për katër vite (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

⁵⁰ <http://psep.cce.cornell.edu/facts-slides-self/facts/nit-heef-grw85.aspx>

Azoti i nitriteve ($N-NO_2^-$) në ujë është i padallueshëm pasi që nuk ka erë, shije, apo ngjyrë dhe ndodh natyralisht në ujërat sipërfaqësore, zakonisht në nivele që nuk ndikojnë shumë në cilësinë e ujit. Azoti i nitriteve mund të përcillet shumë lehtë në ujë nga derdhjet e plehrave apo mbeturinave, prandaj testimi vjetor është i

domosdoshëm. Rrezikshmëria nga konsumimi i ujit të prekur nga azoti i nitriteve qëndron te tretja e tij në trupin e njeriut, e cila oksidon hekurin në hemoglobinën e qelizave të kuqe të gjakut duke e pamundësuar përcjelljen e oksigjenit në qelizat individuale në trup. Standardi për rrezikshmëri është nën 1 mg/L, si vlerë maksimale.⁵¹




Figura 14. Azoti i nitriteve në ujë $N-NO_2^-$ (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

VLERA MESATARE	VITI I MONITORIMIT			
	2010	2011	2012	2013
Minimale	0.009 mg/l $N-NO_2^-$	/	/	/
Maksimale	0.163 mg/l $N-NO_2^-$	/	/	0.275 mg/l $N-NO_2^-$

Tabela 26. Vlerat e azotit të nitriteve për katër vite (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

⁵¹ <https://water-research.net/index.php/nitrate>

Azoti i amoniumit ($N-NH_4^+$) është gjendja e jonizuar e amoniakut dhe përdoret si parametër për të përcaktuar cilësinë e ujit. Është përbërësi i preferuar i bimëve që ndihmon rritjen e tyre. Mund të shndërrohen në nitate dhe nitrite nga bakteret dhe pastaj të përdoret në

bimë. Njihet edhe si një nga ndotësit më të mëdhenj pasi që mund të gjindet gati kudo por është edhe materie toksike. Toksiciteti i tij varet nga pH-ja dhe temperatura, pasi që me rritjen e pH-së ose të temperaturës, NH_4^+ kthehet në gjendjen e pajonizuar NH_3 dhe rrit toksicitetin e tij.⁵²




Figura 15. Azoti i amoniumit në ujë $N-NO_4^+$ (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

VLERA MESATARE	VITI I MONITORIMIT			
	2010	2011	2012	2013
Minimale	0.132 mg/l $N-NO_4^+$	0.015 mg/l $N-NO_4^+$	0.015 mg/l $N-NO_4^+$	0.116 mg/l $N-NO_4^+$
Maksimale	2.072 mg/l $N-NO_4^+$	/	/	3.144 mg/l $N-NO_4^+$

Tabela 27. Vlerat e azotit të amoniumit për katër vite (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

⁵¹ https://www.waterboards.ca.gov/water_issues/programs/swamp/docs/cwt/guidance/3310en.pdf

Fosfori i ortofosfateve (P-P043-) i formuar nga procese natyrore, shpesh ndikohet edhe nga aktivitetet njerëzore

si derdhjet e plehrave inorganike bujqësore dhe ujërave të zeza.




Figura 15. Azoti i amoniumit në ujë N-NO₄⁺ (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

VLERA MESATARE	VITI I MONITORIMIT			
	2010	2011	2012	2013
Minimale	0.003 mg/l P-PO ₄ ³⁻	0.003 mg/l P-PO ₄ ³⁻	0.003 mg/l P-PO ₄ ³⁻	0.005 mg/l P-PO ₄ ³⁻
Maksimale	0.186 mg/l P-PO ₄ ³⁻	/	/	0.394 mg/l P-PO ₄ ³⁻

Tabela 28. Vlerat e fosforit të ortofosfateve për katër vite (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

Fosfori total (poli+orto) është mënyrë për matjen e fosfateve në ujë duke përfshirë ortofosfatet dhe fosforin në copat e mbetura në ujë të bimëve apo

kafshëve. Nivelet e fosforit total janë më stabile dhe matjet vjetore tregojnë cilësinë dhe gjendjen e ujit.⁵³




Figura 17. Fosfori total në ujë P-PO43- (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

MONITORIMI I METALEVE TË RËNDA NË UJËRA

IHMK-ja ka filluar monitorimin e metaleve të rënda në ujëra që nga viti 2008, me shkëputje deri në vitin 2011, prej ku kemi matjet e vazhdueshme.

Disa nga elementet e rrezikshme të gjetura përfshijnë: Pb, Cd, Cu, Ni, si dhe ato të nevojshme si: Fe, Zn, Mn, dhe Cr.⁵⁴

NR.	METALI	SIMBOLI	NJËSIA MATËSE	VML (VLERA MESATARE E LEJUAR)
1	Kadmiumi	Cd	µg/l	5
2	Kromi	Cr	µg/l	50
3	Mangani	Mn	µg/l	50
4	Hekuri	Fe	µg/l	200
5	Nikeli	Ni	µg/l	20
6	Plumbi	Pb	µg/l	10
7	Bakri	Cu	µg/l	1000
8	Zinku	Zn	µg/l	3000

Tabela 29. Vlerat maksimale të lejuara për metalet e rënda në ujërat sipërfaqësore

⁵⁴ AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Republikën e Kosovës, 2015

Metali mangan Mn^{2+} ka tejkaluar vlerën mesatare të lejuar në vitin 2011, 2012 dhe 2013 në rrjedhat e lumenjve

Ereniku - Ura e Terzive dhe Rimnik - Xërxë.




Figura 18. Prezenca e manganit në pellgun e Drinit të Bardhë (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

Metali hekur Fe^{2+} , në vitin 2011, ka tejkaluar limitin e kuantifikimit në lumenjtë Erenik - Ura e Terzive, kurse

në vitet 2012 dhe 2013, në Erenik - Ura e Terzive dhe Rimnik - Xërxë.




Figura 19. Prezenca e hekurit në pellgun e Drinit të Bardhë (AMMK, Raport për Gjendjen e Ujërave në Kosovë, 2015)

BURIMET E NDOTJES⁷⁴ SË UJËRAVE

Cilësia e ujërave sipërfaqësore si edhe e atyre nëntokësore ndikohet nga shkarkimet e jashtme të ujërave të zeza, atyre industriale dhe mbeturinave. Në Gjakovë, Lumi Erenik është lumi më i ekspozuar në të cilin derdhen të gjitha ujërat e zeza të qytetit, ku derdhen ujërat e rreth 91,000 banorëve të zonës urbane dhe dy fshatrave. Ai ka katër ndotës kolektivë dhe tre individualë. Pas tij renditet Drini i Bardhë që pranon ujërat e kanalizimeve të 5,000 banorëve të Rogovës, dhe Trakaniqi të mbi 1,120 banorë të tri fshatrave përreth.⁵⁵

Sipas një studimi mbi ndotjen e Lumit të Erenikut, është gjetur sasi e madhe e kromit nga 42-53.36mg/dm³ si rezultat i lokacionit të minierës në jug

dhe lindje të lumit. Në stacionin e analizuar, përveç kromit, janë gjetur koncentrimet të larta të metaleve të rënda si hekuri, nikeli dhe bakri, si pasojë e aktiviteteve njerëzore. Si rezultat i përdorimit të detergjentëve shtëpiakë është rritur sasia e fosfateve në lumin e Erenikut e cila varion nga 89.96-136.0 mg/dm³ dhe e klorureve nga 79.96-95.15 µg/dm³, duke bërë ujin e papërdorshëm për ujitjen e tokave bujqësore pasi që vlera të tilla do të kishin ndikim negativ në bimë.⁵⁶

Qyteti i Gjakovës është i vetmi vendbanim në Kosovë që përveç rrjetit të kanalizimit ka edhe rrjetin e evakuimit të ujërave atmosferike dhe gropë septike për para-trajtim të ujit të ndotur në zonën industriale.

KOMUNA	VENDBANIMI	NR. I BANORËVE	VENDSHKARKIMI
GJAKOVË	Qyteti	91,800	Ereniku
	Brovinë	700	Ereniku
	Janosh	300	Trakaniq
	Osekpash	420	Trakaniq
	Rogovë	5,000	Drini i Bardhë
	Smolicë	900	Ereniku
	Trakaniq	420	Trakaniq

Tabela 30. Ndotësit kolektivë sipas komunave - Gjakovë (AMMK, Kadastru i Ndotësve të Ujërave të Kosovës)

⁵⁵ AMMK, Raporti Kadastru i Ndotësve të Ujërave të Kosovës

⁵⁶ https://www.researchgate.net/publication/285579161_International_Journal_of_Green_and_Herbal_Chemistry_Pollution_of_Erenik_River_from_City_Discharge_and_Industrial_Water_of_Gjakova-Kosovo (Bardha Korça, Driton Musliu dhe Ilir Shehu, IJGHC, 2015)

Përveç ndotësve kolektivë, Kadastrri i Ndotësve të Ujërave identifikon edhe ndotësit individualë, shumica e të cilëve shkarkojnë ujërat e zeza në tokë, apo në ujëra nëntokësore. Në

listën e ndotësve përfshihen edhe fermat e kafshëve dhe thertoret, hekurishtet dhe prodhuesit e asfaltit, ku Ereniku ngarkohet me tre prej këtyre ndotësve.

KOMUNA	EMRI I NDOTËSIT INDIVIDUAL	VEPRIMTARIA	VENDSHKARKIMI
GJAKOVË	Geberland	Industri e mishit	Ereniku
	Dielli	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
	EuroUnited	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
	Te Ylberi	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
	Kamilla	Industri ushqimore	Ereniku
	Ekspress 2	Pastrim kimik	Ereniku

Tabela 31. Ndotësit individualë - Gjakovë (AMMK, Kadastrri i Ndotësve të Ujërave të Kosovës)



Harta 5. Pikat shkarkuese në Regjionin e Pejës (AMMK, Kadastrri i Ndotësve të Ujërave të Kosovës)

75 UJËRAT

NËNTOKËSORE

Ujërat nëntokësore, sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës, Nr. 04/L-147, janë të gjithat ujërat të cilat janë nën sipërfaqen e tokës në zonën ujëmbajtëse dhe në kontakt direkt me tokën ose tabanin.⁵⁷ Rezervat e ujërave nëntokësore në Kosovë konsiderohen të kufizuara, kryesisht në pjesën perëndimore të vendit, përkatësisht në Rrafshin e Dukagjinit, dhe pellgu i Drinit të Bardhë në veçanti. Ujërat nëntokësore janë të rrezikuara nga ndotja si pasojë e rrjedhjeve nga mbetjet bujqësore, plehurat inorganike, mbeturinat, metalet dhe ndotësit tjerë që mund të përcillen nga dheu.

⁵⁷ Ligji për Ujërat e Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>

BIODIVERSITETI 8

Biodiversiteti mund të ndahet në disa kategori, si biodiversiteti gjenetik, i specieve dhe i ekosistemit. **Biodiversiteti gjenetik** është numri i karakteristikave të ndryshme gjenetike në përbërjen gjenetike të specieve. Është ky diversitet që lejon dallimet mes specieve të ndryshme dhe mundëson mbijetesën dhe rezistencën e tyre ndaj zhdukjes. Në rastin e katastrofave natyrore apo të ndryshimeve ekstreme klimatike, është ky diversitet gjenetik që lejon disa specie të jenë më elastik dhe të kthyeshme, ta marrin veten më shpejtë dhe t'i përshtaten kushteve të ndryshuara.

Biodiversiteti i specieve, poashtu, bazohet në numrin e specieve të ndryshme të një zone dhe në ekuilibrin e bollëkut të specieve. Grabitqarët e mëdhenj, polenizuesit dhe dekompozuesit janë speciet më të rëndësishme në ruajtjen e biodiversitetit dhe forcimit të ekosistemeve.

Biodiversiteti i ekosistemit i referohet variacioneve mes komuniteteve biologjike dhe rëndësisë së ekosistemeve në ruajtjen e biodiversitetit. Ekosistemi definohet si "komunitet biologjik i organizmave ndërveprues dhe mjedisit të tyre fizik" dhe mund të ekzistojë në disa shkallë

të ndryshme. Ato janë të rëndësishme për arsye ndërveprimi mes specieve dhe ambientit të tyre, ku të gjitha janë të ndërruar në njëra-tjetrën për mbijetesë.⁵⁸

Kosova dallohet për biodiversitet të pasur, i mundësuar nga pozita gjeografike, faktorët gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjik, nga relievi dhe klima. Vendi njihet për biodiversitet të pasur biologjik e peisazhor, me llojllojshmëri të faunës dhe florës, ku veçohet prania e bimëve endemike me rëndësi të lartë për ekosistemin.

Megjithatë, viteve të fundit, Kosova ka trend të theksuar të humbjes së biodiversitetit, sidomos me kalimin nga ekonomia e centralizuar në ekonomi të tregut. Ndotja e ujërave, modifikimi i rrjedhave natyrore të lumenjve nga kompanitë hidro-energjetike, prerja e pakontrolluar e pyjeve që shqetëson ekosistemin pyjor, shtimi i numrit të guroreve të hapura, gjuetia, peshkataria e pamonitoruar janë disa nga faktorët kryesorë me ndikim në humbjen e biodiversitetit.⁵⁹ Megjithatë, në Kosovë nuk ka indikatorë të identifikuar të biodiversitetit, të cilët zakonisht janë një lloj specimesh të cilat sigurojnë tregues të shëndetit të një ekosistemi. Këto specie, zakonisht janë ato në maje të zingjirit ushqimor, numri i ulët i të cilave mund të indikojë zhdukjen e burimeve ushqyese për të.

⁵⁸ <https://www.thecropsite.com/focus/5m/52/biodiversity-protecting-the-natural-world>

⁵⁹ MMPH, Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022, 2013

GRUPI	LLOJET NË KOSOVË	LLOJET NË EVROPË	LLOJET NË BOTË
Alga	400*	x	>40,000
Kërpudha	100*	16,000	>70,000
Bimë me lule	1,800*	11,415	250,000
Insekte	130*	40,000	1,000,000
Peshq të ujërave të ëmbla	30*	x	8,500
Amfibe	14	62	4,000
Reptilë	14	123	6,500
Shpendë	180*	450	9,881
Gjitarë	45*	200	4,327

*: Supozohet për numër më të madh të llojeve
x: Numër i panjohur

Tabela 32. Numri i disa llojeve në Kosovë në krahasim me ato në Shqipëri, Evropë dhe në Botë (AMMK, Biodiversiteti i Kosovës)

BIODIVERSITETI I GJAKOVËS ⁰¹

Komuna e Gjakovës ka klimë të mesme kontinentale të modifikuar me elemente të klimës mesdhetare, e cila vjen nga Lumi i Drinit të Bardhë dhe përmes qafave të maleve. Me temperaturë mesatare vjetore prej 11.7°C dhe reshje mbi 1000mm, Gjakova është e pasur me lumenjë si Ereniku, Krena, e Drini i Bardhë dhe toka të smonicave, të zeza aluviale dhe toka të përshtatshme për drithëra, pemë e hardhi, kullosa e livadhe. Komuna ka përpiluar Planin Lokal të Veprimtimit në Biodiversitet me parimet kryesore:

Hartimin e platformës në mbrojtje të biodiversitetit; mbrojtjen, ruajtjen dhe konservimin e burimeve natyrore; Miratimin e zonave të mbrojtura dhe shenjzimin e kufinjëve të tyre; zonimin e vendndodhjes së bimëve endemike dhe kafshëve nën mbrojtje. Problemet e identifikuara në ruajtjen e biodiversitetit përfshijnë dëmtimin e pyjeve, pyllëzimin, erozionin dhe dëmtimin e lumenjve, ndotjen e ujërave, gjuetinë e paligjshme, mbeturinat dhe rrezikimin e florës dhe faunës së mbrojtur me ligj.

⁵⁷ Ligji për Ujërat e Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>

Bazuar në hulumtimet e bëra, Gjakova ka biodiversitet të pasur me ekosisteme të larmishme si në shtrirje horizontale edhe në atë vertikale deri në lartësitë e majet më të larta në territorin e komunës. Lumenjtë e Gjakovës mundësojnë përhapjen e llojeve bimore dhe shtazore përgjatë tyre dhe më gjerë në toka pjellore, livadhe e kullosa, male e bjeshkë të larta. Gjeologjia dhe pedologjia e Gjakovës dallohet me luginat-fushat aluviale rreth lumenjve, fushëgropën e

Gjakovës, krahinat-hapësirat kodrinore si Hasi dhe Dushkaja, masivin malor Qafë e Morinës – Qafë e Prushit, pjesët malore të Pashtrikut dhe pjesët malore të Bjeshkëve të Nemuna me rreth 5% (rreth 3000 ha) të Parkut Nacional me shtrirje në territorin e komunës.⁶⁰ Çabrati, Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë dhe Shkugëza janë tri nga zonat e mbrojtura të komunës që luajnë rol të madh në ruajtjen e biodiversitetit.

KORNIZA LIGJORE DHE 2 INSTITUCIONALE PËR MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233 dhe akteve nënligjore të tij dhe Nenit 52 të Kushtetutës së Kosovës, mbrojtja dhe ruajtja e të gjitha vlerave të natyrës dhe biodiversitetit është përgjegjësi e secilit, prandaj edhe numri i ligjeve që ndërliken me atë të mbrojtjes së natyrës janë në numër të madh dhe i referohen çdo elementi apo sektori që mund të ndikojë në biodiversitet.⁶¹

Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës – ka për qëllim mbrojtjen e natyrës, zhvillimin e qëndrueshëm të saj, specifikisht ruajtjen, mbrojtjen dhe ripërtëritjen përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm; revitalizimin e territoreve të dëmtuara dhe kompensimin për dëmet e shkaktuara; ruajtjen dhe restaurimin e barazpeshës ekologjike; sistemin e planifikimit për mbrojtjen e natyrës; zvogëlimin e shfrytëzimit të tepërt dhe rrezikimit të florës e faunës;

sigurimin e të drejtës për informim publik në lidhje me mbrojtjen e natyrës, sigurimin e të drejtës qytetare për mjedis të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë; sigurim të biodiversitetit përmes ruajtjes së habitateve natyrore; dhe afrimi i standardeve kosovare në harmoni me ato të BE-së.

Ligji Nr. 04/L-087 për Parkun Kombëtar “Sharri” – ka për qëllim mbrojtjen e parkut kombëtar si tërësi hapësinore me vlera të rralla natyrore përmes regjimit të mbrojtjes sipas zonave të caktuara.

Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit – ky ligj rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas koncepteve të zhvillimit të qëndrueshëm.

⁶⁰ KGJ, Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet në Komunën e Gjakovës 2019-2024

⁶¹ MMPH, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020

Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja – ka për qëllim mundësimin e një mjedisi të shëndetshëm për popullin e Kosovës dhe vendosjen e standardeve për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja në harmoni me ato të Bashkimit Evropian.

Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës – ka për synim zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social-ekonomik të Kosovës; të themelojë udhëzime për shpërndarje optimale të burimeve ujore sipas qëllimit dhe shfrytëzimit; të sigurojë mbrojtjen e ujërave nga ndotja, tejshfrytëzimi dhe keqpërdorimi; dhe të përcaktojë strukturat institucionale për administrimin e resurseve ujore.

Ligji Nr. 03/L-174 për Planifikimin Hapësinor – synon të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barazpeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Kosovës përmes shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore e natyrore.

Ligji Nr.03/L-015 për Vlerësim Strategjik Mjedisor – ka për qëllim vlerësimin strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, si dhe të përcaktojë kushtet dhe mënyrat e vlerësimit të ndikimit në mjedis përmes parimeve të mbrojtjes së mjedisit.

Ligji Nr. 03/L-024 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis – me qëllim të parandalimit të ndikimeve negative në mjedis të projekteve të propozuara nga aplikuesit dhe për të përcaktuar procedurat e identifikimit, vlerësimit, raportimit dhe administrimit të ndikimeve mjedisore të një projekti të propozuar.

Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina – me qëllimin e evitimit dhe reduktimit sa më të madh të gjenerimit të mbeturinave; ripërdorimit të komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat; zhvillimit të qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së burimeve natyrore; parandalimit të ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe në shëndetin e njeriut; deponimit përfundimtar të mbeturinave sipas mënyrave të pranueshme mjedisore.

Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma – ka për qëllim shmangien, parandalimin ose zvogëlimin e efekteve të dëmshme dhe bezdisjen si rezultat i ekspozimit ndaj zhurmës në mjedis, si dhe ofrimin e një baze të masave për zvogëlimin e zhurmës së emetuar nga burimet rrugore, hekurudhore, ajrore, industriale dhe burimeve tjera.

Ligji Nr. 04/L-197 për Kimikate – ka për qëllim menaxhimin e drejtë të kimikateve të rrezikshme, mbrojtjen dhe zvogëlimin e rrezikut të mundshëm nga kimikatet, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe në mjedis.

Ligji Nr. 03/L-119 për Produktet Biocide – me qëllim të caktimit dhe rregullimit të kushteve për vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave aktive që përdoren për prodhimin e produkteve biocide në Kosovë.

Ligjet tjera me ndikim në ruajtjen e biodiversitetit janë:

- Ligji Nr. 03/L-153 për Pyjet e Kosovës**
- Ligji Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore**
- Ligji Nr. 2003/5 për Farërat**
- Ligji Nr. 2003/10 për Plehrat Artificiale**
- Ligji Nr. 2003/11 për Rrugët**
- Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë**
- Ligji Nr. 2004/13 për Materialin Fidanor**
- Ligji Nr. 2004/21 për Veterinarinë**
- Ligji Nr. 2004/33 për Blegtorinë e Kosovës**
- Ligji Nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore**
- Ligji Nr. 02/L-53 për Gjuetinë**
- Ligji Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri**
- Ligji Nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë**
- Ligji Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve**

Ligji Nr. 02/L-98 për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve

Ligji Nr. 02/L-111 për Bletari

Ligji Nr. 04/L-085 për Bujqësi Organike

Ligji Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve

Ligji Nr. 03/L-002 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale

Përveç ligjeve, ekzistojnë edhe Konventa, Direktiva dhe Rregullore për ruajtjen e natyrës:

Konventa e Bernit për mbrojtjen e florës, faunës dhe habitateve (1979), Konventa e Bonit për mbrojtjen e llojeve migruese (1979), Konventa e Washingtonit për tregti ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara bimore dhe shtazore (1973), Direktiva e KE për habitatet natyrore, Direktiva e KE për zogjtë e egër, Direktiva Kornizë e Ujërave, Konventa e peisazheve të Evropës, Konventa e Alpeve, Konventa e Karpateve, Konventa Ramsar, UNESCO Mab Programme (The Man and the Biosphere), Rregullorja CITES, etj.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Si organi më kompetent për mbrojtjen e natyrës në Kosovë është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e cila ndër të tjera ka

përgjegjësi edhe mbi ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura natyrore përmes politikave përkatëse.

SEKTORËT KRYESORË ME 83 NDIKIM NË BIODIVERSITET


BUJQËSIA

Ky sektor bazohet dhe ka ndikim direkt e indirekt në burimet natyrore dhe mënyrat e kontribuimit në ruajtjen e biodiversitetit përfshirë aplikimin e sistemeve menaxhuese, të teknologjive dhe praktikave të përshtatshme për natyrën, siq janë rezervatet biologjike të fermave, zvogëlimin e numrit të vendbanimeve të egra që shndërrohen në toka bujqësore, lënia e një pjese të tokës bujqësore për qëllime të ripërtëritjes së vendbanimeve natyrore dhe përdorimin e metodave të qëndrueshme në blegtori dhe në shfrytëzimin e kullotave. Agrobiodiversiteti, që nënkupton llojllojshmërinë e ushqimit për njerëzit dhe kafshët, është fusha më kritike, sidomos në Kosovë, ku shumë varietete të misrit, grurit dhe pemëve janë lënë pas dore, paraqesin produktivitet të ulët dhe duhet të ruhen qoftë edhe për qëllime shkencore, socio-ekonomike dhe mjedisore. ⁶²

PYLLTARIA

Pyjet kryesore përfaqësuese të territorit të Kosovës janë pyjet gjethrënese, të cilat mbulojnë më shumë se 90% të tokave pyjore dhe dallohen me bungun dhe ahun si lloje dominuese. Pyjet halore mbulojnë 7% të tokave pyjore dhe prej tyre dominon bredhi, hormoqi dhe pisha. Sipërfaqet pyjore kanë rëndësi të pazëvendësueshme në ruajtjen e biodiversitetit, pasi që ato sigurojnë drurin dhe produktet tjera me rol mbrojtës, ruajnë ekosistemet, e mbajnë ujin të pastër, zvogëlojnë rrezikun nga vërshimet, erozioni dhe thatësira. Shfrytëzimi ilegal dhe prerja e pakontrolluar kanë ndikim të madh në shqetësimin e sistemeve dhe humbjen e biodiversitetit. Sektori komercial dikton ndërhyrjen ilegale sidomos në shfrytëzimin e pakontrolluar të kërpudhave, frutave të egra të malit, bimëve mjekësore dhe aromatike të rralla dhe të kërcënuara nga zhdukja, si: Sherbela mjekësore (*Salvia officinalis*), Dëllinja e Zezë (*Juniperus communis* L.), Akësi (*Helichrysum italicum* L.), Aguliçja (*Primula veris* L.), Shtogu (*Sambucus nigra*), Rrush Arushe (*Arctostaphylos uva ursi* L.), Bliri (*Tilia cordata* Mill.), Trëndafili i Egër (*Rosa canina* L.), Boronicat (*Vaccinium myrtillus*), mjedrat, dredhëzat, Kërpudhat Vrganji (*Boletus edulis*) dhe Dhelprusha (*Cantharellus cibarius*).

⁶² MMPH, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020



Mbi 50,000 ha të pyjeve janë të shtrira në Zona të Mbrojtura, ku pjesa më e madhe i takojnë Malit të Sharrit (18,884 ha), Bjeshkëve të Nemuna (60,000) dhe Gërmisë (885 ha).

Pyjet në Kosovë klasifikohen sipas llojit, lartësisë, pronësisë dhe përqindjes së sipërfaqes.

Harta 6. Shtrirja e tokave pyjore në Kosovë ⁶³

LLOJI I PYJEVE	PRONËSIA			%
	SHTETËRORE	PRIVATE	GJITHSEJ	
Pyje të larta	51,000	15,000	66,000	15
Pyje të ulëta	116,000	63,000	179,000	42
Pyje të degraduara	34,000	48,000	82,000	20
Shkurre/kaçuba	67,000	36,000	103,000	23
Gjithsej	268,000	162,000	430,000	100

Tabela 33. Pyjet e Kosovës sipas llojit, pronësisë në ha dhe përqindje (AMMK, Biodiversiteti i Kosovës)

⁶³ https://www.academia.edu/24670393/Harta_e_shtrirjes_s%C3%AB_Pyjeve_n%C3%AB_Kosov%C3%AB_Forest_map

Gjuetia zhvillohet për qëllime shkencore, turistike, sportive dhe ekonomike. Ajo rregullohet me Ligjin për Gjuetinë dhe me aktet nënligjore si pjesë e planeve menaxhuese 10 vjeçare. Si sektor me ndikim të madh në biodiversitet, gjuetia duhet rregulluar sipas ligjit dhe rregulloreve të lokaliteteve në mënyrë që të ruhet biodiversiteti. Gjuetia e qëndrueshme nënkupton shfrytëzimin e llojeve të kafshëve dhe vendbanimeve në atë

GJUETIA

mënyrë që humbja afatgjatë e biodiversitetit të jetë sa më e vogël. Sipas analizave në terren, numri më i madh i kafshëve në Kosovë janë në numër të ulët e disa në numër mesatar, përveç derrave të egër, të cilët janë në numër të madh. Llojet e rralla që kërcënohen nga zhdukja janë: dhia e egër, rrëqebulli, ujku, ariu, pula e madhe e egër dhe shqiponja.⁶⁴

LLOJI I KAFSHËVE TË EGRA	VLERËSIMI I GJENDJES 1-2-3	VLERËSIMI I NUMRIT
Dreri (<i>Cervus elaphus</i>)	1	300-400
Drenusha (<i>Dama dama</i>)	(e rrethuar)	160
Kaprolli (<i>Capreolus capreolus</i>)	1-2	5,000-6,000
Dhia e egër (<i>Rupicapra rupicapra</i>)	1	400-500
Derri i egër (<i>Sus strofa</i>)	3	6,000-10,000
Ariu i murrmë (<i>Ursus arctos</i>)	1-2	80-100
Ujku (<i>Canis lupus</i>)	1-2	Deri në 100
Rrëqebulli (<i>Lynx lynx</i>)	1	20-25
Lepuri (<i>Lepus europaeus</i>)	1-2	5,000-10,000
Tetrao urogallus	1	/
Fazani i rëndomtë (<i>Phasianus sp.</i>)	2	5,000-10,000
Fëllanxa e fushave (<i>Perdix perdix</i>)	1-2	5,000
Patat (<i>Anatidae</i>)	1	/
Llojet tjera të imëta	1-2	/

Vlerësimi i gjendjes: 1 = Numër i vogël; 2 = Gjendje e mirë; 3 = Gjendje shumë e mirë

Tabela 34. Vlerësimi i gjendjes dhe numrit të kafshëve të egra në Kosovë (MMPH, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet, 2011-2020)

⁶⁴ MMPH, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020

Në Kosovë ka hapësirë të mjaftueshme mjedisore për gjueti të ligjshme dhe për menaxhimin e tyre. Rreth 200,000 ha janë tokë me vendbanime, rrugë e objekte, ku nuk mundësohet gjuetia, kurse 900,000 ha tjerë janë mjedisore

për lloje të kafshëve dhe kafshë për gjueti. Janë katër vende të ndara për gjueti të interesit të veçantë, Blinaja dhe Duboqaku, me sipërfaqe prej 73,300 ha, apo 8% të sipërfaqes së përgjithshme.⁶⁵

PESHKATARIA

Peshkimi rekreativ-sportiv zhvillohet në shumicën e ujërave të Kosovës dhe pa përfitim të rëndësishëm ekonomik. Vendi ka të zhvilluar aquakulturën që nga vitet e '60-ta dhe prodhohen rreth 300 ton peshk në vit. Trofta ka pasur ngritje në prodhim, por meqë peshkohet në basene artificiale e shumë pak në kushte natyrore, nuk ka ndikim të zingjiri ushqimor i zogjve të egër peshk ngrënës dhe rrallë gjindet si e freskët në treg, por konsumohet kryesisht në hoteleri dhe restorane.

TURIZMI

Përveç ndikimit në ndotjen e ajrit nga emetimet e gazrave të dëmshme, transporti, sidomos ai rrugor ka ndikim negativ në fragmentimin e vendbanimeve natyrore, në mungesë të mbikalimeve për kafshë, dhe shqetësimin e ekosistemeve shkaktuar nga zhurma dhe ndriçimi. Aksidentimi i kafshëve ka pasoja serioze në biodiversitet si pasojë e mungesës së sinjalizimit adekuat të vendkalimet e zakonshme për kafshët e egra.

MINIERAT DHE DEPONITË E BRAKTISURA

Kosova është e pasur me minerale si linjiti, që shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike, mineralet që përdoren në ndërtimtari, si guri gëlqeror, zalli i lumenjve dhe deltina, si dhe ato që shfrytëzohen për prodhimin e metaleve, si nikeli, zinku, plumbi, ari, argjendi dhe kromi. Shumë miniera sot nuk janë aktive, por deponitë e tyre me materiale të dëmshme paraqesin rrezik për jetën dhe vendbanimet natyrore. Të njejtin ndikim në degradimin e ekosistemeve kanë edhe ndërhyrjet ilegale të gurthyesve.

⁶⁵ MMPH, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020

ZONAT E MBROJTURA

NATYRORE

Shumë miniera sot nuk janë aktive, por deponitë e tyre me materiale të dëmshme paraqesin rrezik për jetën dhe vendbanimet natyrore. Të njejtin ndikim në degradimin e ekosistemeve kanë edhe ndërhyrjet ilegale të gurthyesve.

Terme të dobishme për kuptimin e emërtimeve të zonave të mbrojtura

- **Rezervati Strikt i Natyrës** – zonë e mbrojtur për qëllime shkencore
- **Parku Kombëtar** – zonë e mbrojtur për qëllim të mbrojtjes së ekosistemeve natyrore dhe rekreacionit
- **Monumenti Natyror** – zonë e mbrojtur me qëllim të konservimit të karakteristikave specifike natyrore
- **Zona Menaxhuese e Habitave ose Llojeve të Mbrojtura** – zonë e mbrojtur për ruajtjen e habitave ose llojeve të mbrojtura

- **Peisazhet e Mbrojtura** – zona të mbrojtura për qëllime të ruajtjes së peisazheve

- **Zona e Mbrojtur e Resurseve Natyrore** – zonë e mbrojtur me qëllim të shfrytëzimit të qëndrueshëm të ekosistemeve natyrore.

Zonat e mëdha të mbrojtura në Kosovë kanë organe menaxhuese të veçanta, si Parku Kombëtar “Mali Sharr”, i cili menaxhohet nga Drejtoria e Parkut me seli në Prizren, Parku Regjional “Gërmia”, i cili menaxhohet nga ndërmarrja publike “Hortikultura”, dhe “Shpella e Gadimës”, e menaxhuar nga Qeveria. Megjithatë, shumë zona natyrore të mbrojtura nuk kanë plane të menaxhimit.⁶⁶ Më poshtë janë listuar disa nga zonat e mbrojtura me vlera të larta të ruajtjes së florës dhe faunës në territorin e komunës së Gjakovës.

KODI	EMËRTIMI I ZONËS	KOMUNA/ZONA	SIPËRFAQJA (HA)	KATEGORIA SIPAS IUCN	VITI I MBROJTJES	PËRSHKRIMI I VLERAVE
REZERVAT STRIKT I NATYRËS (10,885.82 HA)						
RN_013	Bjeshka e Kuzhnjerit/ Maja e Ropsit	PK. “Bjeshkët e Nemuna”	1,110.57	/	2016	Bimë të llojeve të molikës, bredhit, pishës, ahut dhe i dhisë së egër
RN_014	Majet e Prilepit	PK. “Bjeshkët e Nemuna”	106.04	/	2016	Bimë me përbërje të pastër të panjës malore dhe arnenit
RN_015	Gubavci	PK. “Bjeshkët e Nemuna”	76.86	/	2016	Bimë endemore-like boshtra

⁶⁶ MMPH, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020

RN_016	Rusenica	PK. "Bjeshkët e Nemuna"	270	/	2016	Rrëqebulli
RN_017	Oshlaku	PK. "Sharri"	550.47	/	2016	Areneni i kuq dhe bimë endemike
RN_018	Maja e Arnenit	PK. "Sharri"	145.48	/	2016	Arneni i pastër i kuq
RN_019	Pisha e Madhe	PK. "Sharri"	44	/	2016	Arneni i pastër i kuq
PARK KOMBËTAR (115.957 HA)						
PK_002	Bjeshkët e Nemuna	Pejë, Gjakovë, Deçan, Istog, Junik	62.488	II	2013	Lloje relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës
MONUMENTE NATYRORE (6010.79 HA)						
MN_016	Kanioni i Drinit të Bardhë	Gjakovë, Rahovec	198	III	1986	Karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik
PARK I NATYRËS (5.934 HA)						
PN_002	Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës	Gjakovë, Prizren	5.934	V	2015	Vlera biologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, kulturore dhe turistike
PEISAZH I MBROJTUR (2437 HA)						
PM_001	Shkugëza	Gjakovë	70	V	2011	Vlera floristike, edukative, turistike

Tabela 35. AMMK, Zonat e Mbrojtura Natyrore (specifikisht në territorin e komunës së Gjakovës)

FLORA DHE VEGJETACIONI I KOSOVËS

Vegjetacioni i Kosovës përfaqësohet nga 139 asociacione bimore të grupuara në 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasa. Si qendra të biodiversitetit të florës në Kosovë qëndrojnë Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna. Raporti i sipërfaqes së Kosovës në kuadër të Ballkanit tregon se

fitodiversiteti i vendit paraqet rreth 25% të florës së ballkanit dhe rreth 18% të florës së Evropës. Në Bjeshkët e Nemuna janë 797 lloje të bimëve vaskulare, 128 prej të cilave konsiderohen endemike.⁶⁷

⁶⁷ AMMK, Biodiversiteti i Kosovës

Sipas Librit të Kuq të Florës Vaskulare të Kosovës, janë vlerësuar 237 taksonë bimore sipas kriterëve të IUCN-së dhe

është bërë kategorizimi i statusit të tyre.

KATEGORITË E LISTËS SË KUQE TË IUCN-SË	NUMRI I SPECIEVE	NUMRI I SPECIEVE ENDEMIKE NË BALLKAN	NUMRI I SPECIEVE TË PËRFSHIRA NË LIBRIN E KUQ TË BOTËS	NUMRI I SPECIEVE TË PËRFSHIRA NË LIBRIN E KUQ TË EVROPËS	ENERGJI ELEKTRIKE
I ZHDUKUR (EX)	1	/	/	/	0.4
I ZHDUKUR SI GJENDJE SPONTANE OSE NË TË EGËR (EW)	1	/	/	/	0.4
I RREZIKUAR NË MËNYRË KRITIKE (CR)	61	32	3	6	26
I RREZIKUAR (EN)	86	45	9	6	36
I PËRKEQËSUAR (VU)	19	11	3	3	8
GATI I RREZIKUAR (NT)	34	23	5	1	18
MË PAK I RREZIKUAR (LC)	35	21	4	1	16
NUMRI I PËRGJITHSHËM	237	132	24	17	100

Tabela 36. Kategorizimi i specieve bimore sipas Listës së Kuqe të IUCN-së (MMPH, Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Kosovës, 2013)

Ky kategorizim dhe njohja e rrezikshmërisë së specieve ka rëndësi primare për ruajtjen e llojeve. Zhvillimi i shpejtë i industrive, infrastruktura e zgjeruar, rritja e numrit të popullsisë dhe ndryshimet klimatike rezikojnë rëndë biodiversitetin. Format jetësore që janë përfshirë në taksonet e listuara në Librin e Kuq përfshijnë: Hemikriptofitet (H), Gjeofitet (G), Fenerofitet (P), Terofitet (T) dhe Kamefitet (Ch). Gjatë hulumtimit në terren, lista është zgjatur edhe me 9

lloje të reja të florës së Kosovës dhe që vlejné edhe për Evropën Juglindore: *Crocus flavus*, *Quercus robur* subsp. *Pedunculiflora*, *Cyanus lingulatus*, *Juniperus sabina*, *Ranunculus degenii*, *Viola herzogii*, *Pulsatilla alpina*, *Minuartia baldaccii* subsp. *Baldaccii* dhe *Gypsophila spergulifolia*.⁶⁸ Përveç bimëve me rëndësi mjedisore, ekonomike dhe të ruajtjes së ekosistemeve, rëndësi të veçantë kanë edhe bimët mjekësore dhe aromatike, të cilat janë në gjendje të rrezikuar nga

⁶⁸ MMPH, Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës, 2013

mbledhja e pakontrolluar. Ato mbledhen në fazën e lulëzimit, u mbledhen rizomat, zbardhokët dhe organet tjera riprodutive të tyre që është shqetësuese për statusin e tyre. Dëllinja e zezë (*Juniperus communis*), dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus*), këputja e arës (*Equisetum arvense*), pisha e zezë (*Pinus nigra*), pisha e bardhë (*Pinus sylvestris*), kashtëfryza (*Acorus calamus*), kamomili (*Matri-*

caria chamomilla), hithra (*Urtica dioica*), shtogu (*Sambucus nigra*), thana (*Cornus mas*), gështenja (*Castanea sativa*), boronica (*Vaccinium myrtillus*), sherbela (*Salvia officinalis*), trëndafili i egër (*Rosa canina*) etj. janë vetëm disa nga bimët mjekësore me karakter ekonomik të rëndësishëm për Kosovën dhe për të cilat nevojitet mbrojtje dhe kontrollim i mbledhjes dhe përdorimit.




Figura 20. Format jetësore të taksonëve bimore në Librin e Kuq (MMPH, Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Kosovës, 2013)

Shumë nga rreziqet kryesore që i kanosen bimëve shkaktohen nga disa fenomene natyrore dhe nga veprimet

e njeriut e sidomos nga aktivitetet rekreative.




Figura 21. Rangimi i rreziqeve që i kanosen bimëve (MMPH, Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Kosovës, 2013)

LLOJET	TRENDI AKTUAL I DEGRADIMIT SASIOR TË HABITATIT	NDRYSHIMI SASIOR I HABITATIT NË 15 VITE (%) KRAHASUAR ME ATË AKTUAL	LLOJI I DEGRADIMIT PËR TREGUESIN SASIOR	RENDI AKTUAL I DEGRADIMIT CILËSOR TË HABITATIT	FAKTORËT KRYESORË QË NDIKOJNË NË HUMBJE DHE DEGRADIM
<i>Achillea alexandri-regis</i>	Rënie	1% rënie	Jo biotike, biotike	Rënie	Sukcesioni dhe zjarret
<i>Aristolochia merxmuelleri</i>	Rënie	2% rënie	Jo biotike, biotike	Rënie	Aktivitet e njeriut
<i>Cerastium neoscardicum</i>	Rënie	3% rënie	Jo biotike, biotike	Rënie	Sukcesioni dhe zjarret
<i>Crepis bertiscea</i>	Rënie	1% rënie	Jo biotike, biotike	Rënie	Nryshimet klimatike dhe suksesioni
<i>Crepis macedonica</i>	Rënie	3% rënie	Jo biotike, biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
<i>Fritillaria macedonica</i>	Rënie	3% rënie	Biotike	Rënie	Sukcesioni
<i>Gentiana pneumonanthe</i> subsp. <i>nopcsae</i>	Rënie	3% rënie	Jo biotike	Rënie	Ndryshimi i regjimit ujor
<i>Linum elegans</i>	Rënie	1% rënie	Biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
<i>Senecio scapolii</i>	Rënie	1% rënie	Biotike	Stabile	Aktivitetet e njeriut
<i>Sideritis scardica</i>	Rënie	3% rënie	Jo biotike, biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
<i>Silene pusilla</i> subsp. <i>candavica</i>	Rënie	1% rënie	Jo biotike, biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
<i>Silene retzorfiana</i> subsp. <i>nicolicii</i>	Rënie	1% rënie	Jo biotike, biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
<i>Solenanthus krasniqi</i>	Rënie	10% rënie	Jo biotike, biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut, invadimi i llojeve të huaja, zjarri
<i>Stachys serbica</i>	Rënie	30% rënie	Jo biotike, biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
<i>Tulipa gesneriana</i> (Syn.: <i>Tulipa scardica</i>)	Rënie	3% rënie	Jo biotike, biotike	Rënie	Aktivitetet e njeriut
<i>Tulipa serbica</i>	Stabile	0.5% rënie	Biotike	Stabile	Aktivitetet e njeriut

Tabela 37. Trendi i degradimit cilësor dhe sasior i habitateve të disa llojeve të zgjedhura dhe faktorët që ndikojnë në to (AMMK, Mjedisi i Kosovës – Raport i Treguesve Mjedisorë, 2020)

FLORA NË KOMUNËN E GJAKOVËS

Territori i komunës së Gjakovës është vend i përshtatshëm për rritjen e fitocenozave dhe zhvillimin e specieve të ndryshme bimore përmes faktorëve të saj orografikë, gjeologjikë, pedologjikë dhe klimatikë. Meqë komuna e Gjakovës shtrihet në lartësi të ndryshme mbidetare, flora shtrihet në disa zona vertikale.


Nga Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Kosovës, vetëm në territorin e Gjakovës figurojnë 33 lloje bimore të tilla, prej të cilave 7 në lokalitete të reja, të cilat janë të klasifikuara sipas shkallës së kërcënueshmërisë nga IUCN.

NR.	LLOJI BIMOR	LOKALITETI NË GJAKOVË (LIBRI I KUQ)	KËRCËNUESHMËRIA (SIPAS IUCN)	LOKALITETE TË REJA
1.	<i>Romulea bulbocodium</i> (Lulekabuni)	Babaj i Bokës	CR - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar në mënyrë kritike	/
2.	<i>Daphne blagayana</i> (Xerxele e Bllagajjt)	Morinë	EN - B2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar	/
3.	<i>Dioscorea balcanica</i> (Groshë e egër)	/	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar	EK 2018
4.	<i>Gentiana pneumonanthe</i> L. (Gencianë e Nopçes)	Morinë	EN - B1ab(i,ii,iii,iv)+2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar	/
5.	<i>Gladiolus illyricus</i> (Gladiola e Ilirisë)	Morinë	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar	/
6.	<i>Haplophyllum boissierianum</i> (Haplofil i buasierit)	Morinë	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar	/
7.	<i>Micromeria albanica</i> (Bishtmiu shqiptar)	Te Ura e Fshejtë	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar	/
8.	<i>Minuartia baldaccii</i> (Minuarte e Baldaçit)	Morinë, Ura e Fshejtë	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar	/
9.	<i>Paeonia mascula</i> (Lulebozhure mashkull)	/	EN B2ab(i,ii) - I Rrezikuar.	EK 2018
10.	<i>Pinguicula crystallina</i> (Pinguikulë lulekreshtë)	Morinë	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar.	/
11.	<i>Quercus robur</i> L. sbsp. Robur (Rrënjë)	/	EN - B2ab(i,ii,iii,iv); D - I Rrezikuar.	EK 2018

12.	<i>Sanguisorba albanica</i> (Sanguisorbë shqiptare)	Morinë	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) +2ab(i,ii,iii,iv) - I Rrezikuar	/
13.	<i>Aster albanicus</i> (Ster shqiptare)	Qafë Prush, Pllanik-Morinë	VU B2a - I Përkeqësuar	/
14.	<i>Centaurea albertii</i> (Kokoçeli i Albertit)	Devë	VU - D2 - I Përkeqësuar	/
15.	<i>Epimedium alpinum</i> L. (Epimedë alpine)	Morinë	VU - D2 - I Përkeqësuar	/
16.	<i>Linum elegans</i> (Lini i hijshëm)	Ponoshec, Morinë	VU - D2 - I Përkeqësuar	/
17.	<i>Malus florentina</i> (Mollë florentine)	/	VUB1ab(i,ii,iii,iv)+2ab(i,ii,iii,iv) - I Përkeqësuar	EK 2018
18.	<i>Clematis flammula</i> (Kulpër e butë)	/	NT - Gati i rrezikuar	EK 2018
19.	<i>Linaria genistifolia</i> (Linaria dalmate)	Morinë	NT - Gati i rrezikuar	/
20.	<i>Moltkia doerfleri</i> (Moltkë e Dërflerit)	Morinë	NT - Gati i rrezikuar	/
21.	<i>Potentilla visianii</i> (Potentillë e Visianit)	/	NT - Gati i rrezikuar	EK 2018
22.	<i>Quercus trojana</i> (Qarrazi)	/	NT - Gati i rrezikuar	EK 2018
23.	<i>Salvia ringens</i> (Sherbelë kurorëhapur)	Morinë	NT - Gati i rrezikuar	/
24.	<i>Saponaria sicula</i> (Spunqyqe me spica)	Pllanik, Morinë	NT - Gati i rrezikuar	/
25.	<i>Sedum serpetini</i> (Rrush- qyqe e serpentineve)	Pllanik, Morinë	NT - Gati i rrezikuar	/
26.	<i>Veronica andrasovszkyi</i> (Veronika e Andrazovskit)	Devë, Morinë	NT - Gati i rrezikuar	/
27.	<i>Centaurea kosaninii</i> (Kokoçel i Koshaninit)	Qafë Prush, Morinë	LC - Më pak i rrezikuar	/
28.	<i>Forsythia europaea</i> (Boshtër)	Qafë Prush, Morinë	LC - Më pak i rrezikuar	/
29.	<i>Halacsya sendtneri</i> (Halaçi i Sendtnerit)	Qafë Prush, Morinë	LC - Më pak i rrezikuar	/
30.	<i>Lilium albanicus</i> (Zambaku shqiptar)	Morinë	LC - Më pak i rrezikuar	/
31.	<i>Linum flavum</i> (Liri i verdhë)	Morinë, Qafë Prush	LC - Më pak i rrezikuar	/

32.	<i>Polygala doerfleri</i> (Poli-galë e Dorflerit)	Morinë, Qafë Prush	LC - Më pak i rrezikuar	/
33.	<i>Scabiosa fumaroides</i> (Skabiozë si fomi)	Morinë	LC - Më pak i rrezikuar	/

Tabela 38. Llojet bimore nga Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Kosovë (KGJ, Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet, 2018)



Bimët me karakter endemik janë më të rrezikuara nga zhdukja dhe janë të përhapura në tërë Kosovën. Lokalitetet më të populluara nga bimë endemike paraqiten në Fig. 15, kurse bimët e këtij lloji që gjenden në territorin e komunës së Gjakovës dhe gjendja e tyre është paraqitur në tabelën 39.

Harta 7. Lokalitetet e bimëve endemike në Kosovë (AMMK, Biodiversiteti i Kosovës)

NR.	FAMILJA/LLOJI	LULËZIMI/ FRYTET	BIOTOPI	PËRHAPJA NË KOSOVË	PËRHAPJA E PËRGJITH- SHME	BIMË ENDEMIKE	GJENDJA
ASTERACEAE							
3	<i>Centaurea albertii</i> (Kokoçeli i Albertit)	VI-VII/ VIII-IX	Në vende shkëmbore dhe me bar të zonës kodrinore deri në 1000m l. Në substrate serpentine.	Devë, Golesh	Kosovë	E Kosovës	Të rrezikuara
BORAGINACEAE							
4	<i>Cynoglossum krasniqi</i> (Gjuhëqeni i Krasniqit)	IV-VI/VI	Në vende shkëmbore - gëlqerore	Pashtrik (Gorozhup)	Kosovë	E Kosovës	/

CRASSULACEAE							
9	Sempervivum kosaninii (Burgulli i Koshaninit)	VI-VII/ VIII-IX	Në shkëmbinj gëlqerorë ose serpentinerë të zonës subalpike dhe alpike	Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	Duhet të mbrohet me ligj
DIPSACACEAE							
10	Cephalaria pastricensis (Cefalaria e Pashtrikut)	VI-VII/ VIII	Në vende me bar, shkurre, pyje të zonës malore dhe subalpike	Pashtrik, Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	Të rrezikuara
FABACEAE							
11	Astragalus fiala (Arithja e Fialit)	VII/VIII	Në shkëmbinj të zonës alpine	Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	Të rrezikuara
12	Trifolium wettsteinii (Tërfili i Vetshtajnit)	VII-VIII / VIII-IX	Në kullosa subalpike dhe alpike	Pashtrik	Kosovë	E Ballkanit	E rrallë
LAMIACEAE							
14	Thymus albanus (Listra shqiptare)	V-VI / VIII-IX	Në vende të thata, shkurre, kullosa, pyje të zonës subalpike dhe alpike, në substrate gëlqerore	Oshlak, Koritnik, Alpet Shqiptare	/	E Ballkanit	Duhet të mbrohet me ligj
LILIACEAE							
17	Lilium albancum (Zambaku shqiptar)	VI-VII / VII	Në vende të freskëta shkëmbore të zonës malore - subalpike	Malet e Sharrit, Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	Duhet të mbrohet me ligj
RANUNCULACEAE							
19	Aconitum pentheri (Akoniti i Rusolisë)	VII/VIII	Në vende me shkurre dhe me bar të zonës malore dhe subalpike	Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	Të pakta (duhet të mbrohen)
SAXIFRAGACEAE							
	Saxifrage scardica (Iriqëza e Sharrit)	VI-VIII / VIII-X	Në shkëmbinj të zonës alpike	Koritnik, Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	Të rrezikuara

Wulfenia bleicii (Vulfenia e Bleçiçit)	VI-VIII / VIII	Në vende me bar, pyje e shkurre të zonës subalpike	Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	/
--	-------------------	--	--------------------	--------	-----------	---

Tabela 39. Disa lloje bimore me karakter endemik në territorin e Gjakovës (AMMK, Biodiversiteti i Kosovës)

FLORA DHE VEGJETACIONI I ZONAVE TË ULËTA MBIDETARE

Këto zona shtrihen përgjatë rrjedhës së lumenjve Drini i Bardhë dhe Ereniku, te i cili bashkohen Lumbardhi i Deçanit, Trava, Llukavci dhe së bashku derdhen në Drinin e Bardhë. Kralan-Rakovinë-Meqë-Doblibare-Berdosanë -Marmull-Bishtazhin-Rogovë janë relacionet që shtrihen përgjatë këtij lumi. Hapësirat tjera përgjatë rrjedhave tjera të lumenjve përfshijnë relacionet Zhdredhë-Bec-Vraniq-Doblibarë; Bitesh-Lugbunar-Qerim;Hereç-Pançor -Skivjan-Osek; Dobrosh-Nec-Smolice -Duzhnje;Batushë-Mulliq-Ponoshec-Popoc-Shishman-Babaj Bokës dhe Brekoc-Bishtazhin. Si pasojë e

aktivitetit njerëzor, në këto zona të fragmentuara shpesh rriten shkurre me shelg e plep, verr e marinë që i takojnë vegjetacionit pyjor. Llojet më dominante të këtyre lartësive në katin e drunjëve janë llojet: Salix alba (dominuese), Populus nigra, Ulmus effusa, Almus glutinosa, Salix fragilis. Në katin e shkurreve dominojnë bimët: Salix purpurea, Frangula alnus, Cornus sanguinea, Tamarix tetrandra. Në katin e bimëve barishtore rradhiten: Galium pallustre, Alisma plantago aquatica, Veronica anagallis, Mentha aquatica dhe Agrostis alba.

KATI I SHKURREVE	KATI I DRUNJVE	KATI I BARISHTEVE
Quercus-Fagetea	Salix alba (dominuese)	Galium pallustre
Alnetea glutinosae	Populus nigra	Alisma plantago aquatica
Alnetalia glutinosae	Ulmus effusa	Veronica anagallis
Populetalia albae	Almus glutinosa	Mentha aquatica
Alnion glutinosae	Salix fragilis	Agrostis alba

Tabela 40. Katet e llojeve të bimëve në zonat e ulëta mbidetare (KGJ, Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet, 2019-2024)

Nga hulumtimet në terren nga komuna e Gjakovës, janë gjetur bimë të llojit Quercus robur (Rrënjë, "Dushku

Rrënjë"), e cila tregon se dikur këto terrene ishin të mbuluara nga vegjetacioni dominues i fitocenozës

Periloco-Quercetum roburis, e cila tani nuk gjindet më si fitocenozë apo bashkësi bimore. Si pasojë e aktivitetit atropogjen, shumë nga këto hapësira

tani janë agroekosisteme, djerrina apo livadhe të aleancës Trifolion resupinati, rendit Trifolio-Hordetalia dhe klasës Molinio-Arrhenatheretea.

FLORA DHE VEGJETACIONI I ZONËS KODRINORE – MALORE

Këto zona shtrihen në lartësi mbidetare prej 500-800 (900) metra dhe mbulohen me pyje gjetherënëse si vegjetacion dominues dhe i takojnë klasës Querco-Fagetea, nga rendet Quercetalia pubescentis, Fagetalia sylvaticae, Quercetalia roburi petraeae, Prunetalia spinosae nga aleancat Ostryo-Caprinion orientalis, Quercion frainetto, Cotino-Cotoneastrion, Pruno tenelle-Syringion, Fagion moesiaceae, Quercion roburi-petraeae, Berberidion vulgaris dhe Cratego-Corylion. Vegjetacioni i klasës Querco-Fagetea shtihet në Jabllanicë, relacionet Jabllanicë - Kralan - Rakovicë - Rashkoc - Zhdredhë - Radoniq - Rakoc, Bitesh - Palabardh - Sopot - Bec - Brezinë; Sheremet - Mejë; Dobrosh - Berhjah; Popoc - Smolicë - Nec - Shishman; Koshare - Morinë; Zulfaj - Kusar - Lipovec - Pjetërshan - Kushavec - Bishtazhin dhe Damjan - Gërçinë - Goden.

Terrenet me lartësi mbidetare 1000-1500 m - në drejtim të Pashtrikut dhe në Bjeshkët e Nemuna përmbajnë hapësira me pyje të ahut (Fagetum moesiaceae montanum), që shpesh përzihen edhe me drunjë halorë.

Terrenet më të larta me lartësi mbidetare mbi 1500 m - gjinden poashtu në Bjeshkët e Nemuna dhe dallohen me pyje halore dhe me kullosa subalpike-alpikë në pjesët më të larta.

Në komunën e Gjakovës dallohen Kompleksi i Pishës së Zezë në Shkugëz dhe hapësira në rrethinën e Mulliqit si pjesë të kultivuara me bimë drunore halore kryesisht nga gjinia Pinus. Ato kanë rëndësi shkencore (si lloje endemike, relikte e klimazonale), kanë vlera ekonomike (për ushqim, mjekësi, ndërtimtari), dhe për ruajtjen e dheut nga erozioni. Pra, pamja e peisazhit, ekologjia dhe ekonomia e këtij territori përcaktohet nga vegjetacioni dhe fauna karakteristike.⁶⁹

FAUNA E KOSOVËS ⁸⁷

Vegjetacioni dhe flora e Kosovës dallohet për nga pasuria e specieve, por fauna zë rol po aq të rëndësishëm, meqë Kosova zë vend në radhën e vendeve me faunën më të pasur në Gadishullin Ballkanik. Këtë e

mundëson pozita gjeografike e vendit, relievi dhe faktorët tjerë ekologjikë e historikë, ku përfshihen Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna, Kopaoniku, dhe Mokna si zonat më të rëndësishme për nga pasuria e faunës.

⁶⁹ KGJ, Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet në Komunën e Gjakovës 2019-2024

Nga mbi 250 lloje të egra të kurrizorëve dhe një numri po aq të madh pakurrizorësh (200 lloje të njohura të fluturave, mbi 500 taksonë të makrozoobentosit të ujërave), Kosova ka dy rezervate strikte natyrore në të cilat janë të mbrojtura dy lloje të kafshëve: Rezervati i Rusenicës në komunën e Suharekës si vendbanim i rrëqebullit (*Lynx lynx*) dhe Bjeshka e Kozhnjerit në Komunën e

Deçanit si vendbanim i dhisë së egër (*Rupicapra rupicapra*).⁷⁰

Llojllojshmëria në popullatën e gjitarëve të mëdhenj mundësohet nga pyjet e larta dhe ekosistemet malore të Kosovës, Bjeshkëve të Nemuna në veçanti. Përveç gjitarëve, shpendët poashtu dëshmojnë larmi të rëndësishme jo vetëm për vendin, por edhe për Ballkanin dhe Evropën.




Figura 22. Numri i llojeve me status të mbrojtur në Kosovë 2018 (AMMK, Mjedisi i Kosovës – Raport i Treguesve Mjedisorë, 2020)

Prej këtyre llojeve, në Librin e Kuq të Faunës së Kosovës janë kategorizuar llojet sipas rrezikshmërisë. Sipas këtij kategorizimi, të rrezikuara janë grupet e insekteve – 140 lloje, peshqit – 15 lloje, gjitarët – 39 lloje, ujëtokësorët – 13 lloje dhe shpendët – 24 lloje.⁷¹

Sipas Librit të Kuq të Faunës së Kosovës, llojet e kafshëve janë kategorizuar në gjashtë kategori të IUCN-së sipas statusit të tyre, në: Të dhëna të pamjaftueshme (90 lloje), gati të kërcënuara (80 lloje), i rrezikuar (24

lloje), dhe skajshmërisht i rrezikuar (25 lloje). Kërcënimet e kanosura ndaj këtyre llojeve pasojnë nga përdorimi i burimeve biologjike, modifikimet e sistemeve natyrore, ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër, ndërhyrjet dhe aktivitetet njerëzore, ndotja nga zhvillimi urban e rezidencial, prerja e pakontrolluar e pyjeve, mbishfrytëzimi i ujërave sipërfaqësore për bujqësi e industri, ujërat e zeza urbane, modifikimi dhe degradimi i habitateve natyrore si dhe turizmi dhe rekreacionet pa kriteret e lokaliteteve.

⁷⁰ AMMK, Biodiversiteti i Kosovës

⁷¹ AMMK, Mjedisi i Kosovës – Raport i Treguesve Mjedisorë, 2020

GRUPET/ KATEGORITË	SKAJSHMË- RISHT I RRE- ZIKUAR (CR)	I RREZIKUAR (EN)	I CENUAR (VU)	GATI I KËRCËNUAR (NT)	SHQETËSIM I VOGËL (LC)	TË DHËNA TË PAMJAFTU- ESHME(DD)	TOTALI
GASTROPODA	-	-	10	10	-	-	20
BIVALVIA	-	1	-	2	-	-	1
OLIGOCHAETA	-	1	-	-	2	7	12
HIRUDINEA	-	-	-	-	-	2	2
ARACHNIDA	-	-	-	-	1	8	9
ARANEAE	-	-	-	-	1	7	8
MESOSTIGMATA	-	-	-	-	-	1	1
MALACOSTRACA	-	-	1	-	-	1	2
DIPLOPODA	-	-	3	-	-	6	9
INSECTA	20	11	19	42	13	35	140
EPHEMEROPTERA	-	4	-	4	2	2	12
PLECOPTERA	5	1	-	-	-	-	6
ODONATA	-	-	-	4	1	7	12
COLEOPTERA	-	-	3	2	4	17	26
MECOPTERA	-	-	-	-	-	1	1
DIPTERA	-	-	-	-	-	2	2
TRICHOPTERA	15	1	7	20	1	2	46
LEPIDOPTERA	-	5	9	12	5	4	35
CYCLOSTOMATA	-	-	-	1	-	-	1
ACTINOPTERYGII	1	1	1	4	2	5	14
AMPHIBIA	-	2	1	-	3	7	13
REPTILIA	-	-	1	8	8	3	20
AVES	3	6	4	4	-	7	24
MAMMALIA	1	2	1	9	17	9	39
TOTALI	25	24	41	80	46	90	306

Tabela 41. Kategorizimi i llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës sipas IUCN (MMPH, Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës, 2019)

Në kategorinë **skajshmërisht të rrezikuara (CR)** dallojmë disa specie insektesh, uJORësh dhe shpezësh të cilat lokalizohen në territorin e Komunës së Gjakovës. *Polycentropus ierapetra*, me trend të popullatës në rënie, me një lokalitet në Bjeshkët e Nemuna dhe numër të vogël të individëve. *Anguilla anguilla* (ngjala) e përhapur në Drinin e Bardhë te Ura e Fshejtë dhe në Mirushë, me trend popullimi në rënie të shpejtë në dy lokacione. *Aquila chrysaetos* (Shqiponja e maleve) e përhapur në Gropën e Erenikut, në Bajgorë dhe Zaplluxhë, me trend popullimi të panjohur dhe popullatë të izoluar me më pak se 50 individë të rritur. *Ardea cinerea* (Çapka e përhimë) e përhapur në Liqenin e Radoniqit, Vërmicë, Henc, Vasilevë, Kaçanik, Badovc, Kamenicë dhe Bishtazhin, preferon ujërat e ëmbra me vetëm 1 koloni folezues edhe trend të panjohur të popullimit.

Në kategorinë e llojeve **të rrezikuara (EN)** dallojmë: *Phengaris arion* (Kaltëroshja njollazezë) e përhapur në Junik, Strellc, Qafë të Morinës, Bjeshkët e Sharrit dhe Shkozë të Malishevës, me popullatë në rënie dhe numër shumë të vogël të individëve; *Aythya ferina* (Kryekuqe e mjeme) me përhapje në Radoniq, Henc, Obiliq dhe Graçanicë, me zonë të vogël të pranisë dhe trend të panjohur të popullimit.

Llojet **e cenuara (VU)** brenda territorit të Gjakovës kategorizohen me: *Strigilodelima pentheri* (guaskë fusiforme), lloj endemik i përhapur zakonisht në shkëmbinjë gëlqerorë të Pashtrikut, me trend të panjohur të popullimit, ku më pak se 50% e popullatës globale jeton në Kosovë; *Triloba sandrii* (guaskë fusiforme) me përhapje në Pashtrik dhe trend të popullatës në rënie si pasojë e prerjes

së pyjeve; *Rhyacophila bosnica* (Flutura e Bosnës) e vendeve ujore, e përhapur në përroskë të Bjeshkëve të Nemuna dhe të Bjeshkëve të Sharrit, me trend në rënie të popullatës me vetëm 8m² zonë të pranisë; *Cacharodus floccifera* (flutur) me përhapje në Pashtrik, Mirushë dhe Male të Shkozës, ka trend në rënie të popullatës si pasojë e degradimit të habitateve; *Phengaris alcon* (flutur) me përhapje në Qafë të Morinës, Pashtrik dhe Luboten, ka rënie në popullatë dhe numër të vogël individësh; *Alcedo atthis* (Bilbili i ujit) përhapur në Liqenin e Radoniqit, Badovc, Kamenicë, Obliliq, Fushë Kosovë dhe Liqenin e Livoqit, me habitate folezuese të kërcënuara nga prerja e pyjeve.

Llojet **gati të kërcënuara (NT)** në Gjakovë përfshijnë: *Drusus krusniki* (Flutura e Krushnikut) e përhapur në Bjeshkët e Nemuna me trend të qëndrueshëm të popullimit, por shtrirje të vogël; *Rhyacophila balcanica* (Flutura e Ballkanit) e përhapur në Bjeshkët e Nemuna në dy lokalitete, por me rënie të cilësisë së habitatit; *Rhyacophila fischeri* (Flutura e Fisherit) me përhapje në Bjeshkët e Nemuna, Bajgorë, Prishtinë, Llap dhe Sharr ka rënie në cilësinë e habitatit; *Carcharodus lavatherae* (lloj insekti) i përhapur në Pashtrik, Grykë të Rugovës dhe Strellc, është lloj i rrallë në nivel evropian; *Papilio machaon* (Flutura Bajrake) përhapet në Pashtrik, Lloqan, Oshlak, Kalanë e Prizrenit, Grykë të Rugovës, Brezovicë dhe Mirushë, me numër të vogël të individëve të regjistruar; *Eudontomyzon stankokaramani* (Kavalli i Drinit) me përhapje në Lumin Erenik te Prroni i Necit, në Lumin Erenik në Trava dhe në Lumbardhin e Pejës në Grabanicë, me habitate që rrezikohen nga aktivitetet njerëzore;

Emys orbicularis (Breshkujca) e përhapur në Gjakovë, Krushë, Komoran dhe Gjurakoc, me trend popullsie në rënie etj.

Llojet me **shqetësimin më të vogël (LC)** – llojet e grupeve oligochaeta, insecta, actinopterygii, amphibia, reptila dhe mammalia.⁷²

FAUNA NË KOMUNËN E GJAKOVËS

Pyjet e Gjakovës shtrihen kryesisht në pjesët anësore të komunës, në Bjeshkët e Nemuna, të Dushkajës dhe të Hasit. Zhvillimi i botës shtazore dallohet me kafshë të egra që banojnë në zona përreth e veçanërisht në Bjeshkët e Nemuna. Fauna e këtyre bjeshkëve përbëhet nga lloje të rralla të rajonit e të Ballkanit të gjitarëve dhe shpendëve, ku shumë prej tyre janë specie endemike, relikte dhe të kërcënuara nga zhdukja. Sipas hulumtimeve në terren, fauna e Bjeshkëve të Nemuna karakterizohet edhe me 8 lloje të peshqve, 13 lloje të ujëtokësorëve, 10 lloje rrëshqitësish, më shumë se 175 lloje shpendësh, 37 lloje gjitarësh dhe 129 lloje fluturash vetëm nga rendi Lepidoptera.⁷³

Peshqit (Pisces) – Rrjedha kryesore e Lumbardhit dhe përrrenjtë e shumtë të rrjedhave të shpejta që nuk shterin kurrë i takojnë ujërave të tipit salmonide, prandaj janë vendbanim i dy llojeve të troftës së përroit, *Salmo trutta* m. *Fario* L. dhe *Salmo marmoratus* C. Ky është lloji dominant në pjesët afër burimeve, kurse në vazhdim të grykave kjo përqindje ndërron me llojet Ciprinide si lloj dominues.

Ujëtokësorët (Amphibia) – Pjesa më e madhe e ujëtokësorëve gjenden në mjediset e ujërave vetëm në periudhën e shumimit, kurse pjesën dominuese të jetës e kalojnë në vende tjera, megjithatë me lagështi të

mjaftueshme. Në Bjeshkët e Nemuna ujëtokësorët përfaqësohen nga dy rende: Ujëtokësorët me bisht (Urodela), me një familje, 2 gjini dhe 6 lloje, si dhe ujëtokësorët pa bisht (Anura), të cilët hasen pranë vendeve pyjore me lagështi ose pranë sipërfaqeve ujore. Llojet e bretkosave zhvillohen vetëm në mjedis ujor. Në rendin e tyre hyjnë 5 familje me 7 lloje, si: Gargaliqi, bretkosa e malit, bretkosa e përrrenjve dhe bretkosa e kënetave.

Rrëshqitësit (Reptilia) – Nga 5 familje dhe 10 lloje të rrëshqitësve që jetojnë në Bjeshkët e Nemuna dallohen breshka e pyllit dhe e kënetave, hardhucat dhe gjarpërinjtë.

Shpendët (Ornitofauna) – Shumë nga shpendët e këtyre bjeshkëve janë lloje endemike dhe me status të rrezikuar në Ballkan e në Evropë, ku dallojmë 148 lloje të identifikuar, por mendohet të jenë mbi 200 të tilla të shpërndara në tërë sipërfaqen e Bjeshkëve të Nemuna. Pula e egër (*Tetrao urogallus*) dallohet për jetesën në lokalitete të vogla e specifike, kurse shpendët tjerë që gjinden më gjerë përshtijnë: Shqiponjën e maleve (*Aquila urogallus*), shqiponjën perandorake (*Aquila heliaca*), fajkoin (*Falco naumanni*), mbretin e shkurtës (*Crex crex*), drobenë e madhe (*Otis tarda*) dhe thëllëzën gurore (*Alectoris graeca*).

⁷² MMPH, Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës, 2019

⁷³ AMMK, Biodiversiteti i Kosovës

Gjitarët (Mammalofauna) – Bjeshkët e Nemuna dallohen me përfaqësimin e të gjitha llojeve të gjitarëve që jetojnë në territorin e Kosovës dhe Gadishullit Ballkanik. Brejtësit janë gjitarët më popullues, kurse gjitarët në përgjithësi kategorizohen në 3 lloje inektngrenëse, 19 lloje brejtës, 11 lloje mishngrënës, 1 lloj jopërtypës dhe 3 lloje jopërtypës. Rrëqebulli (*Lynx lynx*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), ujku (*Canis lupus*) dhe çakalli (*Canis aureus*) janë gjitarë në zhdukje në shkallë botërore.

Nga llojet shtazore të mbrojtura me ligj në Kosovë janë edhe disa lloje që jetojnë në territorin e Gjakovës dhe gjinden në Anex II të Direktivës së Habitaveve (92/42/EEC). Ato lloje janë: *Ursus arctos* (Ariu i murrmë), *Sciurus vulgaris* (Ketri), *Martes foina* (Sqarhi, Kunadhja gushbardhë), *Capreolus capreolus* (Kaprolli) dhe *Felis silvestris* (Macja e egër).

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në hulumtimin dhe analizën e raporteve mbi gjendjen mjedisore në Kosovë dhe Evropë, mund të përfundojmë se vendi ynë ka mangësi të theksuar në monitorimin e burimeve të ndotjes në mjedis, në përpunimin e të dhënave nga terreni dhe kontribuimin me të dhëna të sakta mbi cilësinë e ajrit, dheut dhe ujërave në raportet evropiane të monitorimit të gjendjes mjedisore.

IHMK-ja ka qendra monitorimi për cilësinë e ajrit në disa qytete, por nuk ka stacion monitorimi në komunën e Gjakovës, gjë e cila e bën të pamundur analizimin dhe ndërmarrjen e veprimeve të informuara për përmirësimin ose kontrollimin e cilësisë së ajrit. Në mungesë të stacioneve nga IHMK, ka disa iniciativa private të financuara për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe klimës në kohë reale, por të cilat nuk kanë të dhëna të mjaftueshme për prezentimin e historikut të cilësisë së ajrit për periudhë më të gjatë se njëditore ose njëjavore. Përveç temperaturës mesatare dhe dioksid karbonit, këto stacione nuk monitorojnë edhe shumë elemente të tjera të dëmshme në ajër, gjë që rrezikon mirëqenien e banorëve.

Edhe pse jo në të gjitha komunat, cilësia e ajrit monitorohet në 12 stacione të shpërndara nëpër Kosovë, por nuk ka sistem të instaluar për monitorimin e cilësisë së dheut. Iniciativat nga organizatat ndërkombëtare kanë bërë studimin e cilësisë së dheut në detaje në 17 komuna të Kosovës, por as në këtë rast Gjakova nuk është përfshirë në studim, duke e lënë atë edhe një hap prapa në monitorimin e gjendjes në mjedis. Si pasojë e mungesës së studimeve të mirëfillta për cilësinë dhe përfitimet nga menaxhimi i mirë i tokave, sektori i bujqësisë dhe i pylltarisë pëson më së shumti nga degraduesit natyrorë dhe njerëzorë, e me të edhe ekonomia dhe biodiversiteti.

Ujërat dhe jeta e gjallë në to rrezikohen përherë nga derdhja e pakontrolluar e ujërave të ndotur në to. Ndotësit kolektivë dhe individualë të ujërave sipërfaqësore në komunën e Gjakovës janë të identifikuar, por nuk ka dëshmi të kontrollimit të tyre dhe ruajtjes së ujërave nga ndotja e mëtejshme. Këto aktivitete të dëmshme të cilat izolojnë si probleme të institucioneve për monitorimin e ujërave, në fakt, përfshijnë gjithë botën e gjallë dhe ndikojnë drejtpërdrejt në rënien e biodiversitetit e me të edhe të cilësisë së ajrit dhe të dheut, duke mbyllur rrethin e ndërvarshmërisë së mirëqenies në natyrë.

REKOMANDIME:

1. **Të shtohen pikat e monitorimit të cilësisë së ajrit në vend, e veçanërisht në Komunën e Gjakovës, si komunë me industri e ekonomi specifike.** Me monitorim të saktë të vlerave në ajër, do të identifikoheshin edhe ndotësit kryesorë, gjë që do të mundësonte formulimin e strategjive dhe planeve për menaxhim më të mirë të cilësisë së ajrit.
2. **Integrimi i sistemit për ngrohje në sistem të njëtrajtshëm për qytetin ,** meqë aktualisht 13,571 objekte të banimit përdorin burimet e biomasës për ngrohje, që reflektohet në rënien drastike të cilësisë së ajrit gjatë muajve të ftohtë të vitit. Përveç cilësisë së ajrit, prerja e pakontrolluar e pyjeve ka ndikim të drejtpërdrejtë në biodiversitet, që është dëshmuar me trendin në rënie të popullsisë së shumë specieve që jetojnë në pyje.
3. **Marrja e praktikave të qëndrueshme për bujqësi dhe pylltari nga vendet evropiane dhe integrimi në politikat e komunës.** Përdorimi i tepruar i plehrave kimike dhe pesticideve dëmton cilësinë e dheut, të ujërave dhe të vlerave ushqyese të produkteve përfundimtare. Si një nga sektorët më ndotës në vend, menaxhimi i dheut duhet të bazohet në praktika të bollëkut, me mbjelljen e kulturave të ndryshme bujqësore dhe përzierjen e tyre me rrotullimin e mbjelljeve vjetore. Mangësi e theksuar është mungesa e trajnimit të shfrytëzuesve të plehrave kimike për përdorimin e tyre me masë të caktuar, pa efekte të mëdha në ajër dhe mjedis në përgjithësi. Bashkëpunimi ndërinsti-

tucional, angazhimi i ekspertëve të sektorit dhe realizimi i trajnimeve specifike do të ishin të nevojshme për të përmirësuar inventarin e të dhënave të gazrave serrë nga ky sektor.

Promovimi i riciklimit të mbeturinave dhe shtytja institucionale për përvetësimin e kësaj praktike nga bizneset dhe banorët përmes hapësirave të dedikuara, por edhe trajtimit të duhur përfundimtar të mbeturinave në deponinë transfer. Edhe pse janë ndërmarrë shumë iniciativa nga zyret lokale dhe organizatat e pavarura për riciklimin e mbeturinave, mënyra e trajtimit të tyre të mëtejshëm pas grumbullimit është i paqartë, sidomos në rastin kur komuna nuk ka deponi të veten sanitare, por vetëm stacion tranzitor para përcjelljes së tyre në deponinë e Prizrenit në Landovicë.

Promovimi dhe vetëdijesimi mbi ruajtjen e biodiversitetit përmes bashkëpunimit me MASHT dhe shkollat e drejtoritë e arsimit. Qëllimi do të përfshinte krijimin e grupeve dhe shoqatave mjedisore-ekologjike në të gjitha nivelet e arsimit, brenda dhe jashtë shkollës, përfshirja e metodave dhe teknologjike të përshtatshme për natyrë, si dhe fushata që e informojnë publikun mbi problemet me të cilat përballet ekosistemi, ndikimet e kësaj situatë në mirëqenien e qenieve të gjalla, duke përfshirë edhe njerëzit dhe përfshirja e publikut në procesin vendimmarrës.

SHTOJCAT

KODI	EMËRTIMI I ZONËS	KOMUNA/ZONA	SIPËRFAQJA (HA)	KATEGORIA SIPAS IUCN	VITI I MBROJTJES	PËRSHKRIMI I VLERAVE
REZERVAT STRIKT I NATYRËS (10,885.82 HA)						
RN_001	Kamilja	Leposaviq	228	lb	1988	Rezervat i veçantë natyror me veçori paleontologjike
RN_002	Lëndina e Shenjtë	PK. "Sharri"	17.98	/	2016	Rezervat bimor i llojit stenoendemik
RN_003	Shutman	PK. "Sharri"	5057	/	2016	/
RN_004	Bredhik	PK. "Sharri"	126.16	/	2016	Rezervat bimor i bredhit maqedonas dhe ariut të murrmë
RN_005	Pashallare	PK. "Sharri"	400	/	2016	Rezervat bimor i ekosistemeve të pyjeve të Rrobullit, Arnenit, Bredhit, Hormoqit, Dredhakut dhe Ahut.
RN_006	Koretnik	PK. "Sharri"	818	/	2016	Rezervat bimor i pyjeve endemorelikte të Rrobullit
RN_007	Gryka	PK. "Sharri"	103.98	/	2016	Rezervat bimor i llojit Fageto-taxetum baccata
RN_008	Lumbardhi	PK. "Sharri"	304	/	2016	/
RN_009	Lubeteni	PK. "Sharri"	202.16	/	2016	/
RN_010	Koblica	PK. "Sharri"	199	/	2016	/
RN_011	Dupnica	PK. "Sharri"	484	/	2016	/
RN_012	Bistra	PK. "Sharri"	642.12	/	2016	/
RN_013	Bjeshka e Kuzhnjerit/ Maja e Ropsit	PK. "Bjeshkët e Nemuna"	1,110.57	/	2016	Bimë të llojeve të molikës, bredhit, pishës, ahut dhe i dhisë së egër
RN_014	Majet e Prilepit	PK. "Bjeshkët e Nemuna"	106.04	/	2016	Bimë me përbërje të pastër të panjës malore dhe arnenit

RN_015	Gubavci	PK. "Bjeshkët e Nemuna"	76.86	/	2016	Bimë endemore-like boshtra
RN_016	Rusenica	PK. "Bjeshkët e Nemuna"	270	/	2016	Rrëqebulli
RN_017	Oshlaku	PK. "Sharri"	550.47	/	2016	Areneni i kuq dhe bimë endemike
RN_018	Maja e Arnenit	PK. "Sharri"	145.48	/	2016	Arnen i pastër i kuq
RN_019	Pisha e Madhe	PK. "Sharri"	44	/	2016	Arnen i pastër i kuq
PARK KOMBËTAR (115.957 HA)						
PK_001	Parku Kombëtar "Sharri"	Prizren, Suharekë, Kaçanik, Shtërpë, Dragash	53.469	II	(1986), 2012	Lloje relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës. Me vlera gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, speleologjike, kulturore, edukativo-arsimore dhe turistike
PK_002	Bjeshkët e Nemuna	Pejë, Gjakovë, Deçan, Istog, Junik	62.488	II	2013	Lloje relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës
MONUMENTE NATYRORE (6010.79 HA)						
MN_001	Mani Sham	Pejë	0.03	III	1957	Karakter botanik
MN_002	Rrapi në Marash	Prizren	0.05	III	1959	Karakter botanik
MN_003	Plepi në Bajçinë	Podujevë	0.05	III	1959	Karakter botanik
MN_004	Bliri në Isniq	Deçan	0.02	III	1968	Karakter botanik
MN_005	Trungjet e blirit në Isniq	Deçan	0.05	III	1968	Karakter botanik
MN_006	Shpella e Gadimes	Lypjan	39	III	1969	Karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_007	Mineralet - Kristalet	Mitrovicë	0.05	III	1970	Karakter gjeologjik dhe gjeomorfologjik
MN_008	Rrjedha e lumit Mirusha	Suharekë, Klinë, Malishevë	12	III	1983	Karakter hidrologjik

MN_009	Gryka e lumit Bistrica	Prizren	200	III	1976	Karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik dhe botanik
MN_010	Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radacit	Pejë	90	III	1983	Karakter hidrologjik, speleologjik dhe botanik
MN_011	Gryka e Rugovës	Pejë	4301	III	1985	Karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik dhe botanik
MN_012	Burimi i ujit mineral në Dresnik	Klinë	0.07	III	1985	Karakter hidrologjik
MN_013	Gryka e lumit Klina	Klinë	205	III	1985	Karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik dhe botanik
MN_014	Trungjet e bungut në Lozice	Malishevë	0.05	III	1985	Karakter botanik
MN_014	Trungu i qarrit në Zllakuçan	Klinë	0.05	III	1985	Karakter botanik
MN_016	Kanioni i Drinit të Bardhë	Gjakovë, Rahovec	198	III	1986	Karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik
MN_017	Shpella e Baicës	Drenas	0.11	III	1987	Karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_018	Shpella e Gllanasellës	Drenas	0.5	III	1987	Karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_019	Burimi termomineral në Vuqë	Leposaviq	16.6	III	1987	Karakter hidrologjik
MN_020	Burimi i ujit mineral në Sallabajë	Podujevë	0.31	III	1988	Karakter hidrologjik
MN_021	Burimi i ujit në Shajkovc	Podujevë	1.41	III	1988	Karakter hidrologjik
MN_022	Trungu i qarrit në Pollatë	Podujevë	0.44	III	1988	Karakter botanik
MN_023	Trungu i qarrit në Dobratin	Podujevë	0.07	III	1988	Karakter botanik
MN_024	Trungjet e rrënjës në Nekovc	Drenas	0.05	III	2006	Karakter botanik

MN_025	Kompleksi i trungjeve rrënjë në Negroc	Drenas	0.05	III	2006	Karakter botanik
MN_026	Trungjet e Shpardhit në Negroc	Drenas	0.05	III	2006	Karakter botanik
MN_027	Shpella e Kishnarekës	Drenas	2	III	2006	Karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_028	Trungu i qarrit në Krajkovë	Drenas	0.05	III	2006	Karakter botanik
MN_029	Guri i Gradinës në Llapushnik	Drenas	2	III	2006	Karakter gjeomorfologjik
MN_030	Burimi i ujit mineral në Poklek	Drenas	0.05	III	2006	Karakter hidrologjik
MN_031	Trungjet e dushkut – Gjashtë lisat në Likoshan	Drenas	0.05	III	2006	Karakter botanik
MN_032	Trungjet e dushkut në Tërstenik	Drenas	0.05	III	2006	Karakter botanik
MN_033	Trungjet e dushkut në Likoshan	Drenas	0.05	III	2006	Karakter botanik
MN_034	Guri i plakës në Dobroshec	Drenas	0.05	III	2006	Karakter botanik
MN_035	Trungu bungëbutës në Aqarevë	Skenderaj	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_036	Trungjet e dushkut në Polac	Skenderaj	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_037	Trungu i dushkut në Likoc	Skenderaj	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_038	Burimi i ujit në Banjë	Skenderaj	0.1	III	2007	Karakter hidrologjik
MN_039	Trungu i dushkut në Prelloc	Skenderaj	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_040	Kompleksi i trungjeve të dushkut në Rrezallë	Skenderaj	0.02	III	2007	Karakter botanik
MN_041	Kompleksi i trungjeve të bungbutës në Klladernicë	Skenderaj	0.1	III	2007	Karakter botanik

MN_042	Trungu i qarrit në Kotorr	Skenderaj	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_043	Trungu i qarrit në Padalishtë	Skenderaj	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_044	Trungu i bungëbutës në Çitak	Skenderaj	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_045	Trungu i qarrit në Runik	Skenderaj	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_046	Burimi i ujit të njelmët, në Leqinë	Skenderaj	0.05	III	2007	Karakter hidrologjik
MN_047	Trungu i bungut në Lubovec	Skenderaj	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_048	Trungu i rrënjës në Deiq	Klinë	0.03	III	2007	Karakter botanik
MN_049	Kompleksi i trungjeve të rrënjës në Gllarevë	Klinë	0.28	III	2007	Karakter botanik
MN_050	Trungu i qarrit në Nagllavkë	Klinë	0.12	III	2007	Karakter botanik
MN_051	Burimi i ujit mineral në Rudicë	Klinë	0.07	III	2007	Karakter hidrologjik
MN_052	Trungu i bungut në Ujëmir	Skenderaj	0.2	III	2008	Karakter botanik
MN_053	Trungjet e dushkut në Breshanc	Suharekë	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_054	Kompleksi i trungjeve të dushkut në Savrovë	Suharekë	0.15	III	2007	Karakter botanik
MN_055	Trungu i pishës në Delloc	Suharekë	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_056	Trungjet e dushkut në Grejkoc	Suharekë	0.15	III	2007	Karakter botanik
MN_057	Trungu i plepit në Reçan	Suharekë	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_058	Burimi i ujit mineral në Reçan	Suharekë	0.1	III	2007	Karakter hidrologjik
MN_059	Kompleksi i trungjeve të dushkut në Muhlan	Suharekë	0.15	III	2007	Karakter botanik

MN_060	Trungu i vodhës në Budakovë	Suharekë	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_061	Kompleksi itrungjeve të dushkut në Papaz	Suharekë	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_062	Dy trungjet e bungut në Bllacë	Suharekë	0.1	III	2007	Karakter botanik
MN_063	Trungu i qarrit Vraniq	Suharekë	0.05	III	2007	Karakter botanik
MN_064	Lokaliteti i bujgerit në Biraqë	Suharekë	0.1	III	2007	Karakter botanik
MN_065	Kompleksi i trungjeve të bungiit në Luzhnicë	Suharekë	0.15	III	2007	Karakter botanik
MN_066	Guri i xhamisë në Luzhnicë	Suharekë	0.15	III	2007	Karakter gjeomorfologjik
MN_067	Dy trungjet e manit të zi në Cerrcë	Istog	0.11	III	2008	Karakter botanik
MN_068	Trungu i blirit të argjendtë në Lubozhdë	Istog	0.1	III	2008	Karakter botanik
MN_069	Trungu i blirit të kuq në Istog të Poshtëm	Istog	0.05	III	2008	Karakter botanik
MN_070	Trungu i bungbutës në Sinaj	Istog	0.17	III	2008	Karakter botanik
MN_071	Trungu i blirit të argjendtë në Shushicë të Epërme	Istog	0.05	III	2008	Karakter botanik
MN_072	Burimi i ujit natyral në Istog	Istog	3.88	III	2008	Karakter hidrologjik
MN_073	Trungu i vodhës në Uçë	Istog	0.07	III	2008	Karakter botanik
MN_074	Trungu i blirit të argjendtë në Kaliqan	Istog	0.05	III	2008	Karakter botanik
MN_075	Burimi i ujit termal në Banjë	Istog	0.58	III	2008	Karakter hidrologjik
MN_076	Trungu i blirit të kuq në Lubovë	Istog	0.07	III	2008	Karakter botanik
MN_077	Trungu i rrënjës në Zallq-Zabllaq	Istog	0.11	III	2008	Karakter botanik

MN_078	Trungu i rrënjës në Trubuhoc	Istog	0.07	III	2008	Karakter botanik
MN_079	Trungu i rrënjës në Saradran	Istog	0.05	III	2008	Karakter botanik
MN_080	Trungu i qarrit në Gurrakoc	Istog	0.01	III	2008	Karakter botanik
MN_081	Burimi i ujit në Vrellë	Istog	0.26	III	2008	Karakter hidrologjik
MN_082	Ujëvarat e Mirushës	Malishevë, Klinë, Rahovec	598.4	III	2012	Karakter gjeomorfologjik, hidrologjik, speleologjik, botanik, peisazhor
MN_083	Trungu i qarrit në Lladrovç	Malishevë	0.08	III	2014	Karakter botanik
MN_084	Shpella e Temeqinës	Malishevë	0.69	III	2014	Karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_085	Trungu i qarrit në Carravranë	Malishevë	0.08	III	2014	Karakter botanik
MN_086	Trungu bungëbutës në Llozicë	Malishevë	0.08	III	2014	Karakter botanik
MN_087	Trungu bungëbutës në Llozicë	Malishevë	0.07	III	2014	Karakter botanik
MN_088	Shpella e Bozhurit në Damanek	Malishevë	2	III	2014	Karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_089	Shpella e Lladroviqit	Malishevë	2	III	2014	Karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_090	Trungu i bungëbutës Guriq	Malishevë	0.05	III	2014	Karakter botanik
MN_091	Trungu i qarrit në Denovc	Malishevë	1.25	III	2014	Karakter botanik
MN_092	Trungu i qarrit në Bubël	Malishevë	0.08	III	2014	Karakter botanik
MN_093	Trungu i qarrit në Bubël	Malishevë	0.8	III	2014	Karakter botanik
MN_094	Trungu i qarrit në Bellanic	Malishevë	0.8	III	2014	Karakter botanik
MN_095	Trungu i frashrit në Javiq	Malishevë	0.8	III	2014	Karakter botanik
MN_096	Vakëfi i Vërmicës	Malishevë	0.7	III	2014	Karakter botanik
MN_097	Zabeli dhe Vrella në Javiq	Malishevë	0.51	III	2014	Karakter botanik

MN_098	Burimi i ujit në Carravranë	Malishevë	9.76	III	2014	Karakter hidrologjik
MN_099	Shpella e Ponorcit	Malishevë	279	III	2014	Karakter speleologjik
MN_100	Bifurkacioni i lumit Nerodime	Ferizaj	15	III	2015	Karakter morfologjik dhe hidrologjik
MN_101	Shpella e Shullanit në Sllatinë	Kaçanik	1	III	2015	Karakter speleologjik
MN_102	Humnera në shpatin e Qenares, në Gllloboqinë	Kaçanik	1	III	2015	Karakter speleologjik
MN_103	Trungjet e qarrit në Kaçanikun e vjetër	Kaçanik	0.05	III	2015	Karakter botanik
MN_104	Guri i gjatë në Stagovë	Kaçanik	1	III	2015	Karakter gjeomorfologjik
MN_105	Guri i Zi në Llanishtë	Kaçanik	0.20	III	2015	Karakter botanik
MN_106	Trungjet e qarrit në Kaçanikun e vjetër	Kaçanik	0.05	III	2015	Karakter botanik
MN_107	Trungjet e qarrit në Kovaqec	Kaçanik	0.05	III	2015	Karakter botanik
MN_108	Trungjet e Bungut në Bob	Kaçanik	0.05	III	2015	Karakter botanik
MN_109	Kompleksi i trungjeve të dushkut në Runjev	Kaçanik	0.05	III	2015	Karakter botanik
MN_110	Trungu i shलगut në Kaçanik	Kaçanik	0.05	III	2015	Karakter botanik
MN_111	Trungjet e Dushkut në Ivajë	Kaçanik	0.05	III	2015	Karakter botanik
MN_112	Trungu i qarrit në Kottinë	Kaçanik	0.05	III	2015	Karakter botanik
MN_113	Vrella e Zezë në Petrovë	Shtime	2	III	2015	Karakter hidrologjik
MN_114	Shpella e Imer Devetakut në Devetak	Shtime	2	III	2015	Karakter speleologjik

MN_115	Trungjet e dushkut në Mollapolc	Shtime	0.05	III	2015	Karakter botanik
MN_116	Lisi i Sahitit në Godanc i Epërm	Shtime	0.05	III	2015	Karakter botanik
MN_117	Lisi i Alushit në Rashincë	Shtime	0.05	III	2015	Karakter botanik
MN_118	Shpella e Pjetërshiticës në Pjetërshicë	Shtime	0.05	III	2015	Karakter speleologjik
MN_119	Lisat Binjak në Godanc të epërm	Shtime	0.05	III	2015	Karakter botanik
MN_120	Gështenjat e Shtimes në Shtime	Shtime	0.50	III	2015	Karakter botanik
MN_121	Shpella e Devetakut dhe Burimi në Devetak	Shtime	2	III	2015	Karakter speleologjik dhe hidrologjik
MN_122	Trungu i shpardhit në Dyz	Podujevë	0.5	III	2015	Karakter botanik
MN_123	Trungjet e dushkut në Llapashticën e Epërme	Podujevë	0.10	III	2015	Karakter botanik
MN_124	Trungu i dushkut në Llapashticën e Epërme	Podujevë	0.5	III	2015	Karakter botanik
MN_125	Vrella dhe trungu i ahut në Dobratin	Podujevë	0.10	III	2015	Karakter botanik dhe hidrologjik
MN_126	Trungu i plepit në Murgullë	Podujevë	0.5	III	2015	Karakter botanik
MN_127	Trungu i plepit në Gërdoc	Podujevë	0.5	III	2015	Karakter botanik
MN_128	Trungu i plepit në Orllan	Podujevë	0.5	III	2015	Karakter botanik
MN_129	Trungu Trungjet e shpardhit, dushkut në Zhilivodë	Vushtrri	0.10	III	2016	Karakter botanik
MN_130	Trungjet e dushkut në Druar	Vushtrri	0.10	III	2016	Karakter botanik
MN_131	Kompleksi i trungjeve të dushkut në Galicë	Vushtrri	0.15	III	2016	Karakter botanik

MN_132	Reungu i bungut në Shitaricë	Vushtrri	0.5	III	2016	Karakter botanik
MN_133	Trungu i rrënjës në Dumnicë e Llugës	Vushtrri	0.5	III	2016	Karakter botanik
MN_134	Burimi i ujit termomineral në Gjelbishtë	Vushtrri	0.10	III	2016	Karakter hidrologjik
MN_135	Trungu i qarrit në Ceceli	Vushtrri	0.5	III	2016	Karakter botanik
MN_136	Trungu i frashërit në Kaznik	Rahovec	0.8	III	2016	Karakter botanik
MN_137	Trungu i shpardhit në Kaznik	Rahovec	0.35	III	2016	Karakter botanik
MN_138	Trungjet e dushkut në Dobidol	Rahovec	0.13	III	2016	Karakter botanik
MN_139	Trungu i shpardhit në lagjen e Berishajve në Drenoc	Rahovec	0.4	III	2016	Karakter botanik
MN_140	Trungu i shpardhit në lagjen e Me-hovce-Drenoc	Rahovec	0.4	III	2016	Karakter botanik
MN_141	Trungu i bungut Nagavc	Rahovec	0.5	III	2016	Karakter botanik
MN_142	Trungu i qarrit dhe i vidhit në Bratotin	Rahovec	0.7	III	2016	Karakter botanik
MN_143	Trungu i shpardhit në Bratotin	Rahovec	0.4	III	2016	Karakter botanik
MN_144	Shpella e "Bali Agës" në Zatriq	Rahovec	1	III	2016	Karakter speleologjik
MN_145	Shpella e Peshterrit në Zatriq	Rahovec	0.7	III	2016	Karakter speleologjik
PARK I NATYRËS (5.934 HA)						
PN_002	Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës	Gjakovë, Prizren	5.934	V	2015	Vlera biologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, kulturore dhe turistike

PEISAZH I MBROJTUR (2437 HA)						
PM_001	Shkugëza	Gjakovë	70	V	2011	Vlera floristike, edukative, turistike
PM_002	Pishat e Deçanit	Deçan	15	V	1969	Vlera floristike, edukativo-arsimore dhe turistike
PM_003	Kompleksi i pishave në Strazhë	Kaçanik	25	V	2015	Vlera floristike, edukativo-arsimore dhe turistike
PM_004	Kompleksi i pishave në Shtime	Shtime	25	V	2015	Vlera floristike, edukativo-arsimore dhe turistike
PM_005	Gërmia	Prishtinë	2.302	V	2016	Rëndësi shkencore, edukative, kulturore dhe turistike
ZONË E VEÇANTË E MBROJTUR E ZOGJVE (109.5/HA)						
ZVM_001	Zonë e veçantë e mbrojtur e zogjve	Fushë Kosovë, Graçanicë, Lipjan	109.5	V	2014	Vlera ornitologjike, ihtiologjike, idrogjeologjike, botanike dhe peisazhore

Shtojca 1. AMMK, Zonat e Mbrojtura Natyrore

NR.	FAMILJA/LLOJI	LULËZIMI/FRYTET	BIOTOPI	PËRHAPJA NË KOSOVË	PËRHAPJA E PËRGJITHSHME	BIMË ENDEMIKE	GJENDJA
ARISTOLOCHIACEAE							
1	Aristolochia merxmuelleri (Petriku i Grojterit)	IV / V-VI	Në terrene ranore – gurore pranë shkurreve, në substrate serpentinore të zonës kodrinore-malore	Rajoni i Mirushës	Kosovë	E Kosovës	Të zhvilluara mirë, por me areal të kufizuar
ASTERACEAE							
2	Achillea alexandri (Barpezmi i mbretit Aleksandër)	VII / VIII	Në vende barishtore dhe në pyllin e çetina-kut të zonës alpikë në shkëmbinj gëlqerorë	Malet e Sharrit (Oshlak)	Kosovë	E Kosovës (steno-endemike)	Të zhvilluara mirë, por me areal të kufizuar

3	<i>Centaurea albertii</i> (Kokoçeli i Albertit)	VI-VII/ VIII-IX	Në vende shkëmbore dhe me bar të zonës kodrinore deri në 1000m l. Në substrate serpentine.	Devë, Golesh	Kosovë	E Kosovës	Të rrezikuara
BORAGINACEAE							
4	<i>Cynoglossum krasniqii</i> (Gjuhëqeni i Krasniqit)	IV-VI/VI	Në vende shkëmbore - gëlqerore	Pashtrik (Gorozhup)	Kosovë	E Kosovës	/
BRASSICACEAE							
5	<i>Bornmuellera direckii</i> (Bornmulera e Degenit)	VI-VII / VIII	Në vende shkëmbore – serpentinore të zonës malore dhe subalpike	Ostrovicë (1500-1900 m l.)	Kosovë	E Kosovës	E rrallë
CARYOPHYLLACEAE							
6	<i>Diantus scardius</i> (Karafili i Sharrit)	VI-VII / VIII	Në vende shkëmbore dhe me bar të zonës subalpike dhe alpikë	Malet e Sharrit (Luboten, Prevallac)	Kosovë	E Kosovës	Të rrezikuara
CONVOLVULACEAE							
7	<i>Convolvulus cochlearis</i> (Dredhja e Kosovës)	VI-VII / VIII	Në vende me bar dhe gurishtore të zonës kodrinore me natyrë serpentine	Gorancë (territori i Hanit të Elezit)	Kosovë	E Kosovës	E rrallë
CRASSULACEAE							
8	<i>Sedum flexuosum</i> (Rrushqyqja e ephsme)	VII-VIII / IX	Në vende shkëmbore, sidomos gëlqerore, të zonës subalpike	Malet e Sharrit (Luboten, Oshlak)	Kosovë	E Kosovës	E rrallë
9	<i>Sempervivum kosaninii</i> (Burgulli i Koshaninit)	VII-VIII / IX	Në shkëmbinj gëlqerorë ose serpentinorë të zonës subalpike dhe alpikë	Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	Duhet të mbrohet me ligj
DIPSACACEAE							
10	<i>Cephalaria pastricensis</i> (Cefalaria e Pashtrikut)	VI-VII/ VIII	Në vende me bar, shkurre, pyje të zonës malore dhe subalpike	Pashtrik, Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	Të rrezikuara

FABACEAE							
11	Astragalus fiala (Arithja e Fialit)	VII/VIII	Në shkëmbinj të zonës alpine	Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	Të rrezikuara
12	Trifolium wettsteinii (Tërfili i Vetshtajnit)	VII-VIII / VIII-IX	Në kullosa subalpike dhe alpike	Pashtrik	Kosovë	E Ballkanit	E rrallë
LAMIACEAE							
13	Micromeria albanica (Bishtmju shqiptar)	VII-VIII / VIII-IX	Në vende shkëmbore - gëlqerore të zonës kodrinore - malore	Gryka e Lumbardhit të Prizrenit	Kosovë	E Kosovës	E rrallë
14	Thymus albanus (Listra shqiptare)	V-VI / VIII-IX	Në vende të thata, shkurre, kullosa, pyje të zonës subalpike dhe alpike, në substrate gëlqerore	Oshlak, Koritnik, Alpet Shqiptare	/	E Ballkanit	Duhet të mbrohet me ligj
15	Thymus doerfleri (Listra e Dorflerit)	VI-VII / VIII-IX	Në vende të thata, pyje të rralla të zonës malore subalpike	Koritnik	Kosovë	E Kosovës	Të pakta
16	Thymus rochlenae (Listra e Rohlenes)	VI / VII	Në kullosa, livadhe të zonës malore dhe subalpike	Oshlak, Rrethina e Deçanit	Kosovë	E Kosovës	Të rrezikuara
LILIACEAE							
17	Lilium albancicum (Zambaku shqiptar)	VI-VII / VII	Në vende të freskëta shkëmbore të zonës malore - subalpike	Malet e Sharrit, Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	Duhet të mbrohet me ligj
POACEAE							
18	Stipa mayer (Pendëkaposhi i Mayerit)	V-VI / VII	Në kullosa me natyrë serpentinore	Koznik, Rajoni i Mirushës, Godanc etj.	Kosovë	E Kosovës	Duhet të mbrohet me ligj
RANUNCULACEAE							
19	Aconitum pentheri (Akoniti i Rusolisë)	VII/VIII	Në vende me shkurre dhe me bar të zonës malore dhe subalpike	Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	Të pakta (duhet të mbrohen)

ROSACEAE							
20	Potentilla calabra (Zorrëca e Kalabrisë)	VII-VIII / VIII	Në shkëmbinj acidikë me prejardhje vullkanike në lartësi mbidetare 2000 m	Malet e Sharrit, Guri i Zi	Kosovë	E Kosovës	Të rrezikuara
	Potentilla doerfleri (Zorrëca e Dorflerit) Rubus ipecensis	VII-VIII / IX	Në vende me bar dhe shkëmbore të zonës alpike	Malet e Sharrit, Bistra, Maja e Zezë	Kosovë	E Ballkanit	E rrallë
	Rubus ipecensis (Manaferra e Pejës)	/	Në vende shkurre serpentine	Gubavc (Pejë)	Kosovë	E Kosovës	Të rrezikuara
SAXIFRAGACEAE							
	Saxifrage scardica (Iriqëza e Sharrit)	VI-VIII / VIII-X	Në shkëmbinj të zonës alpike	Koritnik, Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	Të rrezikuara
	Verbascum scardicum (Barpeshku i Sharrit)	VII-VIII / VIII	Në kullosa e shkurre të zonës subalpike	Malet e Sharrit (Oshlak)	Kosovë (vetëm në Kosovë)	E Kosovës	Të rrezikuara
	Wulfenia blecicii (Wulfenia e Bleçiqit)	VI-VIII / VIII	Në vende me bar, pyje e shkurre të zonës subalpike	Alpet Shqiptare	Kosovë	E Kosovës	/
VIOLACEAE							
	Viola gracilis (Vjollca barishtore)	VI-VII / VII	Në kullosa të zonës alpike	Malet e Sharrit	Kosovë	E Kosovës	Në grupe të vogla ose mëdha

Shtojca 2. Disa lloje bimore me karakter endemik në territorin e Gjakovës (AMMK, Biodiversiteti i Kosovës)

SHTOJCA 3 – KATEGORITË E IUCN-SË SIPAS KATEGORIVE DHE KRITEREVE TË LISTËS SË KUQE TË IUCN-SË: VERZIONI 3.1-2012

- **I zhdukur (EX)** - Taksoni është zhdukur dhe nuk ka asnjë dyshim të arsyeshëm se nuk ka vdekur. Taksoni konsiderohet i zhdukur kur hulumtimet në habitatin e njohur ose të pritshëm, në kohëtë përshtatshme (ditore, stinore, vjetore), përgjatë rangut të tij historik nuk kanë arritur të regjistrojnë një individ.
- **I zhdukur në natyrë (EW)** - Një takson është i zhdukur në natyrë kur dihet se mbijeton vetëm në kultivim, në robëri ose si popullatë e natyralizuar jashtë rangut të kaluar të taksonit. Ai takson konsiderohet i zhdukur në natyrë kur hulumtimet në habitatin e njohur ose të pritshëm, në kohë të përshtatshme (ditore, stinor, vjetore), përgjatë rangut të tij historik, nuk kanë arritur të regjistrojnë një individ.
- **I zhdukur në rajon (RE)** - Është kategori rajonale për një takson kur nuk ka asnjë dyshim të arsyeshëm se individ i fundit i aftë për riprodhim brenda rajonit ka vdekur ose është zhdukur nga natyra ose kur është një ish-taksin vizitues, individ i fundit ka vdekur ose është zhdukur nga rajoni. Përcaktimi i afatit kohor për listim në këtë kategori i lihet në diskrecion autoritetit rajonal të Listës së Kuqe, por duhet të paraprijë datën 1500 p.e.s.
- **Skajshmërisht i rrezikuar (CR)** - Një takson është skajshmërisht i rrezikuar kur dëshmitë më të mira të disponueshme tregojnë se ai plotëson ndonjërin nga kriteret A deri në E për këtë kategori dhe për këtë arsye konsiderohet se përballet me rrezik jashtëzakonisht të lartë të zhdukjes në natyrë.
- **I rrezikuar (EN)** - Një takson është i rrezikuar kur dëshmitë më të mira të disponueshme tregojnë se ai plotëson ndonjërin nga kriteret A deri në E për këtë kategori dhe për këtë arsye konsiderohet se përballet me një rrezik shumë të lartë të zhdukjes në natyrë.
- **I cenuar (VU)** - Taksoni është i cenuar kur dëshmitë më të mira të disponueshme tregojnë se ai plotëson ndonjërin nga kriteret A deri në E për këtë kategori dhe prandaj po përballet me rrezik të lartë të zhdukjes në natyrë.
- **Gati i kërcënuar (NT)** - Një takson është gati i kërcënuar kur vlerësimi i tij është bërë sipas kriterëve, por aktualisht nuk klasifikohet në kategori të Skajshmërisht i rrezikuar, i rrezikuar ose i cenuar, por është afër kualifikimit ose do të jetë në të ardhmen e afërt.
- **Shqetësim më i vogël (LC)** - Taksoni i takon kësaj kategorie kur edhe pas vlerësimit sipas kriterëve, nuk kualifikohet për kategori të Skajshmërisht i rrezikuar, i rrezikuar, i cenuar ose Gati i kërcënuar. Në këtë kategori hyjnë llojet e përhapura gjithandej dhe me dendësi të madhe.

- **Të dhëna të pamjaftueshme (DD)** – Taksoni që i përket kësaj kategorie ka mungesë të informacioneve adekuate për të bërë vlerësim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të rrezikut të zhdukjes, bazuar në përhapjen ose statusin e popullatës. Taksoni i kësaj kategorie mund të jetë i studiuar mirë dhe i njohur, por mungojnë të dhëna në lidhje me dendësinë dhe përhapjen e tij. Prandaj, kjo kategori nuk është kategori kërcënimi, por indikon se kërkohen më shumë të dhëna nga hulumtimet e ardhshme që tregojnë nëse klasifikimi i kërcënueshmërisë është i përshtatshëm.
- **I zhdukur në natyrë (EW)** – Një takson është i zhdukur në natyrë kur dihet se mbijeton vetëm në kultivim, në robëri ose si popullatë e natyralizuar jashtë rangut të kaluar të taksonit. Ai takson konsiderohet i zhdukur në natyrë kur hulumtimet në habitatin e njohur ose të pritshëm, nëkohë të përshtatshme (ditore, stinor, vjetore), përgjatë rangut të tij historik, nuk kanë arritur të regjistrojnë një individ.
- **I pavlerësuar (NE)** – Kur taksoni nuk është vlerësuar ende sipas kritereve.
- **I paaplikueshëm (NA)** – Kategori e cila konsideron një takson të papërshtatshëm për vlerësim në nivel rajonal. Taksoni mund të jetë i paaplikueshëm sepse nuk i takon një popullate natyrore ose nuk është brenda vargut të tij natyror në rajon, ose është kalimtar në rajon. Ai mund të jetë në numër shumë të vogël i prezantuar në rajon ose taksoni mund të klasifikohet në nivel më të ulët taksonik sesa konsiderohet e pranueshme nga autoriteti rajonal i Listës së Kuqe.

BIBLIOGRAFIA

WORLD HEALTH ORGANISATION (2021): AMBIENT AIR POLLUTION: POLLUTANTS

[HTTPS://WWW.WHO.INT/AIRPOLLUTION/AMBIENT/POLLUTANTS/EN/](https://www.who.int/airpollution/ambient/pollutants/en/)

EUROPEAN ENVIRONMENT AGENCY (2020): AIR QUALITY IN EUROPE – 2020 REPORT

[HTTPS://WWW.EEA.EUROPA.EU/PUBLICATIONS/AIR-QUALITY-IN-EUROPE-2020-REPORT](https://www.eea.europa.eu/publications/air-quality-in-europe-2020-report)

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR (2018): STRATEGJIA PËR NDRYSHIME KLIMATIKE 2019-2028 DHE PLANI I VEPRIMIT PËR NDRYSHIME KLIMATIKE 2019-2021

[HTTPS://KONSULTIMET.RKS-GOV.NET/STORAGE/CONSULTATIONS/14-13-59-04102018/SNK_PVNK_5%20TETOR_2018_FINAL\[1\].PDF](https://konsultimet.rks-gov.net/storage/consultations/14-13-59-04102018/SNK_PVNK_5%20TETOR_2018_FINAL[1].PDF)

ALIU, M. (2007). GJENDJA E PËRGJITHSHME MJEDISORE NË KOSOVË, PROPOZIME DHE SUGJERIME. PRISHTINË KOSOVË: KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE E UIP

[HTTPS://WWW.RESEARCHGATE.NET/PUBLICATION/289511362_GJENDJA_E_PERGJITHSHME_MJEDISORE_NE_KOSOVE_PROPOZIME_DH_E_SUGJERIME](https://www.researchgate.net/publication/289511362_GJENDJA_E_PERGJITHSHME_MJEDISORE_NE_KOSOVE_PROPOZIME_DH_E_SUGJERIME)

WORLD BANK (2019): AIR POLLUTION MANAGEMENT IN KOSOVO – 2019 REPORT

[HTTPS://OPENKNOWLEDGE.WORLDBANK.ORG/BITSTREAM/HANDLE/10986/33041/AIR-POLLUTION-MANAGEMENT-IN-KOSOVO.PDF?SEQUENCE=1&ISALLOWED=Y](https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/33041/air-pollution-management-in-kosovo.pdf?sequence=1&isAllowed=y)

WORLD BANK GROUP (2019): KOSOVO: A FUTURE OF GREEN TRANSPORT AND CLEAN AIR – 2019 REPORT

[HTTPS://OPENKNOWLEDGE.WORLDBANK.ORG/BITSTREAM/HANDLE/10986/32283/KOSOVO-A-FUTURE-OF-GREEN-TRANSPORT-AND-CLEAN-AIR.PDF?SEQUENCE=1&ISALLOWED=Y](https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/32283/kosovo-a-future-of-green-transport-and-clean-air.pdf?sequence=1&isAllowed=y)

INSTITUTI GAP (2016): REGJISTRIMI I VETURAVE SIPAS REGJIONEVE

[HTTPS://VETURAT.INSTITUTIGAP.ORG/#REGJISTRIMI-SIPAS-REGJIONEVE](https://veturat.institutigap.org/#regjistrimi-sipas-regjioneve)

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT (2015): EMETIMI I GAZRAVE SERRË NË KOSOVË 2008-2013 – 2015 RAPORT

[HTTPS://WWW.AMMK-RKS.NET/REPOSITORY/DOCS/RAPORTI_GHG_2008-2013.PDF](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/raporti_ghg_2008-2013.pdf)

MANDAL, A. SARKAR, B. MANDAL, S. VITHANAGE, M. PATRA, A. MANNA, M. (2020). IMPACT OF AGROCHEMICALS ON SOIL HEALTH. IN AGROCHEMICALS DETECTION, TREATMENT AND REMEDIATION. ELSEVIER LTD

[HTTPS://WWW.SCIENCEDIRECT.COM/SCIENCE/ARTICLE/PII/B9780081030172000076?VIA%3DIHUB](https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/B9780081030172000076?via%3DIHUB)

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR (2011): STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR BIODIVERSITETIN 2011-2020

[HTTPS://WWW.AMMK-RKS.NET/REPOSITORY/DOCS/STRATEGJIA_DHE_PLANI_I_VEPRIMIT_PER_BIODIVERSITET\[1\].PDF](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/strategjia_dhe_plani_i_veprimit_per_biodiversitet[1].pdf)

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT (2020): MJEDISI I KOSOVËS 2020, RAPORTI I TREGUESVE MJEDISORË

[HTTPS://WWW.AMMK-RKS.NET/REPOSITORY/DOCS/MJEDISI_I_KOSOVES_2020_RAPORT_I_TREGUESVE_MJEDISOR%C3%AB_-_SHQIP.PDF](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/mjedisi_i_kosoves_2020_raport_i_treguesve_mjedisor%c3%ab_-_shqip.pdf)

Gjitarët (Mammalofauna) – Bjeshkët e Nemuna dallohen me përfaqësimin e të gjitha llojeve të gjitarëve që jetojnë në territorin e Kosovës dhe Gadishullit Ballkanik. Brejtësit janë gjitarët më popullues, kurse gjitarët në përgjithësi kategorizohen në 3 lloje insektngrënëse, 19 lloje brejtës, 11 lloje mishngrënës, 1 lloj jopërtypës dhe 3 lloje jopërtypës. Rrëqebulli (*Lynx lynx*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), ujku (*Canis lupus*) dhe çakalli (*Canis aureus*) janë gjitarë në zhdukje në shkallë botërore.

Nga llojet shtazore të mbrojtura me ligj në Kosovë janë edhe disa lloje që jetojnë në territorin e Gjakovës dhe gjinden në Anex II të Direktivës së Habitaveve (92/42/EEC). Ato lloje janë: *Ursus arctos* (Ariu i murrmë), *Sciurus vulgaris* (Ketri), *Martes foina* (Sqarhi, Kunadhja gushbardhë), *Capreolus capreolus* (Kaprolli) dhe *Felis silvestris* (Macja e egër).

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në hulumtimin dhe analizën e raporteve mbi gjendjen mjedisore në Kosovë dhe Evropë, mund të përfundojmë se vendi ynë ka mangësi të theksuar në monitorimin e burimeve të ndotjes në mjedis, në përpunimin e të dhënave nga terreni dhe kontribuimin me të dhëna të sakta mbi cilësinë e ajrit, dheut dhe ujërave në raportet evropiane të monitorimit të gjendjes mjedisore.

IHMK-ja ka qendra monitorimi për cilësinë e ajrit në disa qytete, por nuk ka stacion monitorimi në komunën e Gjakovës, gjë e cila e bën të pamundur analizimin dhe ndërmarrjen e veprimeve të informuara për përmirësimin ose kontrollimin e cilësisë së ajrit. Në mungesë të stacioneve nga IHMK, ka disa iniciativa private të financuara për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe klimës në kohë reale, por të cilat nuk kanë të dhëna të mjaftueshme për prezentimin e historikut të cilësisë së ajrit për periudhë më të gjatë se njëditore ose njëjavore. Përveç temperaturës mesatare dhe dioksid karbonit, këto stacione nuk monitorojnë edhe shumë elemente të tjera të dëmshme në ajër, gjë që rrezikon mirëqenien e banorëve.

Edhe pse jo në të gjitha komunat, cilësia e ajrit monitorohet në 12 stacione të shpërndara nëpër Kosovë, por nuk ka sistem të instaluar për monitorimin e cilësisë së dheut. Iniciativat nga organizatat ndërkombëtare kanë bërë studimin e cilësisë së dheut në detaje në 17 komuna të Kosovës, por as në këtë rast Gjakova nuk është përfshirë në studim, duke e lënë atë edhe një hap prapa në monitorimin e gjendjes në mjedis. Si pasojë e mungesës së studimeve të mirëfillta për cilësinë dhe përfitimet nga menaxhimi i mirë i tokave, sektori i bujqësisë dhe i pylltarisë pëson më së shumti nga degraduesit natyrorë dhe njerëzorë, e me të edhe ekonomia dhe biodiversiteti.

Ujërat dhe jeta e gjallë në to rrezikohen përherë nga derdhja e pakontrolluar e ujërave të ndotur në to. Ndotësit kolektivë dhe individualë të ujërave sipërfaqësore në komunën e Gjakovës janë të identifikuar, por nuk ka dëshmi të kontrollimit të tyre dhe ruajtjes së ujërave nga ndotja e mëtejshme. Këto aktivitete të dëmshme të cilat izolojnë si probleme të institucioneve për monitorimin e ujërave, në fakt, përfshijnë gjithë botën e gjallë dhe ndikojnë drejtpërdrejt në rënien e biodiversitetit e me të edhe të cilësisë së ajrit dhe të dheut, duke mbyllur rrethin e ndërvarshmërisë së mirëqenies në natyrë.

REKOMANDIME:

1. **Të shtohen pikat e monitorimit të cilësisë së ajrit në vend, e veçanërisht në Komunën e Gjakovës, si komunë me industri e ekonomi specifike.** Me monitorim të saktë të vlerave në ajër, do të identifikoheshin edhe ndotësit kryesorë, gjë që do të mundësonte formulimin e strategjive dhe planeve për menaxhim më të mirë të cilësisë së ajrit.
2. **Integrimi i sistemit për ngrohje në sistem të njëtrajtshëm për qytetin**, meqë aktualisht 13,571 objekte të banimit përdorin burimet e biomasës për ngrohje, që reflektohet në rënien drastike të cilësisë së ajrit gjatë muajve të ftohtë të vitit. Përveç cilësisë së ajrit, prerja e pakontrolluar e pyjeve ka ndikim të drejtpërdrejtë në biodiversitet, që është dëshmuar me trendin në rënie të popullsisë së shumë specieve që jetojnë në pyje.
3. **Marrja e praktikave të qëndrueshme për bujqësi dhe pylltari nga vendet evropiane dhe integrimi në politikat e komunës.** Përdorimi i tepruar i plehrave kimike dhe pesticideve dëmton cilësinë e dheut, të ujërave dhe të vlerave ushqyese të produkteve përfundimtare. Si një nga sektorët më ndotës në vend, menaxhimi i dheut duhet të bazohet në praktika të bollëkut, me mbjelljen e kulturave të ndryshme bujqësore dhe përzierjen e tyre me rrotullimin e mbjelljeve vjetore. Mangësi e theksuar është mungesa e trajnimit të shfrytëzuesve të plehrave kimike për përdorimin e tyre me masë të caktuar, pa efekte të mëdha në ajër dhe mjedis në përgjithësi. Bashkëpunimi ndërinsti-

tucional, angazhimi i ekspertëve të sektorit dhe realizimi i trajnimeve specifike do të ishin të nevojshme për të përmirësuar inventarin e të dhënave të gazrave serrë nga ky sektor.

Promovimi i riciklimit të mbeturinave dhe shtytja institucionale për përvetësimin e kësaj praktike nga bizneset dhe banorët përmes hapësirave të dedikuara, por edhe trajtimit të duhur përfundimtar të mbeturinave në deponinë transfer. Edhe pse janë ndërmarrë shumë iniciativa nga zyret lokale dhe organizatat e pavarura për riciklimin e mbeturinave, mënyra e trajtimit të tyre të mëtejshëm pas grumbullimit është i paqartë, sidomos në rastin kur komuna nuk ka deponi të veten sanitare, por vetëm stacion tranzitor para përcjelljes së tyre në deponinë e Prizrenit në Landovicë.

Promovimi dhe vetëdijesimi mbi ruajtjen e biodiversitetit përmes bashkëpunimit me MASHT dhe shkollat e drejtoritë e arsimit. Qëllimi do të përfshinte krijimin e grupeve dhe shoqatave mjedisore-ekologjike në të gjitha nivelet e arsimit, brenda dhe jashtë shkollës, përfshirja e metodave dhe teknologjike të përshtatshme për natyrë, si dhe fushata që e informojnë publikun mbi problemet me të cilat përballet ekosistemi, ndikimet e kësaj situatë në mirëqenien e qenieve të gjalla, duke përfshirë edhe njerëzit dhe përfshirja e publikut në procesin vendimmarrës.

SHTOJCAT

